



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 63/2021 regjistër (JR)
Datë 02.11.2021

Nr. 1 i vendimit
Datë 15.01.2025

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo	Kryesues
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare

mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 15.01.2025, ditën e mërkurë, në orën 10.00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Ervin Karanxha, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 413, datë 07.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Karanxha.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; neni F, pikat 2 dhe 7 të Aneksit të Kushtetutës; neni 58, pika 1, shkronja “a”, nenet 59, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” dhe shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim, ligji nr. 84/2016), shqyrtoi pretendimet dhe kërkimet e subjektit të rivlerësimit, të paraqitura në ankim dhe parashtrimet shtesë të depozituara në Kolegj, sipas të cilave, ai kërkoj përfundimisht prishjen e vendimit nr. 413, datë 07.07.2021 dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit me një tjetër trup gjykues ose ndryshimin e këtij vendimi, duke vendosur konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores, Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Ervin Karanxha (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1, të ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: **(a)** Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim, “ILDKPKI”); **(b)** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim, “DSIK”); dhe **(c)** Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim, “KLP”), prej të cilave rezultoi si më poshtë:

2.1. ILDKPKI-ja, në përfundim të procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm, sipas të cilit: *(i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka veprime fiktive dhe mashtrim për përfitime të padrejta; (ii) nuk ka burime financiare të ligjshme; (iii) ka kryer fshehje të pasurisë ndër vite; (iv) ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

2.2. DSIK-ja ka përcjellë fillimisht raportin e vlerësimit¹ për subjektin e rivlerësimit, me konstatimin fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës dhe, në datën 15.04.2021, ka dërguar raportin e përditësuar,² në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës. Sipas këtij raporti, për subjektin e rivlerësimit disponohen të dhëna për përfshirje në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës. Pavarësisht nga ky konstatim, autoriteti ndihmës shprehet se konkluzioni përfundimtar të mbetet në vlerësimin e

¹ Raporti datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht në datën 15.04.2021, hartuar pa përgjigjen e Shërbimit Informativ të Shtetit.

² Raporti datë 12.04.2021, deklasifikuar pjesërisht me vendim të datës 13.04.2021.

Komisionit, nën dritën e konstatimeve të dala nga hetimi administrativ, që po kryhet ndaj subjektit të rivlerësimit.

2.3. KLP-ja kreu vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke analizuar formularin e vetëdeklarimit dhe të dhënat e dokumentet e tjera që shoqërojnë këtë formular; 3 (tre) dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; 5 (pesë) dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; të dhënat nga prokuroritë e rretheve gjyqësore, Prokuroria e Përgjithshme dhe burimet arkivore pranë kësaj të fundit. Në përfundim të procedurës së kontrollit, i dërgoi Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit.

3. Komisioni zhvilloi procesin e rivlerësimit kalimtar bazuar *në tri kriteret*, duke konkluduar me masën disiplinore të *shkarkimit nga detyra*, nëpërmjet vendimit objekt shqyrtimi, nr. 413, datë 07.07.2021. Arsyetimi i Komisionit përmbledhet në vijim.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Vendimi i Komisionit, për shkarkimin e subjektit nga detyra, u bazua në vlerësimin përfundimtar se subjekti i rivlerësimit:
 - a. *Nuk* arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, pasi ai dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar krijimin e pasurisë dhe kryerjen e shpenzimeve ndër vite. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, që përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve të bëra në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.
 - b. Është *i përshtatshëm* në vlerësimin e figurës. Nga rrethanat e konstatuara nga grupi i punës së DSIK-së dhe nga Komisioni, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë bërë deklaram të pamjaftueshëm, apo që të jetë në kushtet e nenit 61, pika 2 të po këtij ligji. Për rrjedhojë, subjekti u vlerësua se ka kryer deklaram të saktë në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës.
 - c. Është *i papërshtatshëm* nga vlerësimi i aftësive profesionale për vazhdimin e detyrës së prokurorit, pasi ka demonstruar mangësi serioze të arsytimit ligjor, në kuptim të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, dhe mangësi të theksuara në aftësitë e tij organizative, sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016. Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në respektimin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, në kuptim të nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016. Për shkak të këtyre mangësive, në kuptim të parashikimeve të nenit E, pika 4 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 44, germa “c” e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka demonstruar gjykim të dobët, që ka sjellë gjithashtu shkelje të të drejtave të palëve, të cilat nuk mund të riparohen nëpërmjet programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës. Bazuar në këto konkluzione, ndaj tij duhet të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
 - d. Në vlerësimin tërësor të procedurave, subjekti *nuk* u tregua bashkëpunues gjatë procesit të hetimit të kryer ndaj tij dhe në mënyrë të përsëritur ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë. Sjellja e subjektit të rivlerësimit ka vështirësuar kryerjen e procesit të rivlerësimit. Kundërshtimet dhe kërkesat e përsëritura gjatë procesit, e sidomos në fazën finale të tij, kanë synuar të shtyjnë apo zgjasin procesin,

në kundërshtim me detyrimet ligjore të subjekteve në këtë proces. Një sjellje e tillë cenon besimin e publikut te funksionari që e kryen atë, në një mënyrë të parikuperueshme nëpërmjet trajnimit në Shkollën e Magjistraturës. Edhe vetëm kjo qasje e sjellje ndaj procesit të rivlerësimit, do të përmbushte një nga kushtet e parashikuara për shkarkim nga detyra sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

III. Shkaqet e ankimit të ngritur nga subjekti i rivlerësimit

5. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim kundër vendimit të Komisionit në datën 20.10.2021. Në përfundim të ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkoi nga Kolegji marrjen në shqyrtim të shkaqeve të ankimit dhe: (i) gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike; (ii) konstatimin e shkeljeve të të drejtave Kushtetuese dhe atyre të parashikuara nga KEDNj-ja; (iii) çeljen e shqyrtimit gjyqësor dhe administrimin e provave të reja, në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012; (iv) prishjen e vendimit nr. 413, datë 07.07.2021 dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, me një tjetër trup gjykues ose ndryshimin e vendimit, duke vendosur konfirmimin në detyrë. Gjithashtu, subjekti i kërkoi Kolegjit ndryshimin e vendimeve të ndërmjetme të dhëna nga Komisioni. Bashkë me ankimin, subjekti ka depozituar gjashtë (6) akte³ dhe kërkuar administrimin e tyre në cilësinë e provës.

5.1. Në zbatim të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, subjekti, në datën 08.01.2025, ka paraqitur në Kolegji parashtrime dhe akte.⁴ Po ashtu, përpara datës së seancës gjyqësore, subjekti ka përcjellë në Kolegji edhe pesë (5) kërkesa,⁵ me objekt: *përfundimin e gjyqtarëve të shortuar për shqyrtimin e kësaj çështjeje*. Të gjitha kërkesat, pasi u shqyrtuan në Kolegji veçmas nga trupa gjykues, në të cilët nuk përfshihej gjyqtarja/gjyqtari për të cilin kërkohej përfundimi, u gjetën të pabazuara dhe u rrëzuan⁶.

³ Konkretisht: (i) kopje të printuara të korrespondencës elektronike mes tij dhe Komisionit, që mbajnë datat: 06.07.2021, 07.07.2021, 11.10.2021 dhe 18.10.2021, për kërkesa e njoftime të ndryshme të kryera nëpërmjet tyre gjatë hetimit administrativ të kryer për të; (ii) printim i faqes zyrtare elektronike të Komisionit, për njoftimin e seancës dëgjimore datë 07 korrik 2021; (iii) rekurs i një të pandehuri kundër një vendimi penal të Gjykatës së Apelit Tiranë; (iv) kërkesë drejtuar Komisionit për riçelje të hetimit gjyqësor.

⁴ Me parashtrimet shtesë në Kolegji, subjekti depozitoi edhe: (i) një vërtetim dhe një ekstrakt nga QKB, me të njëjtën datë, lëshuar përkatësisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një çështje civile, për një person juridik, ku kjo shoqëri është një ndër palët ndërgjyqëse; (ii) një akt noterial, lëshuar nga nëna e subjektit mbi disa lajme/shkrime mediatike nga një portal elektronik (Top Channel); (iii) një version i printuar i një artikulli mediatik, të datës 31.03.2022 (Gazeta Shqip); (iv) Njoftim i SPAK për shtyp, datë 16.07.2024; (v) shtatë vendime gjykatash, përkatësisht i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 20.07.2022; i GjKKO-së, datë 03.12.2021 dhe datë 12.01.2023; i Gjykatës së Apelit Tiranë (me një individ kallëzues, F. O.), datë 31.10.2018; i Gjykatës së Lartë, datë 11.04.2014, me të njëjtin kallëzues; i Gjykatës Administrative të Apelit, datë 23.01.2018 dhe i Gjykatës Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, datë 03.06.2024, me kërkues U. Sh. K. K.; (vi) shënimet e mjekut të urgjencës, datë 23.06.2021; (vii) akt ekspertimi financiar datë 15.06.2021, nga një ekspert privat, i përkthyer në gjuhën angleze; (viii) vendimi i Kolegjit për bashkëshorten e subjektit, subjektin e rivlerësimit B. K.; (ix) material filmik i një fjalimi politik të një deputeti të Kuvendit të Shqipërisë (shkarkuar nga YouTube dhe shoqëruar me vërtetimin noterial datë 08.01.2025 dhe një USB); (x) akt noterial, datë 08.01.2025, i shkrimit të marrë nga A2 CNN, datë 30 janar 2023, për dy individë, personazhe publike dhe seancat parlamentare të radhës në lidhje me takimin e tyre; (xi) akte noteriale, datë 08.01.2025, për lajme të pasqyruara nga media të ndryshme në datat 31.03.2022 dhe 17.02.2024; (xii) kopje e njësuar me origjinalin e procesverbalit të një seance gjyqësore në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 09.12.2022, në procedimin penal të një individi (i pandehuri A. L.); (xiii) kopje e njësuar me origjinalin e njoftimit për përfundimin e një hetimi, lëshuar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, (xiv) listë kandidatësh konkurrentë për të studiuar në Shkollën e Magjistraturës në vitin 1997.

⁵ Kërkesat datë 21.10.2024.

⁶ Me vendimet e datës 04.12.2024.

5.2. Në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit grupohen në ato me natyrë procedurale dhe ato të themelit, në kundërshtim të konkluzioneve të Komisionit për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, vlerësimin e aftësive profesionale dhe për cenimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë.

III/1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

5.3. Subjekti i rivlerësimit pretendon se i është shkelur e drejta për t'u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, që nuk përmbushte kërkesat e një gjykate të pavarur dhe të paanshme, në kuptim të nenit 6/1 të KEDNj-së dhe nenit 42 të Kushtetutës, për shkak të: **(i)** pranisë në trupin gjykues të dy anëtarëve, që sipas tij nuk plotësonin kriteret e zgjedhshmërisë për institucionet e rivlerësimit; **(ii)** njëanshmërisë së njërës prej anëtarëve për shkak të lidhjes miqësore me një drejtues televizioni shqiptar kombëtar, që transmetonte vazhdimisht kronika kundër subjektit të rivlerësimit dhe po ashtu në konflikt interesi për shkak të një procesi auditimi, që po kjo anëtare kishte ushtruar më herët edhe ndaj babait të subjektit, si edhe **(iii)** për shkak se të njëjtët anëtarë të trupit gjykues që kanë kryer hetimin administrativ, kanë dhënë vendimin përfundimtar dhe zgjidhur çështjen në themel.

5.4. Komisioni ka vepruar në shkelje të së drejtës së subjektit për t'u dëgjuar dhe në shkelje të parimeve tjera të së drejtës, e konkretisht, parimit të ligjshmërisë, drejtësisë e paanësisë, barazisë para ligjit, mbrojtjes juridike dhe lirive e të drejtave kushtetuese, parimit të kontradiktoritetit dhe të proporcionalitetit. Nëpërmjet mosrespektimit të të drejtave dhe parimeve të referuara më sipër dhe marrjes së një vendimi të paarsyetuar, Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit për një proces të rregullt ligjor.

5.5. Në parashtrimet shtesë, subjekti ka pretenduar se procesi i tij i rivlerësimit ka qenë “torturues”, “denigrues” dhe “poshtërues” për të dhe familjen, në shkelje të nenit 3 të KEDNj-së, “Ndalimi i torturës”, nenit 8, “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare” dhe nenit 14 të po këtij akti, “Ndalimi i diskriminimit”.

III/2. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë

5.6. Subjekti ankimon konkluzionin e Komisionit për apartamentin e banimit me sipërfaqe 90.12 m,² në Tiranë, ndërtuar nga shoqëria “{***}” ShPK, me pretendimet e përmbledhura në vijim:

5.6.1. *Në lidhje me momentin kohor të vënies në posedim real të apartamentit*, subjekti pretendon se banimi në këtë apartament ka filluar në nëntor 2011 dhe jo në korrik 2011, sikurse është konkluduar nga Komisioni, bazuar vetëm në një shkresë të FShU/OShEE-së.

5.6.2. *Kredia në Alpha Bank*, nga personi i lidhur/bashkëshortja, është marrë në vitin 2005, përpara martesë dhe është detyrim vetjak i saj; të njëjtin regjim pasuror ndjekin edhe burimet e përdorura për shlyerjen e saj, ndër to edhe huaja prej 1.200.000 lekësh, marrë nga bashkëshortja, të afërmeve të saj. Fakti i marrjes së huas pas lidhjes së martesës, në datën 02.04.2010, nuk e “zhvesh” këtë detyrim nga karakteri vetjak i bashkëshortes. Komisioni ka interpretuar gabim Kodin e Familjes mbi regjimin pasuror, duke e konsideruar huan si detyrim të bashkësisë ligjore dhe duke e përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

5.6.3. Lidhur me kredinë me kushte lehtësuese, të marrë në vitin 2011, në Bankën Kombëtare Tregtare (në vijim referuar BKT), nga bashkëshortja, Komisioni ka përfshirë në hetimin administrativ të subjektit të rivlerësimit problematikat që i përkasin hetimit administrativ të bashkëshortes, e cila gjithashtu ka qenë subjekt rivlerësimi. Kredia në fjalë është përfituar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore; konstatimi i Komisionit, se kontratat e nënshkruara janë fiktive apo të simuluar, është i pambështetur në ligj, fakte e prova, pasi destinacioni/qëllimi i kredisë (përmbushja e nevojave të subjektit për strehim), nuk ka ndryshuar asnjëherë.

5.6.4. Për analizën financiare, në shkelje të parimit të kontradiktoritetit, Komisioni ka refuzuar kërkesën e subjektit për thirrjen e ekspertit kontabël të pajtuar prej tij dhe krahasimin e raportit financiar të hartuar për këtë qëllim, me atë të hartuar nga këshilltari ekonomik i Komisionit. Analiza financiare e viteve 2006 dhe 2008 ka rezultuar padrejtësisht me balancë negative, për shkak të metodologjisë së gabuar të aplikuar në përpilimin e saj. Për këto vite, Komisioni ka dubluar likuiditetet *cash* me ato të depozituara në bankë, pa marrë parasysh faktet që provonin se këto të fundit ishin krijuar nga transferimi i likuiditeteve *cash*. Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë as efektet e kursit të këmbimit të valutës në periudhat respektive. Analiza financiare për vitet 2010, 2011 dhe 2012 ka rezultuar me balancë negative si rrjedhojë e përfshirjes të detyrimeve që nuk rëndojnë mbi bashkësinë ligjore, si më lart përmbledhur. Gjithashtu, shpenzimet telefonike të bashkëshortes dhe shpenzimet për jetesë kanë qenë në vlera më të ulëta nga ato të llogaritura nga Komisioni.

III/3. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale

5.7. Në mënyrë të përmbledhur, shkaqet e ankimit për këtë kriter shtjellohen në vijim:

5.7.1. Komisioni nuk i ka kaluar subjektit barrën e provës. Në seancën dëgjimore të zhvilluar në mungesë të subjektit, Komisioni ka ndryshuar vlerësimin e kriterit profesional nga “shumë mirë”, sipas raportit të vlerësimit të kryer nga KLP-ja, në “mangësi serioze”, të pamundura të riparohen nëpërmjet programit trajnues në Shkollën e Magjistraturës. Vendimi i Komisionit është i paarsyetuar, pasi nuk shpjegon çfarë ka ndryshuar nga raporti përfundimtar, në të cilin ai është vlerësuar *shumë mirë* për kriterin profesional.

5.7.2. Komisioni ka mbajtur standard të dyfishtë krahasuar me subjekte të tjerë rivlerësimi, pasi për gjetjet e konstatuara lidhur me cenimin e etikës apo të mënyrës së hetimit të një çështjeje, nuk duhej të konkludonte për paaftësi profesionale, por ta referonte për hetim të mëtejshëm në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë (në vijim, ILD).

5.7.3. Denoncimi i z. E. K. - Konkluzioni i Komisionit për papajtueshmërinë është i pambështetur në akte dhe në ligj. Subjekti i rivlerësimit ka dhënë dorëheqjen dhe kjo çështje është hetuar dhe përfaqësuar në gjykatë nga një tjetër prokuror. Konkluzioni i Komisionit është nxjerrë në interpretim të gabuar të ligjit nr. 9367/2005, “Për parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar (në vijim referuar ligji nr. 9367/2005) dhe ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim referuar ligji nr. 96/2016).

5.7.4. Denoncimi i z. F. O. - Konkluzioni i Komisionit për papajtueshmërinë është i pambështetur në akte dhe në ligj. Vendimi i dhënë nga bashkëshortja e tij, në cilësinë e gjyqtarës, nuk është pjesë e arsyetimit të vendimit të pushimit të marrë prej subjektit dhe as të ketë ndikuar në këtë vendim. Ai

(subjekti) nuk ka qenë në dijeni të vendimit të dhënë nga bashkëshortja. Denoncuesi nuk ka pretenduar papajteshmërinë dhe as ka kërkuar përjashtimin e subjektit nga hetimi i çështjes penale. Për rrjedhojë, kjo e drejtë e denoncuesit ka rënë në dekadencë. Veprimet hetimore dhe vendimmarrja e subjektit për pushimin e çështjes, janë vlerësuar nga Gjykata me vendim të formës së prerë se janë në përputhje me ligjin.

5.7.5. Denoncimi i U. Sh. K. K. - Është i padrejtë konkluzioni i Komisionit, se subjekti ka treguar minimalisht mangësi të theksuara të njohurive ligjore, nëpërmjet rolit të tij pasiv në kryerjen e veprimeve hetimore dhe në funksion të zbardhjes së çështjes. Vendimi i Komisionit është i cunguar, pasi nuk arsyeton se cilat janë problematikat e konstatuara në këtë procedim penal, që e vendosin subjektin në kushtet e nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016. Vendimi i Komisionit është marrë në kundërshtim me vendimin e gjykatës, e cila ka lënë në fuqi vendimin e mosfillimit të disponuar prej tij.

5.7.6. Denoncimi i z. A. H. - Subjekti kundërshton konkluzionin se ai ka kryer veprime të dyshimta si prokuror i çështjes. Gjetjet e Komisionit, në lidhje me kërkesat për caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, kthimin e sendeve të sekuestruara, zgjatjen e afatit të hetimeve dhe kërkimin e masës së dënimit në minimumin e parashikuar në ligj, janë të pambështetura në ligj dhe në akte. Hetimet janë kryer nga oficeri i Policisë Gjyqësore, i cili ka referuar te prokurori se hetimet kanë qenë të plota. Kërkimi për caktimin e “arrestit në shtëpi” është bërë për shkak se: (i) afatet e paraburgimit ishin drejt përfundimit; (ii) zbutjes së akuzës pas shpalljes së moskompetencës të Prokurorisë së Krimeve të Rënda; (iii) kjo masë është caktuar nga titullari i prokurorisë, pasi në atë kohë, prokuroria vepronte si një organ i centralizuar. Kthimi i sendeve të sekuestruara në cilësinë e provës materiale është bërë konform ligjit procedural penal, pas kryerjes së të gjitha veprimeve hetimore. Kthimi i tyre nuk dëmtonte hetimin. Vendimet për zgjatjen e afatit të hetimit janë marrë në pritje të ardhjes së letërporosisë nga autoritetet e huaja. Kërkesa për caktimin e masës së dënimit ka qenë brenda kufijve të lejuar, që përcakton neni 298/3 i Kodit Penal. Edhe nëse konstatimet e mësipërme do të rezultonin të qenësishme, ato nuk mund ta vendosnin subjektin në kushtet e nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, i cili e lidh aspektin e njohurive ligjore me tregues të tillë, si aftësia e përgjithshme për të ndërmarrë logjikisht hetimin dhe jo vlerësim në një dosje konkrete.

III/4. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin për cenimin e besimit të publikut

5.8. Subjekti potencon që konkluzioni për cenim të besimit të publikut kushtëzohet nga konstatimi i veprimeve/sjelljeve që përbëjnë shkelje të normave ligjore në fuqi, ndërkohë që Komisioni nuk ka argumentuar cilës “njësi matëse” i është referuar në këtë funksion. Po ashtu, konkluzioni në fjalë, sipas subjektit, ka qenë i paragjykuar dhe i qëllimshëm. Komisioni ka anashkaluar qëllimisht raportet pozitive të organeve kompetente, që verifikojnë figurën dhe profesionalizmin e subjektit (DSIK dhe KLP), të cilat kanë konfirmuar përshtatshmërinë në detyrë të subjektit të rivlerësimit.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

6. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, përveç rasteve të vendimeve të

dhëna sipas nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

7. Pasi analizoi kërkesat procedurale të subjektit të rivlerësimit, për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, riçeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin e provave që janë pjesë e dosjes së Komisionit dhe marrjen e provave të reja, të paraqitura prej tij, trupi gjykues i Kolegjit vendosi të shqyrtojë ankimin në dhomë këshillimi, nën dritën e pikës 1, të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012⁷. Ky konkluzion u arrit pasi trupi gjykues çmoi se nuk gjen zbatim asnjë nga rrethanat e përcaktuara në ligj⁸ për kalimin në seancë gjyqësore publike në praninë e subjektit. Ky vlerësim përfshin analizën e kryer, qoftë për shkaqet procedurale apo të vlerësimit të rrethanave faktike, përcaktuar nga neni 51 i ligjit nr. 49/2012, të shtjelluar më poshtë.

7.1. Ndër aktet e depozituara me ankimin dhe parashtimet shtesë, trupi gjykues konstaton që 13 prej tyre⁹ nuk plotësojnë kriteret e parashikuara për rastet përjashtimore, që normon ligji për provat e reja që lejohen me ankimin, në nenin 47 të ligjit nr. 49/2012. Për sa i përket akteve të tjera (15 prej tyre),¹⁰ që

⁷ “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”

⁸ Neni 51 i ligjit nr. 49/2012 përcakton: “[1.] Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar se: a) për konstatimin e gjendjes faktike, në mënyrë të plotë dhe të saktë, duhen vërtetuar fakte të reja dhe duhen marrë prova të reja kur janë kushtet e nenit 47 të këtij ligji; b) vendimi kundër të cilit është paraqitur ankimi është bazuar në shkelje të rënda procedurale, apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose në mënyrë jo të plotë; c) me qëllim të konstatimit të drejtë të gjendjes faktike duhet të përsërisë marrjen e disa ose të gjitha provave të marra nga Gjykata e Shkallës së Parë. [...]”

⁹ Konkretisht, aktet që nuk plotësojnë kriterin ndalues për provat e reja me ankimin, përmbledhur dhe referuar në grupime sipas tematikës, janë: (1.) Korrespondencë elektronike me Komisionin (email drejtuar subjektit, më datë 06.07.2021, ora 09:56, nëpërmjet të cilit pasqyrohet mospranimi i kërkesave të subjektit, email i subjektit ora 17:32 i së njëjtës ditë, për marrjen dijeni mbi vendimet e përjashtimit dhe shprehjen e dakordësisë për seancën dëgjimore të datës 07.07.2021, ora 09:30 dhe email datë 07.07.2021, ora 08:20, i subjektit drejtuar Komisionit, me lëndë “Kërkesë për riçelje hetimi”). (2.) Printim i faqes zyrtare të internetit të Komisionit me njoftimin e seancës dëgjimore të datës 07 korrik 2021. (3.) Rekurs i një të të pandehuri (A. B.), kundër vendimit penal nr. {***}, datë 02.06.2015, të Gjykatës së Apelit Tiranë. (4.) Kërkesë e subjektit për riçelje të hetimit gjyqësor drejtuar Komisionit. (5.) Vërtetim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një çështje gjyqësore (me kërkuar “{***}” ShPK), me datë 18.06.2021 dhe ekstrakt regjistri tregtar i së njëjtës datë, e për të njëjtën shoqëri. (6.) Redaktim procesverbali konstatimi noterial datë 17.06.2021, ku janë pasqyruar shkrimet e një operatori mediatik (Top Channel). (7.) Tri vendime gjykatash, me palë F. O., përkatësisht të marrë nga Gjykata e Apelit Tiranë (nr. {***}, datë 31.10.2018), Gjykata e Lartë (nr. {***}, datë 11.04.2014) dhe ajo Administrative e Apelit (nr. {***}, datë 23.01.2018). (8.) Shënime të mjekut të urgjencës, mbi ekzaminimin e subjektit, që mban datën 23.06.2021. (9.) Akt ekspertimi financiar, datë 15.06.2021, i ekspertit të licencuar (z. I. D.), i përkthyer në gjuhën angleze. (10) Listë kandidatësh konkurrues në vitin 1997, për pranim në Shkollën e Magjistraturës.

¹⁰ Në grupin e dytë të akteve, të përmbledhura sipas tematikës së tyre, gjenden: (1) Kërkesë e subjektit për dokumentacion dhe kthim përgjigje nga Komisioni, përkatësisht në datat 11.10.2021 dhe 18.10.2021; (2) Gazeta Shqip e datës 31 mars 2022, me shkrimin “Aktualitet, TCH: Përzumë Gjobaxhinjtë/Emisioni Investigativ”; (3) Njoftim për shtyp, datë 16.07.2024, i SPAK; (4) Pesë vendime gjykatash (nr. {***}/2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nr. {***}/2023 dhe nr. {***}/2021, të GjKKO-së, nr. {***}/2024, i Gjykatës së Lartë, nr. {***}/2024, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm); (5) Vendim i Kolegjit për bashkëshorten e subjektit (subjekti i rivlerësimit B. K.); (6) Material filmik i fjalimit të një anëtarit të Kuvendit të Shqipërisë (z. T. B.), shkarkuar nga YouTube nga noteri, shoqëruar me vërtetimin noterial datë 08.01.2025 dhe një USB; (7) Vërtetim noterial, datë 08.01.2025, i një shkrimi nga një kanal televiziv kombëtar (A2 CNN), datë 30 janar 2023, për ngjarje politike në vend; (8) Vërtetim noterial dhe verifikim dokumentacioni, që mban datën 08.01.2025, me fokus tri shkrime të publikuara në mediat online, përkatësisht në mars 2022 dhe shkurt 2024, nga gazetashqip.com, dhe VOA/Zëri i Amerikës, në gjuhën shqipe; (8) Kopje e procesverbalit të një seance gjyqësore, datë

datojnë pas dhënies së vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues vlerësoi se nëpërmjet tyre nuk rezultojnë rrethana që do të diktonin nevojën për debat gjyqësor në prani të palëve, sipas kërkesave të nenit 51 të të njëjtit ligj. Së fundmi dhe në përmbledhje, në tërësinë e tyre, vlerësuar edhe nën dritën e përcaktimeve të nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, aktet e sjella nga subjekti u gjetën të panevojshme dhe jopërcaktuese për procesin dhe zgjidhjen përfundimtare.¹¹

7.2. Gjithashtu, nga vlerësimi i konkluzioneve të Komisionit dhe pretendimeve në ankimin e parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues nuk evidentoi asnjë shkelje të rëndë procedurale apo konstatim të gabuar të situatës faktike, që do të passillte nevojën e debatit gjyqësor në seancë gjyqësore publike në Kolegj, me praninë e subjektit të rivlerësimit, për korrigjimin e tyre.

7.3. Në të njëjtën linjë, edhe kërkimi i subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike, nuk rezultoi të paraqesë ndonjë prej situatave të parashikuara nga neni 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012. Kolegji vlerësoi kryesisht se: **(a)** Komisioni ka konstatuar gjendjen faktike në mënyrë të plotë dhe të saktë, e për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; **(b)** nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale, që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; si dhe **(c)** nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo e të gjitha provave të administruara në Komision.

7.4. Në përmbledhje të arsyetimit dhe analizës së mësipërme, Kolegji e vlerësoi të pabazuar në ligj, kërkimin e subjektit të rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore publike dhe vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49, të ligjit nr. 49/2012, referuar nga neni 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

B. Vlerësimi i Kolegjit për shkaqet e ankimit

B.1. Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

8. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka shkelur parimin e ligjshmërisë, drejtësisë e paanësisë, të drejtës së subjektit për t'u dëgjuar dhe në shkelje të parimeve të tjera të së drejtës, e konkretisht: barazisë para ligjit, mbrojtjes juridike dhe lirive e të drejtave kushtetuese, parimit të kontradiktoritetit dhe proporcionalitetit, e të drejtës për t'u dëgjuar. Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit për një proces të rregullt ligjor, nëpërmjet mosrespektimit të të drejtave të referuara më sipër dhe marrjes së një vendimi të paarsyetuar.

8.1. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se asnjë prej këtyre pretendimeve nuk është i bazuar. Subjekti është dëgjuar, ka pasur korrespondencë të mirëfilltë me Komisionin dhe nga aktet në fashikull rezultojnë qartë që, gjatë procesit të hetimit administrativ, atij i janë respektuar të gjitha të drejtat për proces kontradiktor, sikurse edhe të gjitha aspektet e së drejtës për një proces të rregullt sanksionuar nga Kushtetuta dhe neni 6 i KEDNj-së. Arsyetimi mbi të cilin mbështetet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

09.12.2022, në Dhomën Penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në procedimin penal kundër një të pandehuri (A. L.); (9) Kopje e njëzuar me origjinalin e një njoftimi të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, për përfundimin e hetimeve, datë 16.06.2023.

¹¹ Neni 49, në pikën 6, parashikon: "Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: (a) janë të panevojshme; (...) d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit".

8.2. Komisioni ka komunikuar rregullisht me subjektin e rivlerësimit gjatë katër (4) pyetësorëve dhe në vijim. Më tej, subjektit i është dhënë mundësia të japë shpjegime dhe paraqesë prova për të prapësuar konstatimet paraprake të rezultateve të hetimit administrativ. Pasi subjekti u njoh¹² me aktet në fashikull, Komisioni ka pranuar edhe dy kërkesa të tij, duke i dhënë kohë shtesë për të përgatitur shpjegime e prova, përkatësisht në datën 24.05.2021 dhe 07.06.2021. Në ushtrim të kësaj të drejte, fillimisht më datë 07.06.2021, nëpërmjet postës elektronike, e më pas, më datë 08.06.2021, në protokollin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar sërish shtyrjen e afatit përfundimtar të dorëzimit të provave dhe shpjegimeve, për të kundërshtuar rezultatet e hetimit. Komisioni ka pranuar kërkesën e dytë të subjektit për shtyrjen e afatit për të depozituar prova dhe shpjegimet, duke i dhënë kohë deri në datën 16.06.2021, si edhe duke njoftuar se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 23.06.2021. Më datë 16.06.2021, përpos parashtrimeve e provave të reja, subjekti ka kërkuar edhe thirrjen e disa dëshmitarëve. Komisioni ka refuzuar kërkesën për thirrje dëshmitarësh, duke arsyetuar se çështjet që subjekti kërkoi të provoheshin me dëshmi, ishin të shteruara, pasi për to ishin administruar dokumente dhe faktet ishin provuar gjatë hetimit administrativ tashmë. Ky vendim i është njoftuar subjektit nëpërmjet postës elektronike, më datë 25.06.2021. Sikurse do të trajtohet në vijim, seanca dëgjimore e datës 23.06.2021 ka vijuar edhe në datën 30.06.2021, nën dritën e garancive procedurale që gëzon subjekti për një mbrojtje efektive, në kushtet që vetëm përfaqësuesit e tij ligjorë ishin të pranishëm. Subjekti nuk ka qenë prezent në dy seancat dëgjimore, konkretisht në datën 23.06.2021 dhe 30.06.2021. Duke abstraguuar nga shkaqet për të cilat subjekti nuk ka qenë i pranishëm në këto dy seanca dëgjimore, trupi gjykues i Kolegjit vëren se fakti që tagrat e paplotë të përfaqësimit, që ai ka zgjedhur t'u atribuojë dy përfaqësuesve të tij ligjorë, duken të pakuptimta në kushtet që subjekti ishte në dijeni të fazës procedurale në të cilën gjendej hetimi i tij administrativ dhe kërkesat e tij për zgjatje afati ishin pranuar dy herë. Këta tagra të paplotë janë materializuar në thelb vetëm në mundësimin e kërkimeve të përsëritura të përfaqësuesve ligjorë të subjektit gjatë hetimit administrativ, me efekt krijimin e ngjarjeve procedurale, që synojnë zgjatjen e procesit¹³. Ndërsa thelbi i kërkesave dhe arsyetimi i trupit gjykues të Kolegjit trajtohet në vijim të kësaj rubrike të vendimit, në funksion të shkaqeve të ankimit, çmojmë të theksojmë që natyra e kërkesave dhe momenti kohor kur ato janë parashtruar, tregojnë se synimi ka qenë zgjatja e procesit. Në këtë linjë, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë se, nga analiza e mënyrës se si është kryer hetimi administrativ, rezulton se Komisioni *i ka respektuar* të gjitha garancitë kushtetuese e konventore për parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit.

8.3. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, se Komisioni ka shkelur parimin e mbrojtjes efektive dhe të dëgjimit, dhe që atij nuk iu dha mundësia të dëgjohej, është pabazuar. Ky konkluzion mban në konsideratë disa elemente. Së pari, dispozita procedurale civile, së cilës subjekti i referohet si bazë ligjore në mbështetje të këtij pretendimi - neni 176 i Kodit të Procedurës Civile - rregullon legjitimitimin e palëve,¹⁴ duke përcaktuar që gjykata duhet të sigurojë praninë e rregullt të palëve në proces personalisht

¹² Sipas deklaratës së subjektit, që mban datën 20.05.2021.

¹³ Konkreisht rezulton që përfaqësuesit e autorizuar të subjektit, avokatët N. P. dhe K. R., kanë paraqitur dy kërkesa përjashtimi për Komisioneren V. Sanxhaktari, në seancën e datën 23.06.2021 dhe tetë (8) kërkesa të tjera, në seancën e datës 30.06.2021, katër (4) prej të cilave ishin po ashtu për përjashtimin e së njëjtës Komisionereje, dy (2) për përjashtimin e Komisioneres E. Çiftja dhe dy (2) kërkesa për pezullimin e procesit deri në përfundimin e shqyrtimit të kallëzimit penal të ushtruar nga avokati N. P., në emër të një shoqate kundër të njëjtave Komisionere, anëtare të trupit gjykues në Komision.

¹⁴ “Gjykata verifikon legjitimitimin si palë të personave ose të përfaqësuesve të tyre të paraqitur dhe, kur është rasti, i fton ata të plotësojnë aktet dhe dokumentet që rezultojnë me të meta, duke përfshirë këtu edhe aktet lidhur me përfaqësimin, gjetjen e personit dhe, kur e sheh të nevojshme, u cakton palëve një afat”.

apo nëpërmjet përfaqësimit. Duke abstraguuar nga fakti që subjekti zgjedh të potencojë në mbështetje të argumenteve të tij, të meta në aktin e përfaqësimit të lëshuar nga ai vetë/një magjistrat karriere dhe çfarë mund të deduktohet teorikisht prej kësaj situate, trupi gjykues i Kolegjit vëren se dhënia e tagrave të kufizuara avokatëve nga vetë subjekti me vullnet të plotë, nuk mund ta kategorizojë prokurën me të meta e as të detyronte Komisionin të shtynte seancën në vetvete, përpos sa është shtyrë.

8.4. Së dyti, në kushtet që procesi i rivlerësimit është me natyrë administrative¹⁵ dhe jo civile, mosparaqitja e subjektit të rivlerësimit në seancë nuk shkakton shtyrjen e gjykimit.¹⁶ Pavarësisht këtij përcaktimi ligjor, Komisioni e ka zhvilluar seancën dëgjimore publike të ndarë në dy seanca, konkretisht në datën 23.06.2021 dhe 30.06.2021, pikërisht për t'i dhënë mundësi subjektit për të qenë prezent. Përfaqësuesit me prokurë të subjektit i kanë përdorur të dyja seancat, përkatësisht në datën 23 dhe 30 qershor 2021,¹⁷ vetëm për të ngritur kërkesa procedurale.

8.5. Komisioni ka kryer me dilijencë të gjitha veprimet procedurale, në respektim të të drejtave për një proces të rregullt. Nga ana tjetër, rezulton se pasi është njohur me rezultatet e hetimit administrativ, të cilat konstatonin një sërë problematikash, subjekti ka ndërmarrë një seri veprimesh, që dëshmojnë vullnetin e tij për të pamundësuar, vështirësuar, e më së paku, zvarritur procesin. Komisioni ka njoftuar¹⁸ dhe subjekti ka konfirmuar dijeninë që seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 23.06.2021, ora 12:30. Përmes këtij komunikimi elektronik, Komisioni, duke i rikujtuar subjektit se kërkesat për shtyrjen e afateve janë pranuar, ka ritheksuar natyrën kalimtare (kufizimin në kohë të procesit të rivlerësimit) dhe këshilluar që, në rast pamundësie për të qenë prezent në seancën dëgjimore, të përfaqësohet nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor.

8.6. Këto fakte tregojnë se Komisioni nuk kishte asnjë pengesë ligjore që të vijonte seancat dëgjimore, edhe pa praninë e subjektit, në kushtet që ai: (i) *ka qenë në dijeni të kohës* kur do të zhvilloheshin seancat, (ii) nuk ka sjellë prova për pamundësinë objektive/pengesë ligjore për të qenë i pranishëm, dhe mbi të gjitha (iii) rezultatet e hetimit ishin të njohura për të, tashmë, pasi ai kishte paraqitur prapësimet dhe (iv) vullneti i tij u materializua vetëm në përfaqësimin për paraqitjen e kërkesave procedurale.

8.7. Ndodhitë procedurale në dy seancat dëgjimore të dokumentuara në fashikull, në tërësi, provojnë të kundërtën e pretendimeve të subjektit. Konkretisht, në seancën dëgjimore të datës 23.06.2021, pasi kishte përfutur dy herë më parë shtyrje afati për të prapësuar rezultatet e hetimit dhe kërkuar edhe zgjatje për të thirrur dëshmitarë, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësuesve ligjorë, përfitoi edhe një shtyrje të tretë, ndërsa seanca, përpos efektit të zgjatjes së kohës për prapësimet, u përdor edhe për të depozituar një kërkesë të dytë për përjashtimin e Komisioneres Sanxhaktari.¹⁹ Pasi ka risjellë në vëmendje këto shtyrje, Komisioni ka vendosur që t'i japë subjektit një mundësi të re, duke ia dedikuar seancën vetëm

¹⁵ Neni 4 i ligjit nr. 84/2016 përcakton që: “[6.] Kur është rasti, institucionet e rivlerësimit mund të zbatojnë edhe procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative ose në ligjin ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’, nëse këto procedura nuk janë parashikuar nga dispozitat e Kushtetutës ose të këtij ligji. [...]”.

¹⁶ Neni 34, paragrafi i dytë i ligjit nr. 49/2012, lexuar së bashku me nenin 4, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

¹⁷ Shih poshtëshënimin nr. 13, më sipër.

¹⁸ Email, datë 08.06.2021.

¹⁹ Një kërkesë e mëhershme me këtë objekt ishte shqyrtuar nga Komisioni në datën 08.06.2021 dhe njoftuar subjektit të rivlerësimit në datën 11.06.2021, me shkresën me nr. 4379/3 prot.

prezantimit të rezultateve të hetimit dhe caktoi një seancë tjetër, që subjekti të jepte shpjegimet, një javë më pas, në datën 30.06.2021.

8.8. Në këtë seancë, pasi trupi gjykues shpalli vendimin për mospranimin e kërkesës së dytë për përjashtimin e Komisioneres Sanxhaktari, në prani të përfaqësuesve ligjorë të subjektit, këta të fundit kërkuar një shtyrje të re, duke pretenduar se kishin nevojë për arsyetimin e vendimit në fjalë. Pasi u rrëzua edhe kjo kërkesë për shtyrje të seancës, përfaqësuesit kanë depozituar tetë (8) kërkesa të tjera. Ndër to, gjashtë (6) kërkesa kishin për objekt sërish përjashtimin e Komisionereve (Sanxhaktari dhe Çiftja) dhe dy (2) kërkesa kishin për objekt pezullimin e gjykimit, për shkak të kallëzimeve penale të depozituara prej njërit prej përfaqësuesve ligjorë ndaj këtyre dy Komisionereve. Pasi Komisioni shpalli vendimet për mënyrën e procedimit për këto tetë (8) kërkesa, përfaqësuesit e subjektit paraqitën verbalisht në seancë, kërkesë për përjashtimin e të gjithë trupit gjykues.

8.9. Për pasojë, pretendimet e subjektit, për shkelje të garancive procedurale për proces të rregullt, nëpërmjet mundësisë për t'u mbrojtur apo qenë i pranishëm, janë të pabazuara në ligj dhe në akte. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, nëse vullneti i subjektit ishte realisht pjesëmarrja efektive dhe aktive në procesin dëgjimor në Komision, ai duhet të ishte pasqyruar së pari në rrethin e tagrave të përfaqësimit. Me fjalë të tjera, duke autorizuar kryerjen e të gjitha veprimeve që shoqërojnë përfaqësimin nëpërmjet një prokure të plotë, subjekti do të kishte përdorur mjetet juridike për të marrë pjesë në mënyrë efektive në proces.

8.10. Nga ana tjetër, pikërisht për shkak të momentit procedural kur këto ngjarje janë zhvilluar, e konkretisht, kur procesi ishte drejt përfundimit dhe mbetej vetëm faza e vendimmarrjes, mënyra se si subjekti ka zgjedhur të kontribuojë nëpërmjet veprimeve të ndërmarra prej tij, ilustron përpjekje për të mos lejuar përfundimin e procesit dhe jo bashkëpunim dhe vullnetin për të ushtruar të drejtat procedurale në mirëbesim e me transparencë. Prokura e paplotë, e cila në thelb u materializua në kërkitime të përsëritura, të mbivendosura dhe me të njëjtin objekt, shqyrtimi i disa prej të cilave kërkonte edhe shortim trupash të tjerë gjykues dhe kohë shtesë, vlerësohet nga trupi gjykues në drejtim të konkluzionit që subjekti ka zgjedhur me vetëdije të mos jetë i pranishëm në proces, duke përdorur mjete të ndryshme procedurale, të cilat kanë pasur për qëllim zgjatjen e procesit pa vendimmarrje.

8.11. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se është i pabazuar edhe pretendimi i subjektit se vendimi i Komisionit është i paarsyetuar. Në kushtet që subjekti nuk ka specifikuar në cilin aspekt arsyetimi ka mungesë, vlerësimi i këtij pretendimi u bazua kundrejt sa parashikon neni 57 i ligjit nr. 84/2016, që normon strukturën dhe përmbajtjen e një vendimi të Komisionit. Nga kjo analizë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vendimi objekt ankimi rezulton në përputhje me këtë dispozitë, me të gjitha pjesët përbërëse: hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese.²⁰ Edhe këto tri pjesë, në nënpjesët e tyre përmbajnë të gjitha rubrikat e parashikuara nga ligji. Së fundmi, në drejtim të

²⁰ "[2.] Vendimi përmban hyrjen, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe urdhëruese. 3. Hyrja e vendimit përmban: a) emërtimin zyrtar të Komisionit; b) trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen dhe punonjësin administrativ; c) orën dhe vendin e vendimit të dhënë; ç) emrin dhe identitetin e subjektit të rivlerësimit, si dhe përfaqësuesve të tij; d) mendimin e subjektit të rivlerësimit dhe/ose të përfaqësuesit të tij. 4. Pjesa përshkruese-arsyetuese përmban: a) rrethanat e çështjes, siç janë vlerësuar gjatë procesit, dhe përfundimet e nxjerra nga trupi gjykues; b) provat dhe arsyet mbi të cilat mbështeten vendimet; c) raportin dhe rekomandimin e relatorit; ç) dispozitat ligjore në të cilat mbështetet vendimi. 5. Pjesa urdhëruese, ndërmjet të tjerash, përmban: a) alternativën që ka vendosur trupi gjykues; b) nëse trupi gjykues ka vendosur të caktojë një masë disiplinore; c) të drejtën e ankimit dhe afatin për paraqitjen e tij."

përmbajtjes, në vendimin e Komisionit, janë të qarta arsyet mbi të cilat është mbështetur zgjidhja përfundimtare dhe baza mbi të cilën është marrë masa disiplinore. Fakti që ankimi i subjektit kundër këtij vendimi është 120 faqe, përpos 100 faqeve të parashtrimeve në Kolegj, nënkupton që arsyetimi ka përfshirë argumente, konkluzione dhe të dhëna të mjaftueshme. Për pasojë, arsyetimi i vendimit objekt ankimi *nuk* mund të argumentohet se nuk i ka ofruar subjektit qartësinë dhe transparencën që duhet të pasqyrohet në një vendim, dhe as që të mos i ketë mundësuar ushtrimin e së drejtës kushtetuese (e konventore) të ankimit. Për rrjedhojë, trupi gjykues vëren se ky pretendim është i pabazuar.

8.12. Subjekti pretendon që Komisioni ka caktuar seancën dëgjimore të datës 30.06.2021, pa pritur vendimin e trupit tjetër gjykues mbi kërkesën e subjektit për përjashtimin e një prej Komisionereve. Ky pretendim është i pambështetur në ligj. Nga leximi harmonik i dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, e konkretisht, dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative apo ato të Procedurës Civile, rezulton se, në çdo rast, një kërkesë për përjashtim ka efekt vetëm mbi procesin vendimmarrës,²¹ por jo mbi aspekte të tjera të menaxhimit të procesit, sikurse është caktimi i një date të seancës së radhës. Me vendimin e ndërmjetëm nr. {***}, datë 30.06.2021, Komisioni ka vendosur dërgimin e kërkesave për përjashtim, për shqyrtim nga një tjetër trup gjykues dhe vijimin e seancës dëgjimore, duke referuar edhe që vendimmarrja do të pezullohej në pritje të shqyrtimit të kërkesës së përjashtimit. Në kushtet që vendimmarrja rezulton të jetë kryer nga trupi gjykues, për të cilin ishin ezauruar të gjitha kërkesat për përjashtime të ngritura nga subjekti, nëpërmjet përfaqësuesve të tij ligjorë, caktimi i seancës së radhës, një javë më pas nga trupi gjykues, parë edhe në drejtim të kohës në dispozicion për të lejuar shqyrtimin e kërkesave, rezulton tërësisht në përputhje me përcaktimet e dispozitave ligjore të referuara më sipër, sikurse edhe me nevojat për menaxhimin e drejtë të ngarkesës së punës në rrethanat konkrete.

8.13. Pretendimi i fundit në funksion të së drejtës për mbrojtje efektive dhe të dëgjimit, është që Komisioni ka vepruar në kundërshtim me ligjin, kalimin në fazën e shpalljes së vendimit. Sipas subjektit, duke e vendosur ndryshimin e fazës procedurale në dhomë këshillimi, pa ia njoftuar atij, në seancën e datës 30.06.2021, Komisioni ka shkelur pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 46 të të njëjtit ligj. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se edhe ky pretendim është i pabazuar. Nga aktet në fashikull rezulton se seanca dëgjimore në fjalë është zhvilluar në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Shpallja e vendimit është shtyrë për një javë, në datën 07.07.2021, për shkak të tetë (8) kërkesave të ngritura nga përfaqësuesit e subjektit, në seancën e datës 30.06.2021, për përjashtime të dy anëtareve/komisionereve dhe të gjithë trupit gjykues.

8.14. Me vendimin e ndërmjetëm nr. {***}, datë 30.06.2021, trupi gjykues që ka kryer rivlerësimin, ka vendosur dërgimin e kërkesave për përjashtimin e anëtareve të trupit gjykues për shqyrtim nga një trup tjetër gjykues, si dhe ndalimin e anëtarëve për të marrë pjesë në dhënien e vendimit, derisa të jepej vendimi lidhur me kërkesën e përjashtimit. Ky vendim është komunikuar në seancë, në praninë e përfaqësuesve të subjektit. Kjo nënkupton që subjekti ka qenë objektivisht në dijeni që arsyeja e vetme që nuk ka lejuar marrjen e vendimit përfundimtar në atë datë, ka qenë shqyrtimi i kërkesave të tij për përjashtimin e anëtarëve të trupit gjykues. Po ashtu, referuar procesverbalit të asaj seance, kryesuesja e

²¹ Konkretisht, neni 31 pika 4 i K.Pr.Administrative parashikon që: “[4] Në çdo rast, deri në marrjen nga eprori të një vendimi përfundimtar, nëpunësi pezullohet nga procesi vendimmarrës.” Ndërsa neni 75, paragrafi i fundit i Kodit të Procedurës Civile parashikon që: “[...] grykimi nuk pezullohet, por gjyqtari nuk mund të japë ose të marrë pjesë në dhënien e vendimit, derisa të jepet vendimi që e deklaron të papranueshme ose që e rrëzon kërkesën e përjashtimit.”

trupit gjykues është shprehur: “[...] tashmë do të ishte fjala e subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit në fakt është njoftuar rregullisht me anë të postës elektronike. Siç tha edhe relatorja, ai i ka dërguar shpjegimet e tij edhe me shkrim, kështu që kjo seancë përfundon këtu, tani. Seanca tjetër rifillon më datë 07.07.2021, ora 09.30, në po në të njëjtën sallë. [...]”.

8.15. Nga ky procesverbal rezulton se, pavarësisht se fjala “shpallje” nuk është referuar tekstualisht, në rrethanat në fjalë – e konkretisht, që rezultatet e hetimit ishin referuar, subjekti ishte njohur me to dhe kishte dorëzuar edhe prapësimet – vendimmarrja përfundimtare mbetet i vetmi hap procedural për atë trup gjykues, bashkë me datën kur ai vendim do të shpallej.²² Po ashtu, duke abstraguat nga natyra abuzive e kërkesave të subjektit në seancën e datës 30.06.2021,²³ në kushtet që kërkesat e subjektit për përjashtime ishin të përsëritura, të ngritura në përfundim të procesit e përpos dy zgjatjeve të mëparshme afatesh, subjekti duhet të kishte, objektivisht, pritshmërinë e probabilitetit që trupi gjykues mund të vijonte i njëjti, e për pasojë, do të shpallte vendimin. Për këto arsye, edhe printimi i faqes zyrtare të Komisionit, me të cilin subjekti pretendon të provojë se Komisioni ka shkelur të drejtat e tij për proces të rregullt, paraqitur si provë për kalimin procedural nga seancë dëgjimore në seancë shpallje vendimi, nuk vërteton faktin që njoftimi final ka qenë ai për seancë dëgjimore, sikundër pretendohet. Nga verifikimi në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, rezulton i pasqyruar njoftimi se seanca e datës 7 korrik 2021 do të vijonte me shpallje vendimi²⁴. Kjo procedurë vjen në përputhje me parashikimin e nenit 55, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, që përcakton se në fund të seancës dëgjimore, që është konsideruar në vijim, shpallet vendimi.

9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se i është shkelur e drejta për t’u gjykuar nga një gjykatë e krijuar me ligj, për shkak se dy prej anëtarëve të trupit gjykues në Komision nuk përmbushin kriteret e zgjedhshmërisë dhe sepse ai (trupi gjykues) ka ushtruar njëkohësisht funksione të spektrit hetimor dhe të spektrit gjyqësor. Të dyja këto pretendime janë të pabazuara; ato janë trajtuar gjerësisht në vendime të mëparshme të Kolegjit, sikurse edhe kanë gjetur shtjellim të elaboruar në çështjen kyç të GjEDNJ-së “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”. Për këtë arsye, pa u ndalur gjerësisht, trupi gjykues çmon të rikonfirmojë sa është trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit²⁵ për kriteret e zgjedhshmërisë të anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit, nën dritën e natyrës *sui generis* të procesit të rivlerësimit dhe qëllimit të ligjvënësisë për të zgjedhur procedura të mirëpërcaktuara nga Aneksi i Kushtetutës dhe ligji i posaçëm nr. 84/2016. Po ashtu, edhe shkaqet e ankimit që lidhen me mënyrën se si është konceptuar të funksionojë Komisioni, sikurse elaboruar gjerësisht në vendimet e Kolegjit,²⁶ ka kaluar testin e kushtetutshmërisë

²² Nga aktet në fashikull rezulton se trupi gjykues i themelit në Komision është njoftuar në datën 06.07.2021, nëpërmjet email-it për mospranimin e kërkesave për përjashtimin e dy anëtarëve të trupit gjykues, si dhe mospranimin e kërkesës për përjashtimin e të gjithë trupit gjykues. Pas këtij njoftimi, trupi gjykues i themelit, me vendimin nr. {***}, datë 06.07.2021, vijoi me procesin e vendimmarrjes, duke urdhëruar njëkohësisht edhe pasqyrimin në faqen zyrtare të Komisionit të vijimit të seancës me shpalljen e vendimit. Në të njëjtën datë, subjekti i rivlerësimit është njoftuar, përmes postës elektronike, për mospranimin e kërkesave të depozituara prej tij, për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues.

²³ Referuar në detaj në paragrafët 8.7 dhe 8.8 dhe poshtëshënimin nr.13, të këtij vendimi.

²⁴ Edhe nga aktet në fashikull rezulton se trupi gjykues i Komisionit ka urdhëruar pasqyrimin e këtij hapi procedural në faqen zyrtare.

²⁵ Vendimi nr. 43/2022 (JR), paragrafi 14.2. i-iv, që i përket s. r. H. M., vendimi nr. 3, datë 06.02.2023, prg. 10.1.1, ndaj s. r. T. H. etj.

²⁶ Trajtuar gjerësisht në vendimin nr. 8 (JR), datë 09.03.2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ndaj s. r. I. M., vendimin nr. 43 (JR), datë 15.11.2022, ndaj s. r. H. M., vendimin nr. 3 (JR), datë 06.02.2023, ndaj s. r. T. H. etj.

nga Gjykata Kushtetuese dhe të përputhshmërisë me parimet konventore të procesit të rregullt, sipas nenit 6 të KEDNj-së.

10. Argumenti tjetër i subjektit, që trupi gjykues i Komisionit nuk përmbushte kërkesat e një gjykate të pavarur e të paanshme, në kuptim të nenit 6/1 të Konventës dhe nenit 42 të Kushtetutës, bazohet në pretendimin që dy prej anëtareve të trupit gjykues ndodheshin në kushtet e konfliktit të interesit për të shqyrtuar çështjen e tij të rivlerësimit. Konkretisht, sipas këtij pretendimi, Komisionerja Sanxhaktari ka lidhje miqësore me një drejtues televizioni kombëtar, me të cilin subjekti ka konflikte penale, për shkak të kronikave që transmetonte televizioni në fjalë kundër subjektit, në më shumë se një rast. Po ashtu, vijon subjekti, e njëjta Komisionere është në konflikt interesi me të, pasi në vitin 2004, ajo ka qenë pjesë e një grupi auditues në një hetim administrativ të nisur asokohe nga Kryeministria, ndaj babait të subjektit. Subjekti potencon edhe që, meqenëse ai ka depozituar kallëzim penal në prokurori ndaj dy Komisionereve, Sanxhaktari dhe Çiftja, ato gjenden në kushtet e konfliktit të interesit edhe për shkak të këtij veprimi procedural të tij. Bashkë me parashtrimet në Kolegj, subjekti ka sjellë disa akte (vendime gjykatash të përmbledhura në pjesën hyrëse të vendimit) në mbështetje të këtij pretendimi. Së fundmi, subjekti pretendon se Komisioni ka kryer shkelje të rënda procedurale, duke mos e vënë atë në dijeni për vendimet e marra për kërkesat e tij për përjashtime.

10.1. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se edhe ky grup pretendimesh rezulton i pabazuar dhe në funksion të përpjekjeve që subjekti ka kryer për të parandaluar e pamundësuar vendimmarrjen e Komisionit. Po ashtu, në kushtet që nga aktet rezulton se Komisioni e ka njoftuar subjektin në çdo hap me vendimet e ndërmjetme të marra në përgjigje të kërkesave të tij (të përsëritura), edhe pretendimi i tij për shkelje të rëndë procedurale është i pabazuar në fakte. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

10.2. Së pari, sikurse referuar edhe më sipër, subjekti ka ngritur kërkesa e pretendime me synim ndryshimin e pjesshëm apo të plotë të trupit gjykues të Komisionit, në disa raste gjatë hetimit administrativ. Nga aktet rezulton që të gjitha kërkesat e paraqitura në datat: 07.06.2021, 23.06.2021 dhe 30.06.2021, janë shqyrtuar nga trupa të tjerë, të shortuar posaçërisht për këtë qëllim, në përputhje me parashikimet e nenit 27 të ligjit nr. 84/2016 dhe vendimet janë të arsyetuara e të bazuara. Subjekti i rivlerësimit është njohur me to në seancë publike, me *email* apo edhe me akte të dërguara nëpërmjet shërbimit postar. Ç'është më e rëndësishme, në asnjë prej këtyre rasteve nuk mund të argumentohet se subjektit i është cenuar e drejta e ankimit, në kushtet që vendimet për përjashtimin e gjyqtarëve, sipas ligjit procedural civil, ankimohen së bashku me vendimin përfundimtar,²⁷ në këtë rast, në Kolegj. Sikurse konfirmon në vetvete ky arsyetim i Kolegjit, subjekti e ka ushtruar të drejtën e ankimit. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit për shkelje të rënda procedurale, që konsistojnë në mosnjoftimin e vendimeve të ndërmjetme të arsyetuara, apo që ky hap i procesit ka cenuar të drejtën e tij për ankimin e tyre në Kolegj, janë të pabazuara, por edhe të pakuptimta.

10.3. Duke iu rikthyer pretendimit tjetër, subjekti ka kërkuar përjashtimin e Komisioneres Sanxhaktari për shkak të mospërmbushjes së kriterëve të zgjedhshmërisë, konfliktit të interesit dhe për shkak të kallëzimit penal të depozituar nga subjekti ndaj saj në SPAK. Në vijim të arsytimit të mësipërm për

²⁷Fjalja e dytë e paragrafit të parë të nenit 75 të Kodit të Procedurës Civile: “[...] Ndaj vendimit për pranimin ose rrëzimin e kërkesës për përjashtim lejohet ankim së bashku me vendimin përfundimtar. [...]”

kriteret e zgjedhshmërisë, trupi gjykues e çmon të konfirmojë vetëm që vendimi i Komisionit, nëpërmjet të cilit janë rrëzuar kërkesat e subjektit për këtë aspekt, është i drejtë. Po ashtu, trupi gjykues i Kolegjit vëren se konkluzioni i Komisionit është i drejtë edhe për sa i përket mungesës së konfliktit të interesit nga kjo Komisionere, për secilin prej aspekteve të potencuara nga subjekti.

10.4. Së pari, trupi gjykues i Kolegjit vëren që thjesht njohjet shoqërore të një komisioneri/komisionereje apo anëtari të trupit gjykues, nuk mund të argumentohen si shkak serioz njëanshmërie në një proces administrativ²⁸ apo gjyqësor me palë të treta. Koncepti i marrëdhënies së miqësisë si shkak për konflikt interesi, sipas ligjit nr. 9367/2005²⁹, lidhet dhe kufizohet në marrëdhënien mes *palës* në një proces administrativ – subjektit të rivlerësimit në këtë rast – dhe një *zyrtari* vendimmarrës – Komisionerja Sanxhaktari në këtë rast. Më fjalë të tjera, normativa ligjore e vendosur për të mënjeluar konfliktet e mundshme të interesit nuk ka për synim të përfshijë në kontroll edhe rrethin miqësor të zyrtarit/funksionarit publik. Përpos këtij konstatimi, lloji i mbulimit që kryen një mjet informimi publik, bazuar në politikën editoriale, dhe subjektivizmi me të cilin automatikisht shoqërohet perceptimi për mënyrën se si pasqyrohen ngjarjet, jo vetëm janë jashtë fokusit të procesit të rivlerësimit të subjektit, por e bëjnë edhe të pamundur argumentimin racional në një proces gjyqësor të këtij lloji për konfirmimin e ekzistencës së shkaqeve serioze të njëanshmërisë. Për rrjedhojë, duke abstraguuar nga parimi i lirisë së shprehjes, fakti që një televizion ka kryer raportime mediatike, me të cilat subjekti nuk është dakord apo i percepton si negative për të, është e pamundur të provojë ekzistencën e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës nga Komisionerja, meqenëse kjo e fundit pretendohet se ka lidhje miqësore me drejtuesin e tij (televizionit).

10.5. Në një arsyetim të ngjashëm, pjesëmarrja për shkak të detyrës në një auditim të një të afërmi, të një pale në një proces administrativ, nuk mund të argumentohet si shkak serioz njëanshmërie për një funksionar publik/komisioneren në vendimmarrjen në rivlerësim pas 17 vitesh. Subjekti nuk pretendon e as ka provuar zhvillime me pasoja negative për shkak të këtij auditimi; edhe nëse do të ekzistonin, ato do të ishin në kahun *e kundërt*. E thënë ndryshe, marrëdhënia e mundshme e armiqësisë/konfliktit do të ishte *kundër* Komisioneres nga subjekti e të afërmit e tij, dhe jo e anasjellta. Si rrjedhojë, edhe analizuar në këtë aspekt, pretendimi për konflikt interesi i Komisioneres Sanxhaktari në ushtrimin e detyrës është i pabazuar.

10.6. Së fundmi, subjekti ka kërkuar përjashtimin e Komisioneres Sanxhaktari edhe meqenëse ai ka depozituar kallëzim penal në prokurori kundër saj. Sikurse ka konstatuar edhe Komisioni, kallëzimi penal, i cili në thelb përmban argumentet, të cilat më herët ishin pjesë e kërkesave për përjashtim, është depozituar në përfundim të procesit të rivlerësimit, përpara se Komisioni të shpallte vendimin përfundimtar³⁰. Duke mbajtur në konsideratë qoftë sa rezulton nga përmbajtja, momentin kur kallëzimi është depozituar dhe gjithë sa është konstatuar më sipër për qasjen e subjektit në procesin e rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi edhe këtë procedim penal si një ndër përpjekjet e gjithanshme që ka kryer subjekti për të zvarritur procesin e rivlerësimit.

²⁸ Në kuptim të nenit 30, germa “g” të Kodit të Procedurave Administrative dhe/ose nenit. 72 e 73 të Kodit të Procedurës Civile.

²⁹ Neni 3, pikat 1 dhe 4, gerrat “a”, “b” dhe “c”.

³⁰ Nga aktet në fashikull, referuar vendimit nr. {***}, datë 03.12.2021, cituar në poshtëshënimin 31, kallëzimi mban datën 02.07.2021.

10.7. Pa përsëritur analizën e detajuar më sipër, përse *asnjë* prej rrethanave të potencuara nga subjekti nuk përbën *shkak ligjor* për të konstatuar ekzistencën e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës nga Komisionerja Sanxhaktari, trupi gjykues i Kolegjit konstaton që vendimi i Komisionit, për të mos e pranuar këtë element si shkak përjashtimi, është i bazuar. Një vendimmarrje e ndryshme nga Komisioni do të kishte pasur efekt negativ për procesin e rivlerësimit të subjektit, por edhe në vijimësinë e procesit në tërësi. Me fjalë të tjera, nëse Komisioni do të pranonte si shkak përjashtimi kallëzime penale të bazuara në pretendime të konstatuara në mënyrë shteruese nga organet e rivlerësimit si të pambështetura në ligj, vullneti i kushtetutëbërësit për proces rivlerësimi nuk do të mund të përmbushej. Mungesa e bazueshmërisë ligjore të këtij kallëzimi penal reflektohet edhe në vendimin me të cilin gjykatat³¹ kanë arsyetuar për të rrëzuar përpjekjet e subjektit për të filluar procedim penal ndaj Komisioneres Sanxhaktari.

10.8. Arsyetimi i mësipërm mbi kriteret e zgjedhshmërisë, sikurse edhe mungesën e konfliktit të interesit në ushtrimin e detyrës vlen edhe për shkaqet e ankimit, që lidhen me kërkesën e subjektit për përjashtimin e Komisioneres Etleda Çiftja. Pa përsëritur sa është arsyetuar gjerësisht më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se vendimi i Komisionit është i bazuar, për cilindo prej këtyre aspekteve. Edhe në këtë rast, kallëzimi penal i subjektit të rivlerësimit nëpërmjet përfaqësuesit të tij ligjor është ngritur *në përfundim* të procesit të rivlerësimit, përpara vendimmarrjes përfundimtare. Për të gjitha këto shkaqe dhe në vijim të analizës së mësipërme, edhe kërkesa për përjashtimin e kësaj Komisionereje u vlerësua nga trupi gjykues si pjesë e panoramës së veprimeve të kryera nga subjekti dhe përpjekjeve për të abuzuar me mjete të ndryshme ligjore dhe zgjatur/penguar procesin e tij të rivlerësimit. Përpos sikurse arsyetuar më sipër, për vlerësimin përse procedimi penal nuk e vendos këtë Komisionere në kushtet e konfliktit të interesit, trupi gjykues vëren si rrethanë shtesë (*obiter dictum*) faktin që edhe gjykatat e të dyja shkallëve e kanë konstatuar në thelb pretendimin e subjektit të pambështetur.³²

10.9. Së fundmi, mbi bazën e kallëzimeve të referuara më sipër, subjekti ka kërkuar pezullimin e procesit të rivlerësimit në Komision. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe kjo kërkesë rezulton e pambështetur në ligjin nr. 84/2016, i cili nuk parashikon pezullim të procesit të rivlerësimit dhe kushtëzim të tij nga procese të tjera. Duke patur parasysh natyrën e procesit të rivlerësimit, të kufizuar në kohë, është e qartë përse ligji ka parashikuar që procesi i rivlerësimit të zhvillohet në mënyrë autonome si rregull dhe pa u kushtëzuar nga procese të tjera të juridiksionit të zakonshëm, të cilat mund edhe të sfidonin qëllimin për të cilin është vendosur një afat nëntëvjeçar.

10.10. Për më tepër, kjo kërkesë e subjektit është e pambështetur edhe në dispozitat procedurale civile apo në ato administrative. Konkretisht, neni 297, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile³³ dhe neni 66

³¹ Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (me vendimin nr. {***}, datë 03.12.2021) ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (nr. {***}, datë 24.09.2021) dhe rrëzuar kërkesën e subjektit të rivlerësimit për prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal nr. {***}/2021, në ngarkim të B. B. dhe Valbona Sanxhaktari. Sipas arsyetimit të Gjykatës së Posaçme të Apelit, në faqet 10 dhe 11: “[...] takimet e Komisioneres Valbona. Sanxhaktari me shtetasin B. B., nuk janë indicie të mjaftueshme për ta vlerësuar këtë marrëdhënie të tillë, që e vendos Komisioneren në kushtet e konfliktit të interesit për të mos qenë në përbërje të trupit gjykues të Komisionit apo për të menduar që vota e saj ka qenë pasojë e interesit personal [...]”.

³² Gjykata e Posaçme e Apelit, me vendimin nr. {***}/2023, ka lënë në fuqi vendimin nr. {***}, datë 16.09.2022, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me të cilin Komisionerja Çiftja është deklaruar e pafajshme. Depozituar me parashtrimet e subjektit në Kolegj.

³³ “Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur: a) çështja nuk mund të zgjidhet para se të zgjidhet një çështje tjetër penale, civile ose administrative [...]”.

i Kodit të Procedurave Administrative,³⁴ të lexuara në harmoni, lejojnë pezullimin e një gjykimi/procedure administrative vetëm kur evidentohen çështje, pa zgjidhjen e të cilave nuk mund të procedohet në konfliktin civil apo në procesin administrativ, si parakushte që determinojnë mënyrën se si gjykata/organi administrativ do të zgjidhin çështjen në shqyrtim. Pa përsëritur sa është arsyetuar më sipër, përpos materializimit në përfundim të procesit të rivlerësimit për subjektin, kallëzimet në fjalë përmbajnë shkaqe, të cilat lidhen me anëtarët e trupit gjykues dhe jo me çështje konkrete të rivlerësimit të vetë subjektit të rivlerësimit. Thënë ndryshe, këto dispozita mund të gjenin zbatim në rast se për ndonjë pasuri konkrete të subjektit të rivlerësimit do të rezultonte se po zhvillohej njëkohësisht një proces tjetër gjyqësor apo administrativ, rezultati i të cilit afektonte drejtpërdrejt zgjidhjen e çështjes në Komision.

10.11. Në parashtrimet shtesë të depozituara në Kolegj, subjekti ngre pretendimin se procesi i tij i rivlerësimit ka qenë “torturues, denigrues dhe poshtërues” për të dhe familjen, në shkelje të parimeve të sanksionuara në KEDNJ, e konkretisht atyre të parashikuara nga neni 3, “Ndalimi i torturës”, neni 8, “E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare” dhe neni 14, “Ndalimi i diskriminimit”. Subjekti nuk ka specifikuar veprimet konkrete gjatë procesit të hetimit administrativ në Komision, që kanë përbërë torturë, kanë qenë denigruese apo poshtëruese për të dhe familjen. Në kushtet që nga aktet në fashikull nuk rezulton asnjë e dhënë dhe indicie që mund të vlerësohej edhe indirekt si ilustrim i këtyre pretendimeve, trupi gjykues i Kolegjit i analizoi këto pretendime në nivel teorik. Në këtë funksion, përpos konstatimit të veprimeve abuzive të kryera nga vetë subjekti në procesin e rivlerësimit, trupi gjykues vëren se procesi i kryer për subjektin ka qenë në përputhje të plotë me garancitë kushtetuese, konventore e ligjore për rivlerësimin. Ai ka pasur komunikim të rregullt me Komisionin, ka sjellë prova e shpjegime, i janë dhënë mundësitë për t’u dëgjuar e mbrojtur dhe ka përfutur disa herë edhe nga shtesa në kohë, sipas kërkesave të tij. Afatet kanë qenë të arsyeshme dhe prej tyre nuk rezultojnë rrethana që sugjerojnë diskriminim, përkundrazi. Në njërën nga seancat, subjektit i është dhënë shtesë kohe, në kushtet që pretendoi pamundësinë e tij për pjesëmarrje, për shkaqe shëndetësore. Edhe komunikimet e Komisionit me subjektin rezultojnë të kenë qenë korrekte. Për gjithë këto arsye, edhe ky pretendim i subjektit rezulton i pabazuar.

10.12. Në vijim të sa arsyetuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se procesi i rivlerësimit për subjektin është kryer në përputhje me kuadrin kushtetues, konventor dhe ligjor të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nga ana tjetër, në vlerësimin tërësor të procedurave sipas parashikimit të nenit 4, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar një sjellje korrekte dhe bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit, është i bazuar. Ndërsa është e drejtë kushtetuese e subjektit të paraqesë kërkesat procedurale të nevojshme, aktet në fashikull dhe kronologjia e dinamika e veprimeve, sikurse edhe pohimet e përfaqësuesve të tij ligjorë, tregojnë për përpjekje të kryera në kufijtë e abuzivizmit. Veprimet e subjektit të rivlerësimit, qartazi, nuk duken të synojnë zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, por zvarritjen e këtij procesi, deri në pamundësimin e tij. Në këtë drejtim dhe nën dritën e nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 u vlerësuan edhe në Kolegj kërkesat e përsëritura dhe haptazi të pabazuara të subjektit gjatë procesit, e sidomos, në fazën finale të përmbylljes së hetimit administrativ në Komision.

³⁴ “1. Nëse organi publik që zhvillon procedurën përballet me një çështje, zgjidhja e së cilës është parakusht për zgjidhjen e procedurës dhe që përbën një çështje ligjore të pavarur, për zgjidhjen e së cilës është kompetent një gjykatë ose organ tjetër (“çështja paraprake”), organi publik që zhvillon procedurën administrative pezullon procedurën deri në marrjen e një vendimi të formës së prerë për çështjen paraprake dhe njofton palën në lidhje me këtë. [...]”

B.2. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e pasurisë

B.2.1. Shkaqe të përgjithshme që lidhen me aspektin procedural e ligjor të hetimit dhe vlerësimit të kriterit të pasurisë

11. Subjekti pretendon se Komisioni ka kryer hetim të paplotë, pa marrë prova dhe duke mos i analizuar ato që ai ka depozituar. Vendimi i Komisionit për kriterin e pasurisë është i pambështetur në ligj. Sipas tij, Komisioni është mbështetur vetëm në raportin e ILDKPKI-së, pa administruar akte nga institucione të tjera publike. Komisioni nuk ka pranuar kërkesën e subjektit për thirrjen e ekspertit të zgjedhur prej tij dhe ballafaqimin e tij me ekspertin e Komisionit, që ka kryer analizën financiare. Pas kalimit të barrës së provës, Komisioni nuk e ka njoftuar atë se cilat prova nuk u pranuan dhe arsyet për mospranimin.

11.1. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se këto pretendime janë të pabazuara. Së pari, aktet tregojnë qartë që Komisioni ka kryer hetim të pavarur, përpos administrimit të raportit të ILDKPKI-së, duke marrë prova, siç rezulton ndër të tjera, nga korrespondenca me OShEE-në, UKT-në, ASHK-në, bankat etj. Kjo duket qartë edhe nga fakti që në vendimin objekt ankimi janë analizuar provat e administruara, përfshirë edhe ato të sjella nga subjekti i rivlerësimit në pyetësorë dhe aktin e ekspertimit financiar, ndër të tjerë.³⁵ Ky i fundit është referuar konkretisht të jetë administruar me vendim të ndërmjetëm dhe më tej është analizuar në vendim.³⁶ Nga ana tjetër, Komisioni ka refuzuar ta thërrasë ekspertin financiar në fjalë si dëshmitar, duke mbajtur në konsideratë që dëshmia e tij do të ishte e panevojshme në kushtet që rezultatet e aktit të ekspertimit financiar ishin administruar si provë nga Komisioni.³⁷ Ky vendim i është njoftuar subjektit nëpërmjet postës elektronike.³⁸

11.2. Pretendimi se Komisioni, pas kalimit të barrës së provës, nuk e ka njoftuar subjektin nëse pranoi shpjegimet e dhëna apo arsyet e mospranimit, është i pabazuar në dispozitat e ligjit nr. 84/2016, që përcaktojnë rregullat e përgjithshme të hetimit të çështjes. Konkretisht, në nenin 45 e vijues, ligji nuk parashikon detyrim të Komisionit për t'u shprehur me vendim të ndërmjetëm për çdo provë e shpjegim të paraqitur nga subjekti. Po ashtu, neni 52 përcakton mënyrën se si procedohet pasi Komisioni i kalon subjekteve barrën e provës, sikurse edhe mundësinë e këtyre të fundit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit me prova ose shpjegime të tjera. Analiza e këtyre provave e shpjegimeve përbëjnë bazën mbi të cilën Komisioni mbërrin në vendimin përfundimtar. Fakti që Komisioni ka dalë në një qëndrim ndryshe nga ai i subjektit, nuk dëshmon mungesë të analizës dhe vlerësimit të provave nga Komisioni, por një analizë që konkludohet me një qëndrim të ndryshëm nga ai i subjektit.

11.3. Nga ana tjetër, nëse ndiqet logjika e pretenduar nga subjekti, që për çdo akt, pretendim a kërkesë të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni të dilte me një rezultat paraprak hetimi, procesi i rivlerësimit mund të mos përfundonte, i kushtëzuar nga shterimi i kërkesave për prova, shpjegime e dëshmitarë që

³⁵ Ndër të tjera, mandatarëkëtimet që subjekti ka depozituar si provë në përgjigje të pyetësorit nr. 2, aktet e sjella me pyetësorin nr. 3 (dy deklarata noteriale, nga G. N. dhe A. Gj.), si dhe dokumentacionin për të ardhurat e punësimit për këtë të fundit apo aktin e ekspertimit, administruar me vendim të ndërmjetëm të datës 18.06.2021.

³⁶ Shih pikat 29.1, 41.2, 41.3 të vendimit objekt shqyrtimi.

³⁷ Komisioni, në vendimin nr. {***}, datë 18.06.2021, shprehet se: "[...] e ka administruar në cilësinë e provës këtë akt ekspertimi dhe do ta vlerësojë atë në harmoni me provat e tjera [...] dhe shpjegimet [...]. Pra, duket se nëpërmjet kësaj dëshmie, subjekti kërkon të provojë rezultatet e aktit të ekspertimit financiar, të administruar tashmë si provë nga Komisioni".

³⁸ Email, datë 25 qershor 2021, ora 11:24.

do të zgjidhnin subjektet. Kjo qasje do të binte ndesh me qëllimin e krijimit të sistemit të rivlerësimit – rikthimi i besimit të publikut te drejtësia – sikurse edhe me natyrën kalimtare dhe me afat kohor të kufizuar për kryerjen e këtij procesi, por edhe me dispozitat që rregullojnë procedurat administrative, të cilat përcaktojnë një diskrecion të qartë të organeve administrative për të kryer me efikasitet³⁹ dhe brenda afatesh të mirëpërcaktuara proceset e ngarkuara atyre. Me fjalë të tjera, nëse organet e rivlerësimit do të hartonin rezultate hetimi pas administrimit të çdo akti e shpjegimi dhe subjektet do të kishin afat të papërcaktuar për të sjellë kundërshtime, prova e kërkesa për dëshmitarë, procesi i rivlerësimit do të ishte i pamundur të kryhej.

11.4. Së fundmi, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka kryer keqinterpretim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke e konstatuar atë (subjektin) në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm. Sipas tij, kjo dispozitë do të ishte e zbatueshme vetëm nëse vërtetohet në mënyrë kumulative për deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe atë të figurës; po ashtu, Komisioni ka interpretuar në mënyrë të gabuar nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, pasi subjekti nuk ndodhet në kushtet e dyfishit të pasurisë së ligjshme, të fshehjes së pasurisë dhe nuk ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kontrollin e figurës.

11.5. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimi i mësipërm i subjektit, tashmë, është elaboruar gjerësisht në jurisprudencën e Kolegjit ndër vite,⁴⁰ pasi është ngritur nga një numër i konsiderueshëm subjektsh rivlerësimi, në terma e qasje identike. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit çmon të rikonfirmojë, si edhe në vendime të tjera, se pretendimi i subjektit është i pabazuar në ligj, pasi shkaqet që passjellin marrjen e masës disiplinore janë autonome dhe jo të kushtëzuara nga njëra-tjetra. Kjo duket qartë edhe nga fakti që nene të ndryshme të Aneksit të Kushtetutës përkojnë me nënpjesë e situata të përcaktuara në nenin 61. Deklarimi i dyfishit të pasurisë është vetëm një ndër gjashtë (6) situatat, për të cilat mund të merret masa disiplinore, ajo në të cilën organet e rivlerësimit nuk kanë diskrecion përpos shkarkimit automatik. Kjo mënyrë leximi e interpretimi e organeve të rivlerësimit ka kaluar tashmë edhe testin e kontrollit të kryer nga GjEDNj-ja, duke nisur nga çështja kyç “Xhoxhaj kundër Shqipërisë”, ndër të tjera, e cila ka lënë në fuqi vendimet e Kolegjit bazuar në këtë interpretim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se ky shkak ankimi është i pabazuar.

B.2.2. Shkaqet e ankimit që lidhen me vlerësimin e pasurisë

12. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në kontrollin e kriterit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, që ka passjellë masën disiplinore “të shkarkimit”, Komisioni nuk ka përfshirë e as është bazuar në pasuritë e

³⁹ Ndër të tjerë, neni 53 i ligjit nr. 44/2015, “Përcaktimi dhe shtyrja e afateve procedurale 1. Afatet për kryerjen e një veprimi procedural nga palët, të quajtura në vazhdim “afatet procedurale”, përcaktohen nga ligji ose aktet nënligjore. 2. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit. 3. Afati procedural i caktuar nga ligji ose aktet nënligjore mund të zgjatet vetëm nëse kjo parashikohet shprehimisht nga ligji ose akti nënligjor, ndërsa afati i caktuar nga organi publik mund të zgjatet me kërkesë të justifikuar të palës së interesuar, të paraqitur përpara mbarimit të afatit”.

⁴⁰ Shih vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit: nr. 19/2019, paragrafi 22.15, që i përket subjektit Xh. Z.; nr. 1/2021, paragrafi 20-20.1, që i përket subjektit A. S.; nr. 16/2022, paragrafi 23, për subjektin M. V.; nr. 33, datë 29.07.2022, paragrafi 19, për subjektin A. Xh. etj.

deklaruar nga personi i lidhur/bashkëshortja e tij⁴¹. Në këtë qasje, Komisioni ka mbajtur në konsideratë momentin e krijimit pasurive dhe atë të lidhjes së martesës ligjore, si dhe në kushtet që personi i lidhur/bashkëshortja, po ashtu subjekt rivlerësimi, i është nënshtruar një procesi të pavarur nga një tjetër trup gjykues⁴². Në përfundim të kontrollit të kryer në këtë mënyrë, Komisioni ka konkluduar që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë kryer deklarim të pasaktë dhe të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit pasuror dhe janë në kushtet e mungesës të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e një *apartamenti* në Tiranë dhe kryerjen e shpenzimeve *ndër vite*. Në vijim shtjellohet vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për shkaqet e ankimit të grupuara në funksion të këtyre dy drejtimeve.

*I. Apartamenti në rrugën “{***}”, Tiranë, blerë me çmimin 8.2 milionë lekë*

12.1. Subjekti e ka deklaruar këtë pasuri në deklaratën *vetting*, në pjesë takuese të barabarta me personin e lidhur/bashkëshorten, dhe që apartamenti është porositur me kontratë sipërmarrjeje të tetorit të vitit 2011. Si burime krijimi janë deklaruar një kredi bankare, prej 5 milionë lekësh dhe 1 milion lekësh, si dhe kursimet familjare e personale ndër vite. Subjekti ka deklaruar se *e gjithë* shuma (8.2 milionë lekë) është shlyer në harkun kohor prej 1.10.2011 deri në 28.11.2011, në tri këste⁴³. Pasi ka hetuar për mënyrën dhe kohën e fitimit të pasurisë dhe pagesat e kësteve, dhe ndonëse ka përdorur shprehjen “fshehje” të pagesës së kështit të parë dhe ka konstatuar probleme në lidhje me një kredi të marrë në kushte lehtësuese nga bashkëshortja, Komisioni nuk ia ka ngarkuar subjektit këto dy aspekte në pikën fundore të konkluzionit për kontrollin e tij të pasurisë. Përfundimisht, Komisioni ka konkluduar për pasaktësi në deklarimin e burimit të krijimit të kështit të parë dhe për mungesë të burimeve të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e pasurisë objekt vlerësimi, sipas parashikimeve të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016. E thënë ndryshe, pavarësisht se çfarë referohet gjatë vendimit, në vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, momenti i pagesës së kështit të parë apo ndryshimi i destinacionit të kredisë nga bashkëshortja, nuk kanë marrë asnjë peshë në vlerësimin fundor për kriterin pasuror për subjektin.

12.2. Subjekti i rivlerësimit e kundërshton këtë konkluzion nëpërmjet ankimit, duke pretenduar se ka deklaruar saktë pasurinë e tij dhe se nuk gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për krijimin e saj. Ai potencon po ashtu, se nuk është sanksionuar asnjëherë nga ILDKPKI-ja ndër vite. Vendimmarrja për pamjaftueshmëri në deklarim duhet të mbështetet në konkluzionet e ekspertëve. Akti i ekspertimit kontabël, porositur nga ai për të ardhurat, konfirmon se subjekti ka pasur burime të ligjshme për krijimin e pasurive.

12.3. Nga analiza e akteve në fashikull, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit janë të pabazuara. Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar saktë mënyrën e krijimit të kësaj pasurie, në kushtet që burim krijimi i kësaj pasurie nuk ka qenë *kredia* në kushte lehtësuese e përfituar, por revokimi i kontratës së sipërmarrjes për një apartament

⁴¹ (i) *Apartament banimi, me sipërfaqe 57 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë*; (ii) *truall me sip. 300 m², nga kjo 100 m² ndërtesë, ndodhur në {***}, Berat, viti i krijimit 1997*; (iii) *dy sipërfaqe toke prej 2.400 m² dhe 3.850 m² dhe një ullishte prej 275 m², ndodhur në të njëjtin fshat të Beratit, përfituar me ligjin nr. 7501, “Për tokën”.*

⁴² Paragrafi 40.7 i vendimit të Komisionit.

⁴³ Konkretisht, subjekti ka deklaruar se janë kryer pagesat si vijon: në momentin e lidhjes së kontratës, në 01.10.2011 janë paguar 5.000.000 lekë, në 25.10.2011 janë paguar 2.000.000 lekë dhe në 28.11.2011 është shlyer shuma e fundit, prej 1.200.000 lekësh dhe palët kanë deklaruar përfundimin e detyrimeve me njëri-tjetrin.

në Berat. Po ashtu, edhe në vlerësimin e kryer për analizën financiare dhe ligjore të kryer nga Komisioni në Kolegj, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur, edhe në Kolegj, rezultuan në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pagesën e kështit të dytë dhe të tretë të saj. Këto rrethana e kualifikojnë subjektin e rivlerësimit sipas nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016. Nga ana tjetër, problematikat të cilat Komisioni, pavarësisht konstatimeve, nuk i ka shoqëruar me një konkluzion penalizues për subjektin, në funksion të konstatimit për deklarim të pasaktë të pasurisë prej tij, rezultuan jopërcaktuese për masën disiplinore. Këto aspekte përfshijnë konstatimet e Komisionit për problematikat në përdorimin e fondit të kredisë me kushte lehtësuese dhe ato që lidhen me rrethanat e kohës kur është kryer pagesa e kështit të parë të kësaj pasurie. Si të tilla, ato do të gjejnë trajtim në këtë arsyetim vetëm brenda kufijve të relevancës në masën disiplinore apo nëse janë në dobi të qartësimit të argumenteve të tjera, për efekt të përgjigjeve për shkaqet e ankimit. Në vijim, arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion.

12.4. Së pari, sikurse konstatuar edhe në Komision, nga krahasimi i deklaratës *vetting* dhe asaj periodike vjetore për vitin 2011, rezultojnë të dhëna të ndryshme për sa i përket burimeve të krijimit të pasurisë. Konkretisht, ndërsa në deklaratën *vetting* subjekti referon si burim *kreditë* 5 milionë lekë dhe kursime personale e familjare, në deklaratën periodike për vitin 2011, ai ka deklaruar se apartamenti objekt analize është blerë me shumën e siguruar nga *revokimi* i kontratës së mëparshme të sipërmarrjes (kredia e marrë në BKT, në vlerat 5.000.000 lekë dhe 1.000.000 lekë) dhe nga kursimet familjare dhe personale. Po aty, në deklaratën periodike për vitin 2011, subjekti ka deklaruar një kontratë noteriale porosis/sipërmarrjeje, të datës 27.05.2011, për blerjen e një apartamenti në Berat, për vlerën 6.000.000 lekë, nga e cila ka likuiduar 1.000.000 lekë, ndërsa pjesa e mbetur e detyrimit, prej 5.000.000 lekësh, është paguar nga kredia bankare e marrë në BKT, në këtë shumë. Në datën 16.09.2011, palët kanë revokuar kontratën e porosisë dhe apartamenti i është kthyer sipërmarrësit, ky i fundit i ka kthyer porositësve (subjektit dhe personit të lidhur) shumën 6.000.000 lekë.

12.5. Subjekti i ka deklaruar këto detaje edhe gjatë pyetësorëve,⁴⁴ duke specifikuar edhe që kredia në fjalë është përfituar nga bashkëshortja e tij, për shkak të detyrës, për blerjen e një apartamenti në Berat dhe ka qenë me kushte lehtësuese. Kredia është disbursuar në llogarinë e bashkëshortes në datën 22.07.2011, në shumën 4.950.000 lekë. Pasi është revokuar kontrata e porosisë (rreth 4 muaj pas nënshkrimit), referuar mandatpagesës, bashkëshortes i është kthyer shuma prej 6.150.000 lekësh.

12.6. Sikurse referuar më sipër, Komisioni nuk e ka ngarkuar me përgjegjësi subjektin për veprimet e kryera prej tij apo të bashkëshortes, për fitimin e kredisë me kushte lehtësuese apo si pasojë e konstatimit të kontradiktave në lidhje me kohën kur ka ndodhur në fakt pagesa e kështit të parë të apartamentit në Tiranë. Si rrjedhojë, shuma e përfituar nga *revokimi* i kontratës së sipërmarrjes në Berat, në këndvështrimin financiar, nuk përbën objekt diskutimi në Kolegj, sikurse edhe në Komision. Po ashtu, ndonëse subjekti ka ngritur shkaqe ankimi, kredia e marrë nga bashkëshortja në kushte lehtësuese, në vitin 2011, efekti i saj financiar apo çështja e momentit real në kohë kur është paguar kësti i parë prej 5.000.000 lekësh për apartamentin, nuk kanë passjellë pasoja përcaktuese në zgjidhjen e çështjes nga Komisioni për subjektin. Për pasojë, për ekonomi gjyqësore dhe duke pasur në konsideratë garancitë procedurale që shoqërojnë ankimin, këto aspekte do të gjejnë pasqyrim të përmbledhur dhe vetëm për

⁴⁴ Pyetësori nr. 2, pika 8.

plotësim të arsytimit apo të situatës faktike e ligjore, që rezulton në çështjet që janë përcaktuese në zgjidhjen e çështjes.

12.7. Komisioni ka konstatuar se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar saktë fillimin e marrëdhënies kontraktuale me shoqërinë e ndërtimit/sipërmarrësit në marrëdhënien kontraktore për apartamentin në Tiranë. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky konstatim qëndron. Është e logjikshme të prezumohet se ometimi i dinamikës reale të krijimit të shumës prej 5.000.000 lekësh, në deklaratën *vetting*, mund të ketë përbërë edhe një përpjekje për shmangien e përgjegjësisë për përdorimin e fondit të kredisë, në kundërshtim me kriteret që përcaktonte akti nënligjor, i cili ka mundësuar përfitimin e saj.⁴⁵

12.8. Pavarësisht nga sa më sipër, trupi gjykues i vlerëson konstatimet për problematikën e konstatuar me kredinë në kushte lehtësuese pa peshë përcaktuese, duke çmuar të theksojë vetëm se konfirmohet edhe në Kolegj konstatimi i Komisionit. Kredia me kushte lehtësuese për strehim në Berat është marrë duke pasur për synim në fakt pagesën e apartamentit në Tiranë. Edhe vetë subjekti ka pranuar ekzistencën e marrëdhënies me sipërmarrësin tre muaj përpara kontratës së sipërmarrjes, në korrik 2011, në kushtet që është shprehur për një draftmarrëveshje, ndërkohë që kontrata e furnizimit me energji elektrike për apartamentin, paradaton kontratën e sipërmarrjes me rreth dy muaj, e lidhur në gusht 2011.⁴⁶ Këto fakte tregojnë se subjekti nuk ka deklaruar saktësisht marrëdhënien kontraktuale me shoqërinë ndërtuese për sa i përket apartamentit objekt analize. Nga ana tjetër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për arsyen përse palët kanë rënë dakord për një draftkontratë, qoftë në funksion të lidhjes së energjisë elektrike apo për të zgjidhur marrëdhënien kontraktuale të krijuar për apartamentin në Berat, bien ndesh me aktet që normojnë punën e OShEE-së⁴⁷ dhe u mungon koherenca logjike. Revokimi i kontratës së sipërmarrjes për apartamentin në Berat nuk kishte përse të kushtëzohej me një draftkontratë të lidhur me një ndërtues tjetër në Tiranë. Këto pretendime duken më tepër si përpjekje për të justifikuar marrëdhënien faktike financiare/ligjore me shoqërinë sipërmarrëse për apartamentin në Tiranë apo shmangien e përgjegjësisë dhe kontrollit për pagesa të *padeklaruara*, të kryera që në korrik të vitit 2011. Gjithsesi, për sa u referua më sipër, mungesa e saktësisë në deklarimin e kësaj marrëdhënieje kontraktuale është aspekt pa peshë përcaktuese.

12.9. Në përmbledhje, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimet e subjektit janë të pabazuara. Subjekti ka kryer deklaram të pasaktë në deklaratën *vetting* për burimet e krijimit të kështit të parë të apartamentit në Tiranë. Nga aktet rezultoi e provuar që si burim krijimi për apartamentin në Tiranë nuk ka shërbyer kredia prej 5.000.000 lekësh, por të ardhurat e fituara nga revokimi i kontratës së sipërmarrjes për apartamentin në Berat, sikundër deklaruar prej tij në deklaratën e interesave periodikë

⁴⁵ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 600/2007, "Për trajtimin me strehim të nëpunësve civilë të administratës së lartë shtetërore dhe funksionarëve publikë", me ndryshimet që ka sjellë vendimi nr. 1714/2008. Subjekti dhe personi i lidhur kanë përdorur një kredi në kundërshtim me përcaktimin e aktit nënligjor për të blerë apartament në Tiranë dhe jo në Berat, ku do të duhet të ishte destinacioni për qëllimet e strehimit.

⁴⁶ Nga korrespondenca e Komisionit me OShEE-në ka rezultuar që kontrata e lidhur me bashkëshorten e subjektit mban datën 02.08.2011.

⁴⁷ Nga informacion i publikuar në faqen zyrtare të OShEE-së, dokumentacioni shoqërues për lidhje të re me energji kërkon edhe kopje të dokumentit mbi bazën e të cilit kërkohet përfshirja si përdorues, që mund të jetë një kontratë qiraje, një kontratë sipërmarrje etj. Shih <https://oshee.al/wp-content/uploads/2014/12/Ndryshim-i-perdoruesit-te-prones.pdf>; <https://fshu.al/wp-content/uploads/2019/10/MATRICA-E-DOKUMENTACIONIT-revised.pdf>

vjetorë të vitit 2011. Për rrjedhojë, subjekti nuk ka përmbushur detyrimin e përcaktuar në germën “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

12.10. Për sa i përket burimeve të tjera që kanë shërbyer për krijimin e apartamentit objekt analize, Komisioni ka konkluduar që subjekti dhe personi i lidhur nuk justifikojnë plotësisht likuidimin e këstit *të dytë* dhe *të tretë* të pagesave të kryera gjatë vitit 2011. Komisioni ka konstatuar balancë negative në tri vite (2006, 2008 dhe 2010), e cila ka pasojë të drejtpërdrejtë të kursimet e deklaruara si burim për pagesat e këtyre kësteve, në total prej 3.200.000 lekësh. Ky konkluzion bazohet kryesisht në analizën financiare të kursimeve *cash*, si dhe shlyerjen e parakohshme, në vitin 2010, të një kredie të marrë nga personi i lidhur në vitin 2005, si derivat i pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të personit *tjetër* të lidhur, e afërme e bashkëshortes, për të financuar një hua prej 1.200.000 lekësh.

12.11. Subjekti kundërshton këtë konkluzion të Komisionit, duke kërkuar që të merret në konsideratë një analizë financiare e përgatitur nga një ekspert kontabël i kontraktuar prej tij. Sipas kësaj analize financiare, ai dhe personi i lidhur rezultojnë me burime financiare të mjaftueshme për të kryer shpenzimet dhe përballuar kursimet e deklaruara. Po ashtu, subjekti pretendon se: (i) deri në fund të vitit 2010, ai dhe bashkëshortja kanë disponuar kursime në formë likuiditetesh *cash* në shumën prej 3.500.000 lekësh, nga të cilat 2.500.000 lekë janë akumuluar gjatë periudhës 2003 – 2009 dhe 1.000.000 lekë janë shtuar në vitin 2010, deklaruar në DPV-në 2010; (ii) ai ka deklaruar se i ka shpenzuar këto kursime për blerjen e apartamentit në vitin 2011, dhe nuk i dispononte në vitin 2012. Komisioni ka keqinterpretuar deklarinë e tij në ILDKPKI në vitin 2012, kur ai është shprehur se këto vlera monetare janë mbajtur *cash* në banesë, pasi i ka tërhequr nga banka, por jo që i ka disponuar *cash* në momentin që ka nënshkruar atë procesverbal.

12.12. Po ashtu, për sa i përket problematikës së konstatuar për shlyerjen e parakohshme të kredisë nga bashkëshortja, subjekti ka potencuar se ajo përbënte një detyrim vetjak, meqenëse është marrë para martese. Më pas, subjekti shprehet se suksesi në përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese (referuar më sipër) kushtëzohej nga shlyerja e kredisë së mëparshme të marrë nga bashkëshortja para martese. Bashkëshortja mori huan 1.200.000 lekë nga kushërira (znj. G. N.) për këtë qëllim, në datën 02.04.2010, sikurse deklaruar në deklaratën *vetting* dhe deklaratat periodike vjetore. Bazuar në këto deklarime, burim financiar për shlyerjen e kredisë kanë qenë huaja dhe të ardhurat vjetore të pagës. Edhe nëse shlyerja e kredisë konsiderohet si detyrim i bashkësisë familjare, huadhënësi tjetër (z. A. Gj./në cilësinë e huadhënësit të G. N.), ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme nga punësimi në Itali. Për të provuar këto të ardhura, subjekti depozitoi disa akte në Komision.

12.13. Gjatë kontrollit të analizës së Komisionit, në shqyrtim të akteve në fashikull e shkaqeve të ankimit, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, trupi gjykues i Kolegjit korrektoi disa zëra. Si pasojë e këtij korrigjimi, ndërsa kësti *i dytë* rezulton i mbuluar nga burime të ligjshme financiare, rezulton gjithsesi një balancë negative për mbulimin e një pjese të këstit *të tretë*, në datën 28.11.2011, në vlerën prej (-) 494.965 lekësh. Së dyti, në Kolegj u konfirmua një balancë negative financiare për të mbuluar shpenzimet e deklaruara të kryera në vitin 2010 (në funksion të shlyerjes së vlerës prej 1.700.000 lekë, të detyrimit të mbetur për shlyerjen e kredisë së marrë në vitin 2005, nga bashkëshortja). Këto balanca negative janë rezultat i konstatimit të mungesës së burimeve të ligjshme të personit *tjetër* të lidhur (e afërme e bashkëshortes), për të financuar huan e dhënë pas martese, sikurse edhe

pamundësinë e vetë subjektit dhe personit të lidhur për të shlyer këto detyrime e krijuar kursimet në likuiditet jashtë sistemit bankar (*cash*), gjatë vitit 2010. Edhe pretendimet e subjektit për disponimin e *likuiditeteve cash*, në funksion të kursimeve të pretenduara në vitin 2009 dhe 2010, qoftë në drejtim të krijimit të kësaj pasurie apo të përmbysjes së analizës financiare me mungesë burimesh për periudhën 2003 – 2016, u vlerësuan të pabazuara nga trupi gjykues i Kolegjit. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit, se huaja e referuar më sipër nuk duhet t'i ngarkohet bashkësisë familjare. Në vijim shtjellohet në detaj arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion.

12.14. Për sa i përket shlyerjes së parakohshme të kredisë, rezultojnë të dhënat që përmbledhen si vijon:

- a. Në datën 28.06.2005, personi i lidhur/bashkëshortja, ka lidhur një kontratë kredie për shumën prej 2.500.000 lekësh, me afat të *pacaktuar*.
- b. Në datën 02.10.2009, subjekti dhe bashkëshortja kanë lidhur martesë ligjore.
- c. Sipas deklaratës periodike për vitin 2009, detyrimi i mbetur për kredinë në fjalë, deri në fund të vitit 2009, ka qenë në shumën 1.700.000 lekë.
- d. Në deklaratën periodike për vitin 2010, bashkëshortja e subjektit, ndryshe nga sa referohet në kontratë, ka deklaruar se kredia në fakt është me afat 15-vjeçar. Po ashtu, ajo është shprehur se ka shlyer kredinë në katër (4) këste, të paguara përkatësisht: një në janar dhe tre në prill. Kësti i fundit (536.903 lekë), deklaruar me burim nga *të ardhurat vjetore* nga paga. Në të njëjtën deklaratë, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar edhe kontratën noteriale të huadhënies, më datë 02.04.2010, lidhur *me një të afërme të saj* (znj. N.), për shumën 1.200.000 lekë.
- e. Nga lëvizjet në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit rezultojnë depozitime në *cash* në llogarinë e kredisë, në datat: 02.04.2010 dhe 08.04.2010, përkatësisht në vlerat 1.200.000 lekë dhe 560.000 lekë. Në datën 09.04.2010 është shlyer tërësisht pjesa e kredisë së mbetur. Në total, shuma e paguar për shlyerjen e kredisë, në periudhën 01.01.2010 – 09.04.2010, është 1.879.203 lekë (principal + interesa).

12.15. Sa më sipër tregon që, duke nisur nga viti 2010, bashkëshortja e subjektit e ka deklaruar kredinë sikur të ishte me afat *ndryshe* nga kontrata e lidhur për këtë qëllim, dhe e ka shlyer atë brenda harkut kohor janar – prill 2010. Nevoja për shlyerjen e shpejtë, sipas shpjegimit të subjektit, ishte aplikimi për kredinë tjetër me kushte lehtësuese, akorduar me sukses gjatë vitit 2011. Kjo periudhë kohore, po ashtu është pas martesës dhe pas krijimit të regjimit pasuror të bashkësisë ligjore. Për pasojë, në mungesë të një akti për të disponuar ndryshe, huaja e marrë për të shlyer kredinë, prezumohet të jetë detyrim i bashkësisë ligjore sipas neneve 73 dhe 81 të Kodit të Familjes⁴⁸. Për sa më sipër dhe sikurse është shprehur subjekti, këto veprime financiare kanë pasur për objektiv krijimin e kushteve për të përfituar një kredi, për të krijuar një pasuri bashkëmartësore, sikurse edhe ka ndodhur. Për pasojë, pretendimi i

⁴⁸ “Regjimi pasuror martësor i bashkësisë ligjore zbatohet kur bashkëshortët nuk kanë lidhur kontratë për regjim tjetër pasuror martësor.” “Bashkëshortët përgjigjen mbi pasurinë në bashkësi: a) për të gjitha barrët dhe detyrimet që rëndojnë mbi ta në çastin e fitimit të pronësisë; b) për të gjitha shpenzimet e administrimit të pasurisë së përbashkët; c) për të gjitha shpenzimet për mbajtjen e familjes dhe për çdo detyrim të kontraktuar nga bashkëshortët, qoftë dhe veçmas, që është në interes të familjes; ç) për çdo detyrim tjetër kontraktues ose jokontraktues, me përjashtim të detyrimeve të përcaktuara si vetjake në këtë Kod.”

subjektit që zgjedh të potencojë vetëm një prej dispozitave të Kodit të Familjes, atë që rregullon detyrimet e krijuara para martese nga bashkëshortja, ndërkohë që anashkalon/hesht për veprimet juridike të tjera në dobi dhe në ngarkim të ekonomisë së përbashkët familjare, është i pakuptimtë, pasi është i pabazuar.

12.16. Konkretisht, përpos momentit kohor që përkon *pas martese*, në prill 2010, kur pretendohet të jetë marrë huaja nga personi i lidhur, subjekti i rivlerësimit ka qenë i interesuar dhe përfitues i drejtpërdrejtë nga shlyerja e kredisë së marrë nga bashkëshortja në vitin 2005, si kusht determinant për përfitimin e kredisë me kushte lehtësuese dhe blerjen e apartamentit *gjatë martesës*. Po ashtu, cilësimi si vetjak i detyrimeve të bashkëshortëve përpara martese, nën dritën e përcaktimeve të nenit 82 e vijues të Kodit të Familjes, ka për qëllim të rregullojë përgjegjësinë dhe pasojat ligjore vetëm në raport individual *me kreditorët*, në rast mospërmbushje detyrimi. Me fjalë të tjera, ndërsa sipas ligjit personi i lidhur/bashkëshortja përgjigjet personalisht kundrejt kreditorëve për detyrimet e interesat financiarë që ajo mund të ketë krijuar përpara tetorit 2009, në rastin konkret kundrejt personit tjetër të lidhur/huadhënës dhe bankës, nga e cila është marrë kredia lehtësuese në vijim, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, marrja e huas gjatë martesës apo shlyerja e detyrimeve nëpërmjet kësaj huaje përbën interes pasuror të subjektit të rivlerësimit dhe iu nënshtrua kontrollit të ligjshmërisë së krijimit, edhe meqenëse synimi fundor ishte krijimi i një pasurie bashkëmartesore, prej së cilës përfiton vetë subjekti i rivlerësimit.

12.17. Në vijim të arsyetimit të mësipërm dhe pas kontrollit të analizës së kryer në Kolegj, u konfirmua konkluzioni i Komisionit për pamundësinë e personit tjetër të lidhur, huadhënës, për të financuar huan prej 1.200.000 lekë me burime të ligjshme. Nga ana tjetër, edhe duke abstraguat nga pretendimi rishtazi e jobindës, paraqitur gjatë hetimit administrativ, se huadhënësja në fakt ka pasur fonde të marra hua nga një person i tretë, sërish subjekti nuk arrin të provojë burime të ligjshme të mjaftueshme. Të dyja këto aspekte analize janë arsyetuar gjerësisht në vendimin e Kolegjit nr. 37/2022 (JR), për shqyrtimin e ankimit të bashkëshortes së subjektit. Në përmbledhje dhe si konfirmim i atij arsyetimi, referuar paragrafit 23.17 të atij vendimi, së pari, trupi gjykues i Kolegjit thekson se huadhënësja/personi tjetër i lidhur, nuk provon me dokumentacion mundësinë për të financuar huan e deklaruar dhënë bashkëshortes së subjektit.

12.18. Së dyti, nën dritën e pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, subjekti kishte detyrimin të deklaronte qartë burimin real të fondeve, që në këtë rast pretendohet t'i atribuohet një huadhënësi të sjellë rishtazi. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij, në deklaratën periodike për vitin 2010 (referuar më sipër në paragrafin 12.14/d) dhe në ILDKPKI, në mars 2012, kanë konfirmuar marrëdhënien e huas sipas kontratës noteriale. Për më tepër, në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI,⁴⁹ ata kanë specifikuar edhe që huadhënësja dhe bashkëshorti i saj kanë pasur mundësi të financonin huan, pasi kanë *biznes* privat. Për herë të parë, subjekti ka sjellë “në fotografi” një huadhënës të personit tjetër të lidhur, vetëm gjatë hetimit administrativ, në janar 2021⁵⁰. Nga aktet rezulton se edhe bashkëshortja e tij e ka ngritur për herë të parë këtë pretendim, në hetimin administrativ të kryer për rivlerësimin e saj, rreth

⁴⁹ Referuar procesverbalit të mbajtur më datë 06.03.2012, në ILDKPKI.

⁵⁰ Me përgjigjet e pyetësorit nr. 3. Rezulton se bashkëshortja e subjektit ka pretenduar për herë të parë marrëdhënien juridike me huadhënësin tjetër vetëm gjatë pyetësorit nr. 3, gjatë hetimit të saj. Shih faqen 23 të vendimit të Kolegjit në https://kpa.al/wp-content/uploads/2022/12/Vendimi_B._K._anonimizuar_perfshire_mendimet_paralele.pdf.

një vit më herët.⁵¹ Me fjalë të tjera, pretendimet e subjektit janë rikonfirmim i shpjegimeve të bashkëshortes. Sipas këtij versioni, huadhënësja ka pasur burime financiare të ligjshme, meqenëse ka marrë hua nga një kushëri i përbashkët i saj dhe i bashkëshortes së subjektit. Subjekti ka pretenduar se mungesa e specifikimit të burimit real të fondeve ishte për shkak *padijenie*. Ai dhe bashkëshortja kanë mësuar vetëm gjatë hetimit administrativ të bashkëshortes, që personi tjetër i lidhur i kishte shpjeguar që, në fakt, huadhënësja kishte marrë hua për të hapur një aktivitet privat, të cilin nuk e hapi. Ndërkohë, sipas shpjegimeve të subjektit, huadhënësja ishte e papunë.

12.19. Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mungesë dijenie për burimin e vërtetë të të ardhurave, nëpërmjet të cilave është mundësuar huaja, është jobindës dhe me mungesë besueshmërie, pasi jo vetëm është ngritur për herë të parë gjatë hetimit administrativ, por edhe sepse rrethanat faktike që kërkohet të pranohen, sfidojnë logjikën. Konkretisht, subjekti pretendon se huadhënësja, e papunë, i dha hua bashkëshortes së subjektit para, që vetë huadhënësja i kishte marrë hua për të shlyer një kredi dhe marrë një tjetër për të blerë apartament në Tiranë, ndonëse bashkëshortja e subjektit vijonte të punonte në Berat, ku edhe kishte fituar statusin e pastrehë. Shpjegimet se huadhënësja, e papunë në kohën e dhënies së huas dhe me nevojë financiare, zgjedh të mos e përdorë huan për nevojat e saj dhe për qëllimin për të cilin e mori, por t’ia transferojë vajzës së tezes (gjyqtare, me stabilitet ekonomik), madje me një afat të largët për kthimin e huas, prej 10 (dhjetë) vjetësh, janë të pabesueshme. Nga ana tjetër, në kushtet që në këtë trekëndësh palësh, bashkëshortja e subjektit ishte njësoj e afërme me huadhënësin real, sipas deklarimeve, z. Gj., është e pakuptimtë përfshirja e huadhënësës si palë e ndërmjetme. Është po ashtu e pakuptimtë se si asnjë prej palëve huadhënëse, kushërinj të bashkëshortes së subjektit, nuk kanë parë nevojën ta qartësojnë kontributin respektiv në këtë trekëndësh për mbi nëntë (9) vite, deri në shtator 2019⁵².

12.20. Përpos pamundësisë financiare të huadhënësës si person tjetër i lidhur (znj. N.), për të dhënë huan, subjekti nuk provoi as mundësinë e personit të tretë në këtë raport (z. Gj.), për të krijuar huan prej 10.000 eurosh me burime të ligjshme. Pas konstatimit për mungesë besueshmërie të dinamikës se si pretendohet të jetë materializuar kjo marrëdhënie, edhe duke abstraguat prej saj, trupi gjykues i vlerëson pa peshë deklaratat noteriale të huadhënësve për provueshmërinë e huadhënëve të pretenduara, edhe duke konsideruar kohën kur janë hartuar. Konkretisht, ndonëse referojnë një marrëdhënie të vjetër juridike, deklaratat noteriale janë hartuar përkatësisht në datat 09.09.2019 dhe 25.01.2020, gjatë procesit të rivlerësimit të bashkëshortes së subjektit. Nga ana tjetër, aktet e sjella nga subjekti provojnë vetëm mundësinë e krijimit nga huadhënësi të shumës prej 3.842 eurosh në total (pa zbritur shpenzimet e jetesës) nga punësimi,⁵³ edhe duke abstraguat nga mospërbushja e kritereve formale që paraqesin disa

⁵¹ Vendimi i Komisionit për bashkëshorten e subjektit mban datën 15.06.2020, ndërsa hetimi administrativ rezulton të ketë përfunduar në datën 13.02.2020.

⁵² Deklarata noteriale e paraqitur nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, që mban datën 19.09.2019, gjatë hetimit administrativ të kryer për të, në të cilën huadhënësja G. N. ka deklaruar se ka marrë hua shumë 10.000 euro nga A. Gj., në 22.08.2009, më afat likuidimi, për hapjen e një aktiviteti privat, parukeri, të cilin nuk e ka hapur (deri në datën e deklarimit). Shih edhe paragrafin 23.16 të vendimit të Kolegjit për subjektin e rivlerësimit B. K.

⁵³ Aktet e sjella për këtë qëllim përbëhen nga: (i) vërtetimi datë 08.11.2019, i administratorit të një personi juridik italian, i përkthyer dhe i pajisur me vulë apostile. Sipas këtij akti, huadhënësi A. Gj. është punësuar më datë 25.07.2007 nga shoqëria “{***}”, e bashkuar më pas me shoqërinë “{***}”. Nga muaji tetor 2009, z. A. Gj. është punësuar me kohë të pacaktuar, kontratë e aplikuar në industrinë e drurit. Ky vërtetim nuk përmban të dhëna për të ardhura të realizuara nga punësimi i tij pranë kësaj shoqërie. (ii) Pagesë mujore lëshuar nga shoqëria “{***}”, për muajin dhjetor 2003, me pagë neto 650 euro. (iii) Pagesë mujore, lëshuar nga shoqëria “{***}”, për muajin maj 2006, me pagë neto 367 euro. (iv) Pagesë mujore, lëshuar

prej tyre. Kjo shumë është dukshëm e pamjaftueshme për të mbuluar huadhënien prej 10.000 eurosh, të pretenduar dhënë të afërmes që deklarohet si huadhënësja direkte e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit. Përpos nga ana sasiore, edhe në këndvështrimin kohor, pagesat e gjeneruara nga punësimi janë të ndryshme e relativisht në distancë kohore nga momenti kur pretendohet të jetë dhënë huaja, në gusht 2009. Konkretisht, aktet tregojnë për të ardhura për dhjetor 2003, maj 2006 dhe maj 2007, vite përpara huas ose pas huas, në dhjetor 2009 dhe janar 2010. Për të gjitha këto arsye, aktet e sjella dhe të dhënat e pasqyruara në to u vlerësuan pa vlerë provuese, qoftë nga ana sasiore, ashtu edhe në drejtim të ligjshmërisë kundrejt krijimit të huas.

12.21. Në vijim, analiza për shlyerjen e parakohshme të kredisë u fokusua në burimet e tjera të deklaruara, të ardhurat vjetore të pagës. Nga kontrolli i analizës financiare të kryer në Kolegj, për periudhën 01.01.2010 – 09.04.2010, konfirmohet balanca negative e përlllogaritur nga Komisioni. Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare të mjaftueshme, për të paguar plotësisht shlyerjen e pjesës së mbetur të kredisë së marrë nga personi i lidhur, në Alpha Bank, në vitin 2005, në një balancë negative pothuajse të njëjtë me Komisionin. Për rrjedhojë, konfirmohet balanca negative e konstatuar në Komision prej (-) 1.554.845 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se vlerat e shpenzimeve të jetesës janë përlllogaritur në Komision në përputhje me standardin e INSTAT-it, referuar dhe përdorur rregullisht nga organet e rivlerësimit. Duke rikonfirmuar sa është shtjelluar gjerësisht në vendime të mëparshme të Kolegjit, standardi i përdorur nga INSTAT-i përbën një mesatare në të cilën janë marrë në konsideratë gjitha fashat demografike, përfshirë edhe të punësuarit me paga minimale apo pensionistët. Për rrjedhojë, kërkesa e subjektit për të zbritur shpenzime jetese për familjen e tij për këtë vit, u vlerësua e pabazuar.

12.22. Duke iu rikthyer analizës për këstin e dytë dhe të tretë të apartamentit objekt analize, *kursimet* familjare, të deklaruara si burimi i dytë, kanë afektuar konkluzionin e Komisionit për pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme. Komisioni ka theksuar që ndërsa subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendjen e likuiditeteve në bankë, të krijuara në vitet 2006 dhe 2008, dhe as burimin e krijimit të tyre, ekuivalenti në lekë i shumës 20.000 USD, pretenduar si pjesë e shumës së kursyer *cash* deri në fund të vitit 2010, nuk mund të ketë shërbyer si burim për likuidimin e pagesave të kryera për apartamentin në Tiranë gjatë vitit 2011, nëse mbahet në konsideratë shpjegimi i subjektit, në mars 2012, në ILDKPKI. Në atë rast, subjekti ka pretenduar që këto fonde i kishte ende në banesë në atë moment kohor, në *cash*. Për rrjedhojë, pasi ka kryer analizën financiare, Komisionit i ka rezultuar se subjekti rezultonte me balancë negative burimesh të ligjshme në vitet 2006, 2008 dhe 2010, që passjell edhe efekt negativ mbi mundësinë e krijimit të kursimeve të deklaruara si të përdorura për pagimin e dy kësteve, në totalin e vlerës së tyre, prej 3.200.000 lekësh.

12.23. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, duke argumentuar se termi “likuiditet”, nënkupton gjendjen *cash*, pavarësisht nga vendndodhja, e cila pasqyrohet vetëm në bilance. Po ashtu, shuma prej 10.000 USD nuk është krijuar e gjitha në vitet 2006 dhe 2008, por edhe me kursimet

*nga shoqëria “{***}”, për muajin maj 2007, me pagë neto 959 euro. (v) Pagesë mujore, lëshuar nga shoqëria “{***}”, për muajin dhjetor 2009, me pagë neto 923 euro. (vi) Pagesë mujore, lëshuar nga shoqëria “{***}”, pagesë e muajit janar 2010, me pagë neto 943 euro. (vii) Karta e identitetit e z. A. Gj., lëshuar më datë 11.08.2016, nga Komuna {***} dhe lejet e qëndrimit lëshuar për herë të parë më datë 20.10.2003 dhe rinovuar afati i qëndrimit për vitet pasuese. Disa prej këtyre akteve, të papërkthyer në gjuhën shqipe, janë njësuar me origjinalin pranë noteres, me aktin {***} rep., datë 25.01.2021.*

e viteve të mëparshme. Mosdeklarimi i tyre në vitet përkatëse nuk ka qenë i qëllimshëm; ai ka deklaruar shtesat e likuiditeteve, por jo faktin që një pjesë të tyre i ka depozituar në bankë. Deklarimi në ILDKPKI, në vitin 2012, duhet parë në tërësinë e tij. Ai ka deklaruar se ka referuar shumat në momentin e tërheqjes dhe jo në momentin kur është pyetur, në datën 06.02.2012. Të gjitha kursimet e tij në vite janë pakësuar, pasi janë paguar për blerjen e apartamentit. Shumën 8.000 USD e ka tërhequr nga banka në datën 10.10.2008, pasi në vitet 2006 – 2010 ka pasur lëkundje të sistemit bankar dhe për të parandaluar humbjen e tyre, ka vendosur t'i mbajë kursimet në banesë. Në mbështetje të prapësimeve të tij, subjekti ka depozituar si provë të re, aktekspertimin financiar të përgatitur nga një ekspert kontabël.

12.24. Nga aktet në fashikull rezultojnë të dhënat si vijon:

- a. Shumatorja e *cash*-it në gjendje, jashtë sistemit bankar, deklaruar nga subjekti në periudhën 2003 deri në 31.12.2006, është 13.000 dollarë amerikanë. Deklaruar shtesa në secilin vit të ndërmjetëm. Subjekti ka deklaruar kursime nga paga e vitit.
- b. Nga dokumentacioni i administruar në Komision nga bankat ka rezultuar se, në datën 10.08.2006, subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash* në bankë (Emporiki Bank/ABI Bank) shumën 10.000 USD, duke e investuar në depozitë me afat. Gjendja e kësaj depozite në datën 31.12.2006 është 10.000 USD. Kjo depozitë bankare nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit.
- c. Në deklaratën për vitin 2007, subjekti ka deklaruar shtesë të likuiditeteve *cash* në shumën 6.000 USD.
- d. Në deklaratat për vitet 2008, 2009 dhe 2010, subjekti ka deklaruar shtesë likuiditetesh *cash* nga të ardhurat vjetore nga pagat. Depozitimet apo tërheqjet e shumave nuk janë deklaruar. Deri në vitin 2009, personi i lidhur nuk ka deklaruar kursime në formë likuiditetesh *cash*.
- e. I pyetur nga ILDKPKI, mbi depozitën 10.000 USD, në vitin 2006, në Emporiki Bank, në datën 06.03.2012, subjekti është shprehur se: “këtë vlerë e ka *gjendje cash në banesë*”, ndërsa për depozitën e çelur në vitin 2008, në Raiffeisen Bank, me gjendje fillestare 10.000 USD, ka deklaruar se “*aktualisht e ka në gjendje cash në banesë*”.
- f. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar, as në deklaratën *vetting*, dy depozitat bankare prej 10.000 USD secila dhe as burimin e krijimit të tyre, të pretenduar nga pakësimi i gjendjes të *cash*-it që dispononte në banesë, përpos mosdeklarimit të tyre në deklaratat e interesave private periodike të viteve 2006 dhe 2008.

12.25. Nga analiza e këtyre akteve, nën dritën e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim, rezulton se qasja e Komisionit është e bazuar ndërsa janë jobindëse pretendimet e subjektit për mënyrën se si duhet të interpretohen kundërshtitë në deklarimet e tij të likuiditeteve ndër vite. Në kushtet që ligji nr. 9049/2003 parashikon shprehimisht mënyrën e deklarimit të likuiditeteve, duke kërkuar shprehimisht ndryshimet vit pas viti dhe vendndodhjen e ruajtjes e administrimit të tyre, sikurse arsyetuar e zbërthyer gjerësisht në shumë vendime të mëparshme të Kolegjit, subjekti prezumohet se ishte i qartë. Këtë e provon edhe fakti që subjekti ka deklaruar saktësisht përpara dhe pas momenteve në kohë kur janë kryer depozitat, por jo në periudhat kur këto janë çelur. Konkretisht, nga deklaratat periodike vjetore të viteve 2003 – 2005, rezulton se subjekti ka qenë i kujdesshëm/specifik në deklarimin e likuiditeteve, duke përcaktuar edhe vendndodhjen e tyre “*gjendje cash në shtëpi*”. Në deklaratat për vitet 2006 dhe 2008, subjekti nuk

tregon të njëjtën qasje specifike për të deklaruar vendndodhjen e saktë të likuiditeteve, ndonëse flitet për një veprim si transferimi në depozitë bankare. Në këto vite, ai ka deklaruar vetëm kursime, pa specifikuar nëse i dispononte gjendje *cash* në shtëpi apo në depozitë bankare. Në deklaratën për vitin 2009, subjekti është treguar sërish i detajuar, duke u shprehur për vendndodhjen e kursimeve si *gjendje cash*. Në deklaratën për vitin 2010, subjekti deklaroi ndryshime të likuiditetit si “shtesë në shumën 500.000 lekë” (dy herë), pa specifikuar vendndodhjen e këtyre kursimeve. Nga të gjitha këto detaje rezulton qartë që mosspecifikimi i vendndodhjes së likuiditeteve është bërë pikërisht në vitet kur datojnë edhe depozitat bankare.

12.26. Për rrjedhojë, në kushtet që në deklaratat periodike vjetore subjekti nuk ka deklaruar ndryshimet që kanë pësuar likuiditetet *cash*, në rastin konkret, konvertimin/materializimin e tyre në dy depozita bankare prej 10.000 USD secila, në vitet 2006 dhe 2008, nën logjikën e deklarimit periodik vjetor sipas ligjit nr. 9049/2003, deduktohet që likuiditetet *cash* nuk janë pakësuar, duhet të kenë vijuar të paprekura apo nuk mund të kenë shërbyer si burim krijimi i dy depozitave. Ky interpretim është në linjë edhe me qëndrimin e konsoliduar të Kolegjit, se nuk mund të prezumohet përdorimi nga subjektet i gjendjeve *cash* si burime për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve, për sa kohë një gjë e tillë nuk është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike dhe as në deklaratën *vetting*.

12.27. Në këtë vlerësim, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë edhe mospërputhjet mes pretendimeve të subjektit në ankim, për përdorimin e kursimeve për këstet e apartamentit, në vitin 2011, me sa ka deklaruar në ILDKPKI, *në mars 2012*, për disponimin e këtyre likuiditeteve *në banesë në atë moment*. Këto mospërputhje paraqiten si në shërbim të nevojave dhe në dobi të situatës që paraqitet në kohë e faza të ndryshme, dhe jo si interpretim i ndryshëm i gjuhës së ligjit. Në kushtet që subjekti *nuk* rezulton të ketë korrigjuar deklaratimet e tij në këto dy vite apo edhe pasi është pyetur për sqarime nga ILDKPKI-ja, është e pamundur të argumentohet që vetëm pretendimet e sjella gjatë procesit të rivlerësimit janë të besueshme. Në përmbledhje, pretendimet e subjektit për disponimin e likuiditeteve gjendje *cash*, në funksion të kursimeve të pretenduara në vitin 2009 dhe 2010, qoftë si burim krijimi i kësaj pasurie apo për efekt të përmbysjes së balancave negative, që kanë rezultuar për disa vite gjatë periudhës 2003 – 2016, u vlerësuan të pabazuara nga trupi gjykues i Kolegjit.

12.28. Në vijim të sa më sipër, pas korrektimit të analizës financiare të Komisionit, referuar në rezultatet e hetimit administrativ, duke ndjekur të njëjtën qasje, në Kolegj, subjekti i rivlerësimit rezulton me burime të ligjshme të *mjaftueshme* për të përballuar shlyerjen e plotë të këstit të dytë të apartamentit në Tiranë, në datën 25.10.2011. Konkretisht, referuar analizës së Komisionit,⁵⁴ duke pranuar shpjegimet e subjektit në ILDKPKI dhe deklaratimet periodike vjetore, deduktohet se subjekti ka pasur mundësinë të përdorte 1.620.400 lekë nga kursimet e deriatëhershme⁵⁵ për këstin e dytë. Pas përfshirjes edhe të të ardhurave të vitit, subjekti dhe personi i lidhur rezultojnë me mundësi për të paguar shumën 2.000.000 lekë, me burime të ligjshme. Nga ana tjetër, duke ndjekur të njëjtën qasje, subjekti dhe personi i lidhur,

⁵⁴ Referuar faqes 18 të rezultateve të hetimit administrativ, qasje që rezulton të mos ketë pësuar ndryshim në vendimin përfundimtar, Komisioni shpreh: “Në kushtet kur vetë subjekti ka deklaruar se këto depozita janë krijuar nga kursimet *cash* të deklaruara ndër vite, duket se si vlerë e mundshme e kursimeve në formë likuiditetesh *cash*, e mbartur nga viti 2010, e cila mund të jetë përdorur për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2011, mund të ketë shërbyer shuma prej 1.620.400 lekësh”.

⁵⁵ Si më sipër, kjo vlerë përbën diferencën mes totalit të kursimeve *cash*, 3.500.000 lekë, deklaruar deri në fund të vitit 2010, me 1.879.600 lekë/ekuivalenti i 20.000 USD, deklaruar në gjendje në banesë, në mars 2012, në ILDKPKI.

sipas kësaj analize, rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme për të përballuar kështu e tretë, prej 1.200.000 lekësh, në datën 28.11.2011, pasi rezultojnë me mungesë burimesh në vlerën (-) 494.965 lekë.

12.29. Në përmbyllje të pretendimeve të ngritura në lidhje me pasurinë “apartament”, në rrugën “{***}”, Tiranë, blerë me çmimin 8.2 milionë lekë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se tërësia e rrethanave faktike të konstatuara në kontrollin e kësaj pasurie çon në përfundimin se pasuria në fjalë nuk është deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, e po ashtu, subjekti dhe personat e lidhur rezultuan, edhe në Kolegj, me mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e saj. Këto rrethana vlerësohen se e kualifikojnë subjektin e rivlerësimit sipas nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b” të ligjit nr. 84/2016, si dhe në kushtet e pikave 1 dhe 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

II. Analiza financiare 2003 - 2016

13. Komisioni ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2006, 2008, 2010, 2011 dhe 2012.

13.1. Subjekti pretendon se ka argumentuar gjerësisht se ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera, të deklaruara dhe të evidentuara për vitet me balancë negative, referuar likuiditeteve *cash* dhe në bankë, për vitet 2006 dhe 2008, shlyerjes së parakohshme të kredisë në vitin 2010 dhe likuidimin e çmimit të apartamentit në Tiranë gjatë vitit 2011. Subjekti, po ashtu, kërkon zbritjen e shpenzimeve telefonike të personit të lidhur, rillogaritje të kursit të këmbimit për likuiditetet *cash* edhe në bankë, si edhe rishikimin e shpenzimeve të jetesës.

13.2. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues i Kolegjit vëren se thuajse të gjitha këto argumente kanë gjetur arsyetim më sipër dhe në rastin e shpenzimeve të jetesës, në vendime të mëparshme. Përgjatë bërës shpenzimet e telefonisë si pjesë e shpenzimeve të jetesës. Meqenëse trupi gjykues që shqyrtoi ankimin e bashkëshortes së subjektit ka vlerësuar ta zbrësë këtë zë nga shpenzimet e jetesës për vitet përkatëse (2008 – 2012), edhe në analizën financiare të subjektit u procedua njësoj. Shpenzimet e telefonisë, edhe në këtë rast, në analizën e kryer në Kolegj, u zbritën nga shpenzimet e ekonomisë familjare të subjektit dhe personit të lidhur⁵⁶. Nga korrektimi i disa zërave të potencuar nga subjekti në ankim, në Kolegj rezultoi një balancë negative e burimeve të ligjshme, prej (-) 3.202.274 lekësh, përkundërt vlerës së konstatuar nga Komisioni prej (-) 3.423.414 lekësh. Vitet me balancë negative u konfirmuan edhe në Kolegj, e konkretisht 2006, 2008, 2010, 2011 dhe 2012⁵⁷. Ky rezultat e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016. Kjo balancë negative, së bashku me mungesën e burimeve të konstatuara në lidhje me pasurinë e analizuar më sipër, është e tillë që përjashton zbatimin e parimit të proporcionalitetit.

⁵⁶ Në linjë me qasjen e Kolegjit në vendimin e marrë për bashkëshorten e subjektit të rivlerësimit, nr. 37/2022 (JR), në paragrafin 24.9. Efekti në analizën financiare të shpenzimeve të jetesës që kanë këto shpenzime është vlerësuar 3.4% të vlerës totale.

⁵⁷ Kjo balancë është shumatorja e sa vijon: për vitin 2006, balanca negative është (774.903 lekë); për vitin 2008, balanca negative është (127.492 lekë); për vitin 2010, balanca negative është (1.628.604) lekë; për vitin 2011, balanca negative është (420.399) lekë; dhe për vitin 2012, balanca negative është (250.875) lekë.

13.3. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur më të, *nuk* kanë deklaruar saktë e në përputhje me ligjin dhe kanë *mungesë* të burimeve financiare të ligjshme, për të justifikuar krijimin e pasurisë dhe njëkohësisht kryerjen e shpenzimeve ndër vite, është rrjedhojë e një konstatimi të drejtë të situatës faktike dhe në zbatim të ligjit. Këto rrethana e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, me pasojë aplikimin e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, sipas parashikimeve në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

B.3. Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale dhe vlerësimin tërësor

14. Komisioni ka konkluduar që subjekti i rivlerësimit është i papërshtatshëm në vlerësimin profesional, pasi ka treguar mangësi serioze të indikatorit të *arsyetimit* ligjor, të aftësive *organizative*, dhe në respektimin e etikës, në kuptim të neneve 72, 74 dhe 75 të ligjit nr. 96/2016. Për këto shkaqe, Komisioni ka vlerësuar se subjekti ka treguar gjykim të dobët dhe cenuar të drejtat e palëve, duke përbërë shkelje që nuk mund të riparohen nëpërmjet programit të trajnimit, dhe subjekti është gjetur i papërshtatshëm nga ana profesionale, nën dritën e nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Po ashtu, Komisioni ka konkluduar se subjekti ka cenuar besimin e publikut, në vlerësimin tërësor, për shkak se është treguar jobashkëpunues gjatë hetimit administrativ në Komision. Këtë konkluzion, Komisioni e argumenton me atë që ka konsideruar mungesë të vullnetit për të dhënë shpjegime për denoncimet nga publiku, sikurse edhe për shkak të sjelljeve, nëpërmjet të cilave subjekti ka vështirësuar procesin e rivlerësimit. Konkretisht, referuar vendimit, Komisioni shprehet se subjekti ka vështirësuar procesin e rivlerësimit në fazën përfundimtare, si dhe nëpërmjet shtyrjeve të afatit, qoftë për dhënien e shpjegimeve apo për shtyrjen e procesit pa arsye të përligjura, kërkesave për përjashtim të një prej anëtarëve, dy vite pasi ishte informuar për trupin gjykues, sikurse edhe mënyrës se si ka zgjedhur të përballët me procesin nëpërmjet mosqenies i pranishëm. Të gjitha këto veprime janë arsyetuar si mungesë vullneti dhe vështirësi e subjektit për t'u përballur dhe provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit. Në fund, edhe i vetëm ky aspekt, sipas Komisionit, do të ishte i mjaftueshëm për të dhënë masën disiplinore për cenim të besimit të publikut, sipas nenit 61 pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

14.1. Subjekti kundërshton të gjitha këto konkluzione. Sikurse referuar në mënyrë të përmbledhur në paragrafin 5.7 më sipër dhe nënpjesët e tij, argumentet e subjektit për këtë konkluzion, në mënyrë të përmbledhur, konsistojnë në pretendimet që Komisioni ka mbajtur standard të dyfishtë në rastin e tij, ka interpretuar gabim dispozitat ligjore, që rregullojnë shmangien e konfliktit të interesit në detyrë. Subjekti i ka kryer veprimet hetimore drejt dhe në përputhje me ligjin, sikurse konstatuar edhe nga vendimet gjyqësore, sipas rastit. Subjekti po ashtu konteston mënyrën se si gjen zbatim cenimi i besimit të publikut në rastin e tij. Konkluzioni i mësipërm ankimohet nga subjekti, me pretendimin se ai ka qenë bashkëpunues, duke dhënë shpjegime dhe prova për të gjitha denoncimet. Sipas subjektit, në vendimin objekt ankimi, nuk argumentohet se për cilat denoncime ai nuk ka kthyer përgjigje.

14.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi aktet në fashikull dhe pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi se problematikën që ka konstatuar Komisioni në katër denoncimet qëndrojnë. Këto mangësi nuk janë pasojë e mungesës së njohurive, që mund të korrigjohet nëpërmjet një programi trajnimi në Shkollën e Magjistraturës. Subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore dhe në

arsyetimin e vendimeve, ka treguar mangësi organizative, si dhe ka ndjekur procedime penale në kushtet e papajtueshmërisë, përkatësisht nën dritën e nenit 75, pika 4 (cenimi i paanësisë, etikës e vlerave profesionale); nenit 73, pika 2 (aspekti i njohurive ligjore nëpërmjet ndërmarrjes së veprimeve për të hetuar dhe mbledhur prova), dhe nenit 73, pika 3 (arsyetimi dhe cilësia e analizës).

14.3. Trupi gjykues vlerësoi t'i përfshijë konkluzionet e sipërpërmbledhura në vlerësimin tërësor të çështjes. Ky qëndrim mban në konsideratë rrethanat specifike të rezultuara nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, mënyrën se si subjekti ka zgjedhur të shpjegojë veprimet e tij, referuar gjerësisht edhe më sipër në këtë arsyetim, dhe që gjithë panorama që rezulton, tregon veprime e mosveprime, të cilat pasqyrojnë zgjedhje të subjektit, magjistrat me përvojë të konsiderueshme profesionale. Parë në këtë kontekst dhe nën dritën e perceptimit të publikut, mënyra se si subjekti ka zgjedhur të kryejë një sërë veprimesh në funksionin e prokurorit, cenon besimin e publikut, qoftë parë në planin procedural, kundrejt të drejtave të palëve, apo në këndvështrimin etik e të parimit të drejtësisë, që duhet të shihet që bëhet.

14.4. Nga ana tjetër, ndonëse disa nga pretendimet e potencuara nga subjekti i rivlerësimit për këtë kriter u vlerësuan të bazuara, ato nuk passollën ndryshimin e këtij vlerësimi, në konsideratë të të gjitha aspekteve mbi të cilat bazohet konkluzioni për vlerësimin e kriterit të aftësisë profesionale apo atë tërësor, për subjektin e rivlerësimit. Vlerësimi i Kolegjit, i përmbledhur më lart, u bazua në rrethanat e konstatuara gjatë shqyrtimit të pretendimeve të subjektit në lidhje me kriterin e vlerësimit profesional, shtjelluar në vijim të këtij vendimi.

B.3.1. Analiza e pretendimeve që lidhen me arsyetimin ligjor

14.5. Komisioni e ka bazuar konkluzionin për papërshtatshmërinë në vlerësimin profesional të subjektit në konkluzionet që kanë rezultuar nga hetimi pas katër (4) denoncimeve nga publiku. Për 22 denoncime të tjera, Komisioni ka konstatuar se mungojnë rrethanat për indicie konkrete për t'i përfshirë në analizë.⁵⁸ Nga ana tjetër, ndonëse i ka konsideruar të pamjaftueshme shpjegimet e subjektit për 22 denoncimet për të cilat iu kalua barra e provës, Komisioni nuk rezulton të ketë arsyetuar se në cilin prej tyre ka konstatuar shpjegime të pamjaftueshme nga subjekti. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i bazuar. Konkluzioni për mungesë bashkëpunimi për këtë aspekt, për shkak të mosangazhimit të subjektit në procesin e rivlerësimit për të dhënë shpjegime, është përgjithësues për 18 denoncimet, të cilat në vlerësimin fundor u konsideruan pa rrethana apo indicie konkrete që mund të paraqisnin rëndësi në rivlerësimin e subjektit. Ky konstatim nuk cenon vlerësimin e Komisionit për katër (4) denoncimet e tjera.

14.6. Në vijim të sa më sipër, trupi gjykues vëren se është i bazuar konkluzioni i Komisionit, për sa rezulton nga hetimi, për denoncimet nga tre individë dhe një person juridik⁵⁹. Shpjegimet e subjektit janë përqendruar kryesisht në riprodhimin e veprimeve hetimore të kryera prej tij, por pa u ndalur në një analizë të çështjeve për të cilat iu kalua barrë prove. Për këtë arsye vlerësohet i drejtë konkluzioni i Komisionit, që të merret në konsideratë mungesa e bashkëpunimit nga subjekti, në kuptim të nenit 48,

⁵⁸ Referuar në paragrafin 45.5 dhe në detaj në poshtëshënimin nr. 75 të vendimit të Komisionit.

⁵⁹ Denoncimet e depozituara nga z. E. K., z. F. O., U. Sh. K. K. dhe z. A. H.

në vlerësimin tërësor, si pjesë integrale e sjelljes së demonstruar prej tij, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit.

14.7. Pretendimi i subjektit, se Komisioni nuk i ka krijuar mundësinë për dhënien e shpjegimeve, rezulton i pambështetur në ligj dhe në akte. Përpos sa arsyetuar gjerësisht në paragrafin 8 dhe nënpjesët e tij, dhe pa përsëritur faktet e referuara në mënyrë specifike në atë pjesë, në këtë rubrikë, trupi gjykues i Kolegjit çmon vetëm të theksojë që Komisioni e ka njohur subjektin e rivlerësimit me rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret dhe i ka kaluar barrën e provës në datën 12.05.2021. Në datën 24.05.2021, subjekti i rivlerësimit ka kërkuar shtyrjen e afatit, pasi i nevojitej më shumë kohë, veçanërisht për kriterin e *aftësive profesionale*. Komisioni e ka pranuar këtë kërkesë dhe e ka shtyrë afatin me 11 ditë, deri në datën 07.06.2021. Më datë 07.06.2021, subjekti ka dërguar prapësimet vetëm mbi kriterin e vlerësimit pasuror, ndërsa për gjetjet që lidhen me kriterin profesional, nuk ka dhënë sqarime. Në të njëjtën datë, subjekti ka kërkuar sërish shtyrjen e afatit për paraqitjen e prapësimeve dhe provave mbi rezultatet e hetimit, duke parashtruar si arsye, paaftësinë e përkohshme në punë. Komisioni e ka pranuar edhe këtë kërkesë dhe i ka dhënë kohë subjektit deri më datë 16.06.2021. Në këtë datë, subjekti ka dërguar prapësimet e plota lidhur me rezultatin e hetimit, duke dhënë shpjegimet, si për kriterin e pasurisë, ashtu edhe për atë profesional. Sa më sipër provon që Komisioni, jo vetëm i ka dhënë subjektit mundësi të japë shpjegime, por edhe dy herë kohë shtesë për depozitimin e prapësimeve. Në të njëjtën linjë, trupi gjykues i Kolegjit rithekson sa është arsyetuar gjerësisht më sipër, subjekti është njoftuar rregullisht për seancën dëgjimore dhe i janë respektuar të gjitha garancitë kushtetuese dhe konventore për t'u mbrojtur dhe dëgjuar. Këto të drejta, subjekti ka zgjedhur, me vullnet të qartë, të mos i ushtrojë. Për rrjedhojë, ky pretendim u vlerësua i pabazuar.

14.8. Së dyti, në kushtet që, nën dritën e dispozitave kushtetuese dhe ligjore, institucionet e rivlerësimit janë autonome në vlerësimin e tyre, për secilin prej tri kriterëve, Komisioni është brenda tagrave të tij të ketë një konkluzion të ndryshëm nga ai i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, për vlerësimin e aftësisë profesionale dhe raporti i tij duhet të jetë jashtë akteve që ka shqyrtuar raporti i institucionit tjetër. Po ashtu, secili prej konkluzioneve të Komisionit, për hetimin e kryer mbi bazën e denoncimeve për të cilat ka konstatuar mangësi, është arsyetuar në vendim, sikurse edhe në rezultatet e hetimit administrativ. Kjo duket qartë nga vendimi i Komisionit, ku pjesa që i dedikohet arsyetimit për këtë aspekt të kriterit të vlerësimit profesional përfshin faqet 37 - 43 të vendimit, paragrafët 45.7 deri në 49.10. Edhe fakti që subjekti ka mundur t'i dedikojë këtyre konkluzioneve faqet 99-110 të ankimit dhe 81-96 të parashtrimeve shtesë, konfirmon të kundërtën e këtij pretendimi. Ndërsa subjekti nuk është dakord me arsyetimin e Komisionit, cilësimi i mosdakordësisë si mungesë arsyetimi, është derivat i këtij kundërshtimi, por jo pasqyrim i një të mete në vendim, në këtë rast. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit, se Komisioni nuk ka arsyetuar vendimin, është i pabazuar.

14.9. Edhe pretendimi i subjektit, se Komisioni ka mbajtur standard të dyfishtë, pasi gjetjet e konstatuara duhet t'ia referonte Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë, është haptazi i pabazuar në pikën 4, të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. Kjo dispozitë, në mënyrë të shprehur,⁶⁰ gjen zbatim vetëm kur një subjekt

⁶⁰ “[4.] Pavarësisht se subjektit të rivlerësimit i jepet vendim për konfirmimin në detyrë, Komisioni ka të drejtë të transferojë çështjen pranë organit kompetent për inspektim, në rast se evidenton shkaqe që përbëjnë shkelje disiplinore, sipas legjislacionit që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, ose në rast se evidenton shkaqe për t'u marrë parasysh gjatë vlerësimit periodik të tij. Ndaj këtij vendimi nuk mund të bëhet ankim.”

konfirmohet në detyrë për të tria kriteret dhe përbën një parashikim plotësues të mënyrës se si veprohet nëse konstatohen problematika, të cilat nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkaku shkarkimi. Në kushtet që Komisioni ka konstatuar se për subjektin duhet të merrej masa disiplinore e shkarkimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, atë profesional dhe në vlerësimin tërësor, referimi i çështjeve për inspektim në ILD, përjashtojë si alternativë e mundshme.

15. *Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me denoncimin e z. E. K.*

15.1. Denoncuesi pretendon se prona e tij ka qenë objekt i një konflikti pronësie, për të cilin janë zhvilluar një proces gjyqësor, në vitin 2015 dhe një penal, në vitin 2018. Në procesin gjyqësor, çështjen e ka shqyrtuar bashkëshortja e subjektit, ndërsa ky i fundit ka ndjekur kallëzimin penal ndaj punonjësve të ALUIZNI-t, për shpërdorim detyre, iniciuar nga denoncuesi. Subjekti ka vendosur *mosfillimin* e procedimit penal për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, pasi ka argumentuar se konflikti ka natyrë administrative. Denoncuesi pretendoi se procesi penal *është ndikuar* nga procesi gjyqësor, për shkak të lidhjes bashkëshortore mes prokurorit/subjektit dhe gjyqtarës/bashkëshortes së subjektit. Denoncuesi ka rezultuar gjyqumbës në procesin administrativ⁶¹.

15.2. Komisioni ka konstatuar që subjekti kishte detyrimin të hiqte dorë nga hetimi i çështjes, nën dritën e nenit 26, lexuar së bashku me nenin 17 të Kodit të Procedurës Penale, për arsye njëansësie. Zëvendësimi i subjektit në këtë hetim nga një prokurore tjetër ka ndodhur vetëm pasi gjykata, e vënë në lëvizje nga denoncuesi, ka urdhëruar prokurorin të regjistronte procedimin. Komisioni pranoi me disa rezerva një akt të sjellë si provë gjatë hetimit administrativ, pasi i mungojnë rekuizitat e formës⁶² dhe duke theksuar që dorëheqja është dhënë mbi bazën e kërkesës së kallëzuesit/denoncues dhe meqenëse (subjekti) ishte caktuar drejtues i seksionit.

15.3. Subjekti i rivlerësimit ka mohuar të ketë qenë në kushtet e papajtueshmërisë, meqenëse ka dhënë dorëheqjen, çështja është hetuar e përfaqësuar në gjykatë nga një tjetër prokurore dhe rezultati i hetimit ka qenë i njëjtë. Prokurorja që e zëvendësoi, kërkoi pushimin e çështjes dhe gjykata ra dakord. Sipas subjektit, ai nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, pasi ka përmbushur testin objektiv dhe subjektiv për garantimin e paanshmërisë së tij në këtë proces. Subjekti nuk depozitoi fashikullin e plotë të materialit kallëzues, për të cilin ka vendosur mosfillimin e procedimit sipas kërkesës së Komisionit.

15.4. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit. Pavarësisht nga mënyra se si ka rezultuar në pikën fundore fati i kallëzimit penal, subjekti i ka kryer veprimet hetimore për këtë çështje në kushtet e *papajtueshmërisë*. Në bazë të nenit 17, shkronjat “dh” dhe “ë”, të Kodit të Procedurës Penale, subjekti kishte detyrimin të hiqte dorë nga hetimi i kësaj çështjeje penale për shkaqe të rëndësishme njëanshmërie, në kushtet që për rrethanat që përbëjnë thelbin e kallëzimit ka pasur një vendim të marrë nga bashkëshortja, disa vite më herët. Këtë kontekst e konfirmon edhe vetë subjekti, i cili pretendon që me informacionin për drejtuesin e prokurorisë, depozituar në Komision, ka dhënë

⁶¹ Bashkëshortja e subjektit ka shqyrtuar çështjen administrative me palë ndërgjyqëse: paditës/denoncuesi, i paditur/ALUIZNI dhe persona të tretë, me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së lejes së legalizimit, lëshuar në emër të denoncuesit [...] Detyrimin e ALUIZNI-t Tirana 1, të bëjë korrigjimin e dy lejeve të legalizimit, bazuar në situatën faktike në terren. Me vendimin nr. {***/2015, bashkëshortja e subjektit ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë të paditësit/denoncuesit.

⁶² Sipas vendimit të Komisionit, poshtëshënimi nr. 78. Akti është i thjeshtë, në formatin Word, pa nënshkrim, i paprotokolluar, dhe pa vulë.

dorëheqjen nga hetimi i kësaj çështjeje, në *nëntor 2019*. Edhe duke abstraguar nga problematika e referuar më sipër mbi formën e këtij dokumenti, vërehet se pas rreth një viti pasi subjekti kishte marrë vendim mosfillimi, në datën 25.09.2018, ai ka kërkuar dorëheqjen, duke argumentuar, ndër të tjera, se: “[...] Nga ana e kallëzuesit ka pasur pretendime në lidhje me paanësinë e prokurorit [...]”.

15.5. Pretendimet e subjektit janë të pabazuara, edhe parë në aspektin kohor, pasi bien në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe me aktet. Sikurse konstatuar edhe gjatë hetimit administrativ, në shkresën për drejtuesin e prokurorisë, që mban datën 04.11.2019 (referuar më sipër), subjekti i rivlerësimit shprehet se kërkon të heqë dorë bazuar në faktin që gjykata ka urdhëruar *fillimin e hetimeve*. E thënë ndryshe, subjekti ka kërkuar dorëheqjen 14 muaj pasi ishte regjistruar kallëzimi dhe pasi vendimi i tij i mosfillimit ishte kontestuar me sukses nga kallëzuesi. Edhe interpretimi që subjekti i bën dispozitave të konfliktit të interesit, me fokus përcaktimin e çastit të fundit të procesit vendimmarrës, është i gabuar. Sikurse rezulton nga përmbajtja e dispozitës të nenit 4/2 të ligjit nr. 9367/2005, zbatuar në situatën konkrete, çasti i fundit i procesit vendimmarrës⁶³ nga një prokuror nuk mund të jetë vendimmarrja nga *gjykata* – sikurse argumenton subjekti në mbështetje të pretendimit të tij. Natyrshëm, çasti i fundit i vendimmarrjes së një prokurori është vendimmarrja e tij/saj, në këtë rast për mosfillimin e një procedimit bazuar mbi kallëzimin e denoncuesit. Po ashtu, referuar nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, vendimi i prokurorit për mosfillim shqyrtohet nga gjykata *vetëm* mbi bazën e një ankimi, përndryshe mbetet në fuqi. Parë edhe duke marrë në konsideratë këtë veçori me pasojë për palët, nën dritën e nenit 4/2 të ligjit nr. 9367/2005, së bashku me parashikimin e nenit 291 të Kodit të Procedurës Penale, çasti i fundit i procesit vendimmarrës është edhe një vendim mosfillimi nga prokurori. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të hiqte dorë përpara marrjes së këtij vendimi, sidomos në kushtet që kallëzuesi kontestonte paanësinë e tij (e subjektit), sikurse rezulton nga informacioni për drejtuesin e prokurorisë, depozituar prej tij në Komision.

15.6. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se është pa peshë pretendimi i subjektit, se denoncuesit nuk i është cenuar asnjë e drejtë kushtetuese, meqenëse edhe prokurorja që vijoi hetimet, kërkoj pushimin e çështjes në gjykatë, pasi konstatoi se denoncimi nuk përmban elemente të ndonjë veprë penale. Në kushtet që ky denoncim analizohet vetëm në drejtim të pretendimit të denoncuesit për cenim të paanësisë dhe duke konstatuar që subjekti nuk ka sjellë akte për të provuar këtë pretendim, ky aspekt mbeti deklarativ. Së fundmi, edhe nëse pranohet pretendimi i subjektit për rezultat të njëjtë pas hetimit të kryer, fakti që subjekti ka vendosur *mosfillim* nuk mund të barazohet me pushimin e çështjes, pavarësisht ngjashmërive në dispozitat që parashikojnë rastet për secilin veprim nga prokurori⁶⁴. Sikurse theksuar më sipër, vendimi i mosfillimit shqyrtohet nga gjykata vetëm nëse ndaj tij ushtrohet ankim, ndërsa për pushimin e çështjes, vendimmarrja fundore është tagër e gjykatës. Kjo dinamikë procedurale e bën automatikisht më të mbrojtur kallëzuesin në rastin e pushimit të një procedimi, krahasuar me mosfillimin, për shkak se garanton që pretendimet e shfaqura në ankim t’i nënshtrohen hetimit për të pasur një përgjigje shteruese për sa kallëzohet.

⁶³ “[2.] Për qëllimet e këtij ligji: a) vendimmarrje për një akt do të vlerësohet, në çdo rast, çasti i fundit i procesit vendimmarrës, gjatë të cilit vendoset përmbajtja përfundimtare e aktit; b) vendimmarrje për një akt do të vlerësohen edhe ato çaste paraprake të vendimmarrjes, sipas shkronjës “a” të kësaj pike, të cilat janë thelbësisht të rëndësishme dhe përcaktuese për përmbajtjen përfundimtare të aktit; c) një zyrtar ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese për një akt, nëse pjesëmarrja, ndikimi dhe qëndrimi i tij në vendimmarrjen për këtë akt, sipas shkronjave “a” ose “b” të kësaj pike, përcaktojnë përmbajtjen e aktit. [...]”

⁶⁴ Rregulluar përkatësisht nga nenet 290 dhe 291 dhe 328 e 329/a të Kodit të Procedurës Penale.

15.7. Së fundmi, trupi gjykues i Kolegjit vëren se është i pabazuar në ligj pretendimi i subjektit, se konkluzioni i Komisionit për cenim të parimit të paanësisë është interpretim i gabuar i pikës 4, të nenit 75, të ligjit nr. 96/2016. Sipas subjektit, kjo dispozitë me konceptin në *burimet e tjera*, nënkupton të dhënat e përpiluara nga institucione të përcaktuara për këtë qëllim (siç është KLP-ja ose institucione të tjera). Argumentimi i subjektit bazohet në një analizë të cunguar të kuadrit ligjor, që anashkalon disa dispozita, duke zgjedhur vetëm në një pjesë, të njërës prej tyre. Konkretisht, dispozita e referuar nga subjekti parashikon që:

“[4.] Paanësia e magjistratit, në lidhje me kujdesin e tij ndaj konfliktit të interesit [...] matet duke u bazuar në tregues të tillë si përdorimi i gjuhës diskriminuese, numri tejet i lartë i kërkesave të pranuarra të palëve për përjashtimin e magjistratit, si dhe tregues të tjerë që dalin nga burime të tjera vlerësimi”.

15.8. Ndërsa burimet e vlerësimit nuk janë ndër konceptet e përkufizuara nga ligji nr. 96/2016, neni 77 i tij përcakton 11 burime vlerësimi për magjistratët, përfshirë edhe raportet e organeve audituese e kontrolluese, përpos të dhënave pas verifikimit të *ankesave*, dosjeve të zgjedhura me short, e të tjera, në funksion të procesit të *zakonshëm* të vlerësimit⁶⁵. Nga ana tjetër, procesi i rivlerësimit është kalimtar/i *jashtëzakonshëm* dhe institucionet e rivlerësimit i ushtrojnë funksionet e tyre bazuar jo vetëm në ligjin nr. 96/2016, por edhe nr. 84/2016, ndër të tjera. Kjo nënkupton që, përpos burimit të vlerësimit të shprehur në nenin 77 të ligjit nr. 96/2016, Komisioni dhe Kolegji kryejnë vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale, duke analizuar së bashku nenin 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, me disa prej dispozitave të ligjit nr. 84/2016, përfshirë sa rezulton nga hetimi i kryer mbi bazën e denoncimeve nga publiku⁶⁶.

15.9. Në përmbledhje të analizës së mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit *ka trajtuar materialin kallëzues/çështjen në kushtet e papajtueshmërisë*. Në zbatim të parashikimit të neneve 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale, subjekti mbartte detyrimin të hiqte dorë nga hetimi i çështjes penale për fakte të kallëzuara që lidheshin me rrethana, të cilat i kishte shqyrtuar edhe bashkëshortja e tij më parë. Nga analiza e integruar e shpjegimeve të subjektit, akteve në fashikull dhe arsytimit në vijim, trupi gjykues çmon se veprimet e subjektit nuk tregojnë mungesë njohurish, që mund të korrigjohet nëpërmjet një programi trajnimi në Shkollën e Magjistraturës. Ky konkluzion është pjesë e vlerësimit tërësor të çështjes, nën dritën e perceptimit të publikut, qoftë në planin e të drejtave të palëve në proces, ashtu edhe në këndvështrimin etik e të parimit të drejtësisë, që duhet të shihet që bëhet.

⁶⁵ Neni 77 i ligjit nr. 96/2016 përcakton: “Vlerësimi i magjistratëve bazohet në këto burime: a) dosja personale e magjistratit; b) të dhënat statistikore, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 90 të këtij ligji; c) dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim, sipas nenit 91, të këtij ligji, duke përfshirë edhe regjistrimet e seancave me mjete audio ose video, në lidhje me dosjet gjyqësore, të cilat duhet të mbulojnë plotësisht të gjitha llojet e çështjeve të gjykuara dhe të hetuara; ç) vlerësimi i kryer nga magjistrati dhe vendimet gjyqësore ose aktet e hartuara prej prokurorit dhe të përzgjedhura prej tij. Në çdo rast, numri i vendimeve/akteve të hartuara dhe të përzgjedhura prej prokurorit nuk duhet të jetë më shumë se 2 në vit; d) mendimi i kryetarit; dh) të dhënat për verifikimin e ankësive të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit; e) informacioni me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës ose institucione të tjera, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në veprimtaritë trajnuese; ë) vendimet përfundimtare për masat disiplinore ndaj magjistratit që janë dhënë gjatë periudhës së vlerësimit, në mënyrë të pavarur, nëse masa disiplinore është shuar ose jo; f) raportet e kërkuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ose institucione të tjera audituese ose kontrolluese; g) kundërshtimet e magjistratit dhe çdo procesverbal ose dokument i seancës dëgjimore gjatë procesit të vlerësimit; gj) çdo e dhënë tjetër, që tregon ngritjen profesionale të magjistratit”.

⁶⁶ Referuar nenit 43, pika 4, neni 49, pika 1, germa “b” dhe neni 53 të ligjit nr. 84/2016.

16. *Analiza e shkaqeve të ankimit që lidhen me denoncimin e z. F. O.*

16.1. Denoncuesi ka pretenduar për veprime të paligjshme, për prishjen dhe shkatërrimin e pronës së tij nga punonjës të administratës publike. Ai shprehet se përpjekjet e tij pranë organeve të drejtësisë kanë qenë të pasuksesshme dhe këto organe “i pushojnë çështjet e tij pa asnjë bazë ligjore”. Denoncuesi ka pasur një mosmarrëveshje administrative me ALUIZNI-n dhe organe të tjera shtetërore. Gjykata Administrative e Apelit, në datën 23.01.2018, ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Pjesë e trupit gjykues në Apel ka qenë edhe bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit. Subjekti ka regjistruar procedimin penal në datën 16.05.2018. Subjekti ka vendosur *pushimin* e procedimit penal (nr. {***/2018), të nisur mbi bazën e kallëzimit të denoncuesit. Kërkesa (pa datë), për pushimin e çështjes, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i është njoftuar palëve më 01.06.2018.

16.2. Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka vlerësuar me përgjegjësi dhe seriozitet gjetjet e pasqyruara në rezultatet të hetimit, ka dashur të evitojë shpjegimet, në përpjekje për të shmangur veten nga përgjegjësia ligjore që lidhet me këtë rast. Nga aktet rezulton se, me rezultatet e hetimit, Komisioni ka konstatuar që subjekti ka vepruar në shkelje të neneve 26 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak të mosrespektimit të detyrimit për heqje dorë nga hetimi i çështjes penale për fakte të kallëzuara, për të cilat ka mbajtur qëndrim edhe bashkëshortja e tij, në vendimin nr. {***}, datë 23.01.2018, të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Për rrjedhojë, subjekti është gjendur në kushtet e cenimit të paanësisë, të etikës e vlerave profesionale, në kuptim të nenit 75, pika 4 e ligjit nr. 96/2016.

16.3. Subjekti pretendon se ky konkluzion është i pambështetur në fakte dhe në ligj. Ai nuk ka qenë në dijeni të vendimit të dhënë nga bashkëshortja e tij. Ky i fundit nuk ka ndikuar në pushimin e çështjes prej tij. Papajtueshmëria në hetim e subjektit nuk është pretenduar nga denoncuesi, i cili duhet të kishte kërkuar përjashtimin e tij. Për pasojë, “kjo e drejtë e tij ka rënë në dekadencë”. Në përgjigjet e dhëna pas kalimit të barrës së provës, subjekti është fokusuar vetëm mbi rrethanat e çështjes dhe vendimmarrjen e tij, dhe ka heshtur për detyrimin për të hequr dorë nga hetimi, duke u bazuar në një lapsus të Komisionit në vitin e vendimmarrjes⁶⁷ dhe theksuar që bashkëshortja ishte gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat në vitin në fjalë. Subjekti është fokusuar në faktin që, me vendim të formës së prerë, gjykata ka vlerësuar se veprimet hetimore dhe vendimmarrja e subjektit ka qenë në përputhje me ligjin. Me parashtrimet shtesë në Kolegj, subjekti depozitoi në cilësinë e provave disa vendime,⁶⁸ referuar në hyrje të këtij arsyetimi, në pjesën e analizës së akteve të sjella përpara seancës në Kolegj. Analiza për arsyet e mospranimit të këtyre akteve është shtjelluar gjerësisht në paragrafin 7.1.

16.4. Trupi gjykues i Kolegjit e gjen të bazuar konkluzionin e Komisionit. Subjekti i rivlerësimit është gjendur në kushtet e konfliktit të interesit dhe duhet të kishte hequr dorë nga ndjekja e këtij hetimi. Nga ana tjetër, fakti që me vendimin e marrë prej tij ka qenë dakord edhe gjykata, ka lidhje me aspektin e themelit të çështjes, për të cilin Komisioni nuk ka kryer hetime dhe as ka bërë vlerësim, sikurse rezulton

⁶⁷ Në rezultatet e hetimit, Komisioni ka referuar gabim vitin në të cilin ishte marrë vendimi nga bashkëshortja, duke cituar 23.01.2008, në vend të datës 23.01.2018.

⁶⁸ Vendimin nr. {***}, datë 31.10.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***} akti, datë 24.09.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si edhe vendimin nr. {***}, datë 11.04.2024, të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga kallëzuesi F. O., kundër vendimit nr. {***}, datë 31.10.2018, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

qartë edhe në konkluzionin përfundimtar.⁶⁹ Komisioni, po ashtu, nuk ka konkluduar për ndikim të procesit gjyqësor penal nga vendimi i dhënë nga bashkëshortja e subjektit. Subjekti kishte detyrimin të kërkonte heqjen dorë, në zbatim të neneve 26 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, për shkak se ekzistojnë arsye njëanësie.

16.5. Sikurse referuar më sipër, për natyrën taksative të neneve 26 dhe 17 të Kodit të Procedurës Penale, zbatimi i detyrimeve ligjore që ato parashikojnë nuk kushtëzohet nga garancitë që mund të japin subjektet procedurale (gjyqtar e prokuror) për kryerjen me paanësi të hetimit dhe përfaqësimit në gjyq. Nga ana tjetër, pretendimi i subjektit, se papajtueshmëria e tij në hetim “ka rënë në dekadencë”, është po ashtu i pabazuar në kontekstin e kontrollit të kryer në procesin e rivlerësimit. Së pari, palët pjesëmarrëse në një proces, jo domosdoshmërisht prezumohet të kenë dijeni për lidhjet bashkëshortore, të gjakut e farefisnore të prokurorit të çështjes apo të gjyqtarëve. Gjithashtu gjuha e pikës 1, të nenit 18, të Kodit të Procedurës Penale përcakton si të drejtë të palëve e diskrecion të tyre kërkimin e përjashtimit, duke parashikuar shprehimisht që “*palët mund të kërkojnë përjashtimin [...]*”. E kundërta rezulton nga leximi i nenit 26 i Kodit të Procedurës Penale, i cili përcakton qartë detyrimin për heqje dorë, duke përcaktuar shprehimisht se: “*prokurori ka për detyrë të heqë dorë*” në rastet e parashikuara nga neni 17. Me fjalë të tjera, sipas ligjit heqja dorë është detyrim, i cili duhet përmbushur nga vetë prokurori kryesisht, sapo konstaton rrethanat. Ky veprim nuk përbën zgjedhje dhe as kushtëzohet me kërkimin e palëve për përjashtim prokurori. I parë në këtë këndvështrim, pretendimi i subjektit, bazuar në faktin që denoncuesi duhet të kishte kërkuar heqjen dorë gjatë procesit apo që ky kërkim ka rënë në dekadencë, nuk është në përputhje me ligjin dhe duket edhe i pasinqertë për një magjistrat.

16.6. Edhe pretendimi i subjektit për mungesë dijenie të tij për shqyrtimin në gjykatë të këtij konflikti, rezulton i pabazuar, pasi bie ndesh me aktet e paraqitura prej tij në këtë çështje. Konkretisht, në kërkesën për pushimin e çështjes, subjekti ka argumentuar, ndër të tjera, se: “*Pretendimet e kallëzuesit në lidhje me prishjen e këtij ndërtimi janë trajtuar dhe duke u shqyrtuar civilisht në sistemin gjyqësor dhe konkretisht në Gjykatat e Shkallës së Parë dhe ato të Apelit [...]*”. Së fundmi, edhe pretendimi në parashtrimet e depozituara në Kolegj, se bashkëshortja nuk ka shprehur mendim, pasi vendimi kishte për objekt sigurimin e padisë, dhe është marrë nga një trup gjykues dhe jo nga ajo e vetme, është jo vetëm i pambështetur në fakte, por edhe i pabazuar në ligj. Vendimi objekt analize,⁷⁰ i marrë nga trupi gjykues, pjesë e të cilit ishte edhe bashkëshortja e subjektit, ishte një gjykim themeli, në kushtet që objekti kryesor i padisë ishte detyrimi për nxjerrje leje legalizimi në emër të paditësit. Sigurimi i padisë për pezullimin e ekzekutimit të çdo akti administrativ që pengon nxjerrjen e lejes së legalizimit, ishte objekt dytësor.

16.7. Po kështu, edhe pretendimi që bashkëshortja nuk ka gjykuar e vetme, por në cilësinë e anëtares e trupit gjykues, nuk prezumon mosdhënie mendimi nga ana e saj, pasi vota e secilit anëtar të trupit gjykues ka të njëjtën peshë. Pretendimet e subjektit janë haptazi në kundërshtim me aktet dhe produkt mungese sinqeriteti, në kushtet që ato janë parashtruar nga një magjistrat karriere. Për rrjedhojë, edhe me parashtrimet në Kolegj, subjekti nuk arriti të shpjegojë e ndryshojë konkluzionin se ai nuk ka respektuar detyrimin për heqje dorë nga hetimi i kësaj çështjeje. Ky konkluzion u arrit edhe duke abstraguat nga aspektet e tjera për papranueshmërinë e akteve referuar më sipër.

⁶⁹ Shih paragrafin 45.7, shkronja a.6, dhe pikën 47 e nënpikat në faqet nr. 37 dhe 39 të vendimit objekt ankimi.

⁷⁰ Vendimi nr. {***}, datë 23.01.2018, i Gjykatës së Apelit Administrativ.

16.8. Për sa analizuar më sipër dhe parë e vlerësuar nën optikën e sjelljes së subjektit, në raport me procesin e rivlerësimit, trupi gjykues konstaton, edhe në këtë denoncim, se subjekti i rivlerësimit ka anashkaluar shpjegimet për problemet e ngritura, duke zgjedhur të merret me aspekte të pakontestuara, që i përkasin themelit të çështjes penale. Parë në këtë aspekt, vlerësohet i drejtë konstatimi i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime dhe dokumentacionin për çdo çështje për të cilën iu kalua barra e provës, sjellje e cila, edhe në çmim të Kolegjit, duhet të merret në konsideratë në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17. *Analiza e shkakut të ankimit për denoncimin nga U. Sh. K. K.*

17.1. U. Sh. K. K. (në vijim UShKK), pretendon se ka paraqitur një kallëzim penal për shpërdorim të detyrës dhe vjedhje përmes shpërdorimit të detyrës, kundër një përmbaruesi gjyqësor, në datën 27.11.2018. Në datën 18.01.2019, subjekti i rivlerësimit ka njoftuar UShKK-në për *mosfillimin* e procedimit penal. Sipas UshKK-së: (i) Subjekti nuk ka kryer veprime të thelluara hetimore. (ii) Nuk ka respektuar afatet e njoftimit të vendimit të mosfillimit, parashikuar nga neni 291 i K. Pr. Penale. (iii) Vendimi i tij nuk është i qartë, është i paarsyetuar dhe i pakuptueshëm. (iv) Subjekti ka hetuar në papajtueshmëri të plotë, për shkak të shprehjes së mendimit në një tjetër procedim penal të lidhur me këtë çështje, në vendimin nr. {***}, datë 01.10.2018, ku ka vendosur mosfillim procedimi lidhur me kallëzimin e UShKK-së. Denoncuesi pretendon se në rast se do të ishte thirrur gjatë hetimit, do të kishte kërkuar përjashtimin e subjektit. (v) Subjekti nuk ka hetuar mbi dëmin e shkaktuar kallëzuesit nga veprimet e përmbaruesit.

17.2. Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e pretendimeve të ngritura në këtë denoncim, të pasqyruara si gjetje në rezultatet e hetimit administrativ. Ai ka demonstruar, minimalisht, mangësi të theksuara të njohurive ligjore, nëpërmjet rolit të tij pasiv në kryerjen e veprimeve hetimore dhe në funksion të zbardhjes së çështjes. Problematikat serioze e të papranueshme, referuar eksperiencës dhe përvojës së tij profesionale të hasura në këtë procedim, përbëjnë defekte të aspekteve ligjore, në kuptim të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

17.3. Në prapësim të barrës së provës, subjekti ka dhënë shpjegime të përgjithshme, që konsistojnë në parashtrimin e rrethanave, të cilat përbëjnë ripërsëritje të vendimit të mosfillimit. Për sa i përket ecuresë së kësaj çështjeje, subjekti ka deklaruar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. {***} akti, datë 23.04.2019, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të tij të mosfillimit, por nuk ka sjellë një kopje të tij. Në ankim dhe parashtrimet e depozituara në Kolegj, subjekti ka pretenduar se vendimi objekt ankimi është i paarsyetuar, pasi nuk evidenton problematikat e papranueshme dhe që e vendosin subjektin në kushtet e nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, dhe është në kundërshtim me vendimin e gjykatës, e cila e ka gjetur të drejtë vendimin e tij për mosfillimin e procedimit penal. Me parashtrimet shtesë, subjekti ka depozituar në Kolegj vendimet e gjykatave që kanë lënë në fuqi vendimin e tij të mosfillimit,⁷¹ referuar në hyrje të këtij arsytimi, në pjesën e analizës së akteve të sjella përpara seancës në Kolegj. Analiza për arsyet e mospranimin të këtyre akteve është shtjelluar gjerësisht në paragrafin 7.1.

⁷¹ Përkatesisht, vendimin nr. {***}, datë 03.06.2024, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, i cili ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 23.04.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

17.4. Nga analiza e akteve në fashikull, trupi gjykues i Kolegjit vëren se edhe ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Në vendimin objekt ankimi,⁷² Komisioni ka referuar pretendimet e ngritura nga denoncuesi UShKK, të cilat i janë njoftuar subjektit përmes rezultateve të hetimit, referuar edhe më sipër në përmbledhje të pretendimeve të denoncuesit. Komisioni ka referuar edhe praktikën unifikuese⁷³ të Gjykatës së Lartë, për sa i përket detyrave të prokurorisë që të mbajë të informuar në fazën e hetimit edhe denoncuesin në cilësinë e njoftuesit të veprës penale. Problematikat kanë evidentuar rolin pasiv të subjektit në kryerjen e veprimeve hetimore në funksion të zbardhjes së çështjes, vonesën në kryerjen e veprimeve procedurale përtej afateve dhe papajtueshmërinë e subjektit për kryerjen e hetimeve, për shkak të shprehjes së mendimit në një tjetër procedim të lidhur apo edhe mosrespektim nga ana e tij të afateve të përcaktuara qartë në Kodin e Procedurës Penale. Subjekti nuk ka dhënë shpjegime për çështjet e kërkuara nga Komisioni si referuar më sipër. Edhe në ankim, subjekti i rivlerësimit ka zgjedhur të japë shpjegime vetëm mbi rrethanat e çështjes dhe argumentet që lidhen me vendimmarrjen e tij, pa u ndalur në pretendimet specifike të ngritura, të referuara në rezultatet e hetimit administrativ. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është haptazi i pabazuar në akte.

17.5. Në të njëjtën linjë, nëse konsiderohet argumenti që gjykata ka lënë në fuqi vendimet e marra prej tij, si ilustrim zëvendësues/alternativë e shpjegimeve të padhëna prej tij, trupi gjykues i Kolegjit çmon se gjykata⁷⁴ nuk ka analizuar në mënyrë specifike pretendimet për të cilat subjektit i ka kaluar barra e provës, e konkretisht, pretendimet për rolin pasiv të prokurorit/subjektit në kryerjen e veprimeve hetimore në zbardhjen e çështjes, papajtueshmërinë e tij për kryerjen e hetimeve për shkak të një tjetër procedimi penal të lidhur apo për mosrespektimin e afateve të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale. Në këtë këndvështrim, trupi gjykues i Kolegjit e gjen pa peshë përcaktuese këtë vendim të depozituar me parashtrimet shtesë.

17.6. Si vlerësim dytësor, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë rëndësinë që ka qasja bashkëpunuese dhe transparente, që subjekti do të duhet ta kishte zgjedhur më së paku në procesin në Kolegj, duke sjellë shpjegimet e argumentet e tij për sa është në analizë. Kufizimi minimalist në potencimin e faktit që gjykata ka lënë në fuqi vendimin e tij, nuk mund të zëvendësojë peshën që kanë kundërgargumentet e tij dhe vullneti për të respektuar procesin. Ky vlerësim mban në konsideratë edhe që disponimi i njëjtë i gjykatës nuk nënkupton se pyetjet dhe çështjet e ngritura nga denoncuesi mbivendosen saktësisht me qëndrimin e gjykatës. Përkundrazi, gjykata nuk ka marrë në analizë asnjë prej shkaqeve të ankimit të relatuar prej saj në pjesën hyrëse të vendimit, të cilat konstatohen se janë të njëjta me ato të parashtruara në denoncimin përkatës në Komision, dhe as ka arsyetuar përse nuk ka vend për hetim për veprat penale të kallëzuara.

17.7. Në konkluzion, trupi gjykues i Kolegjit i mbajti në vëmendje gjetjet e mësipërme, kryesisht në vlerësimin tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe të përgjegjësisë së subjekteve për të treguar frymë bashkëpunimi e transparencë gjatë procesit të rivlerësimit, nën dritën e nenit 48 të ligjit

⁷² Pika 48 dhe nënparagrafët respektivë.

⁷³ Vendimi unifikues nr. 2, datë 20.06.2013, pika 15: “Rastet e mosfillimit të çështjes penale nuk kërkojnë ndonjë hetim të thellë. Konstatimi i rrethanave është i lehtë dhe përgjithësisht bëhet para fillimit të procedimit penal, për këtë, mjaftojnë vetëm disa verifikime të shpejta për të konkluduar rreth marrjes së një vendimi mosfillimi. Si subjekte që marrin pjesë në këtë fazë, përveç prokurorit dhe policisë gjyqësore, janë edhe kallëzuesi, si njoftues i veprës penale, e në varësi të rastit, edhe personi të cilit i atribuohet vepra penale”.

⁷⁴ Vendimi nr. {***}, datë 03.06.2024, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

nr. 84/2016, duke i atribuuar peshë mungesës së vullnetit të subjektit për të qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit, treguar në hetimin e këtij denoncimi, në qasjen e pasinqertë të tij dhe shmangien e dhënies së shpjegimeve për problematikat apo orientuar ato drejt themelit të vendimmarrjes, që ishte aspekt i pakontestuar nga Komisioni.

18. *Analiza e shkaqeve të ankimit për denoncimin e paraqitur nga A. H.*

18.1. Denoncuesi pretendon për veprime të dyshimta të subjektit, ndër të tjera, në një procedim penal të vitit 2013 (nr. {***/2013}), për të cilin ka pasur analizë edhe në lidhje me një subjekt tjetër rivlerësimi⁷⁵. Denoncuesi pretendon se problematikat e konstatuara në mungesën e veprimeve të plota hetimore të kësaj çështjeje, pjesërisht i atribuohen edhe subjektit të rivlerësimit Ervin Karanxha. Procedimi penal është regjistruar për dhënien ndihmë të kalimit të paligjshëm të kufirit, në ngarkim të një të pandehuri, transferuar nga Prokuroria për Krimet e Rënda, Prokurorisë Tiranë. Subjekti ka qenë prokurori i çështjes në periudhën tetor 2013 – nëntor 2014.

18.2. Komisioni ka konkluduar se subjekti ka demonstruar minimalisht mangësi të njohurive të ligjit, pasi ka qenë pasiv dhe joefikas në veprimtarinë hetimore të kryer në këtë procedim penal, për sa i përket kërkesave për ndryshimin e masës së sigurimit personal, vendimeve për kthimin e sendeve të sekuestruara, kërkesës për gjykim dhe konkluzioneve përfundimtare të paraqitura prej tij lidhur me këtë procedim penal, rrethana për të cilat subjekti duhet të kishte ushtruar kujdes dhe vëmendje të posaçme. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar rol pasiv në drejtim të veprimtarisë hetimore në funksion të zbardhjes çështjes, si dhe vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve. Këto veprime, sipas Komisionit, janë të qëllimshme dhe e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e defekteve të dukshme të njohurive ligjore, në kuptim të nenit 73, pika 2 e ligjit nr. 96/2016.

18.3. Në prapësim të barrës së provës dhe në ankim, subjekti i rivlerësimit e kundërshton këtë konkluzion. Në mënyrë të përmbledhur, argumentet e tij janë që masa e sigurimit për të pandehurit “arrest në shtëpi”, është caktuar në përputhje me ligjin, në kushtet e pamundësisë për zgjatjen e afateve të paraburgimit, të cilat kishin nisur përpara transferimit të dosjes nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, kthimi i sendeve të sekuestruara është kryer në përputhje me ligjin, hetimet janë zgjatur sipas kërkesës së Oficerit të Policisë Gjyqësore (OPGj) dhe çështja është dërguar menjëherë në gjyq në përfundim të hetimeve. Afati nuk është respektuar nga OPGj-ja, në pritje të ardhjes së letërporosisë. Së fundmi, subjekti potencon që ka kërkuar masë dënimi në përputhje me ligjin, e dhënë edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit e konsideron paragjyquese gjetjen e Komisionit për kërkimin e ndryshimit/zbutjes së masës së sigurimit brenda një jave. Sipas subjektit, trupi gjykues i Komisionit “nuk e ka lexuar dosjen”, pasi aktet dhe ligji tregojnë se ka vepruar drejt. Subjekti ankimon gjetjen e Komisionit, për heqjen e sekuestros brenda 24 ditësh nga caktimi i çështjes dhe kthimi i tre telefonave celularë dhe të automjetit të sekuestruar një prej të pandehurve (z. H. M.). Sipas tij, në citimin se këto sende nuk përbënin mjetet nëpërmjet të cilave konsumohej vepra penale në fjalë, prokuroria dhe gjykata kanë arritur në të njëjtin konkluzion. Po ashtu, konkluzioni i Komisionit se ishte i dyshimtë kërkimi nga subjekti të një dënimi në minimumin e parashikuar nga ligji, bazohet mbi hamendësim.

⁷⁵ Referuar poshtëshënimit nr. 81 të vendimit objekt ankimi, Komisioni ka administruar për këtë denoncim dosjen e rivlerësimit të subjektit Sh. K.

18.4. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se, ndonëse disa nga argumentet e potencuara nga subjekti qëndrojnë, ka aspekte të tjera të veprimtarisë hetimore, që rezultojnë nga aktet, të cilat tregojnë se konkluzioni i Komisionit është i drejtë. Nga vendimi i Komisionit rezultojnë me relevancë për konstatimin e ankimuar: (i) kërkesa e subjektit për llojin e masës së sigurimit; (ii) kthimi i telefonave të sekuestruar; (iii) zgjatja e afateve të hetimit dhe (iv) kërkimi përfundimtar për masën e dënimit gjatë procesit gjyqësor. Analiza e veprimeve të kryera nga subjekti dhe shpjegimeve të tij tregojnë që konkluzioni i Komisionit qëndron për tri nga katër aspektet, e konkretisht për mangësitë organizative të treguara në zgjatjen e afatit hetimor, në kthimin e pajustificuar dhe paarsyetuar të sendeve të sekuestruara, dhe për sa i përket masës së dënimit. Për sa i përket masës së sigurimit, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit janë të bazuara në ligj. Arsyetimi mbi të cilin bazohet ky konkluzion shtjellohet në vijim.

18.5. Subjekti i rivlerësimit është ngarkuar me hetimin e këtij procedimi penal pas transferimit të çështjes në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë nga Prokuroria për Krime të Rënda,⁷⁶ në datën 30.09.2013. Një ditë më pas, në 01.10.2013, ai vendosi regjistrimin e procedimit penal në ngarkim të pandehurve për ndihmë për kalimin e paligjshëm të kufirit, në bashkëpunim, kundrejt fitimit dhe më shumë se një herë, parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal. Tri ditë më pas, subjekti i është drejtuar gjykatës me kërkesë për caktimin e masës së sigurimit, bazuar në nenet 88⁷⁷ dhe 244⁷⁸ të Kodit të Procedurës Penale. Së dyti, subjekti ka urdhëruar kthimin e menjëhershëm të sendeve të sekuestruara të të hetuarit H. M., me urdhrin datë 25.10.2013. Subjekti ka arsyetuar në urdhr se dy telefonat dhe një automjet i sekuestruar, në kuadër të hetimit të nisur nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, nuk kanë rëndësinë e provës dhe nuk lidhen me veprën penale. Së treti, subjekti i rivlerësimit ka marrë 5 (pesë) vendime për zgjatjen e afatit të hetimeve, nëpërmjet të cilave është shtyrë përfundimi i hetimit deri më datë 31.12.2014.⁷⁹ Në të paktën katër prej këtyre vendimeve, arsyeja e zgjatjes referohet për kryerjen e veprimeve të tjera procedurale, si përkthimi i letërporosisë nga gjuha frënge, pyetje dëshmitarësh etj. Së katërti, në konkluzionet përfundimtare të depozituara në përfundim të gjyqimit të çështjes penale në fjalë, subjekti i rivlerësimit i ka gjetur të pandehurit fajtorë për kryerjen e veprës penale të kryer në bashkëpunim sipas akuzës dhe ka kërkuar nga gjykata, për secilin të pandehur, minimumin e dënimit të parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal, 5 vjet burgim.

18.6. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se kërkesat për ndryshimin e masës së sigurisë janë të bazuara në ligj. Konkretisht, nën dritën e nenit 88 të Kodit të Procedurës Penale, masat e sigurimit të vendosura më herët nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, do t'i humbnin efektet brenda 10 ditëve, pasi

⁷⁶ *Procedimi penal regjistruar në këtë prokurori për veprën penale të “Ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufirit”, e kryer në bashkëpunim, në formën e “Grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga nenet 298 dhe 333/a të Kodit Penal.*

⁷⁷ *Neni 88 - Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata jokompetente parashikon: “1. Masat e sigurimit të vendosura nga gjykata, e cila në të njëjtën kohë ose më vonë shpallet jokompetente për çdo lloj shkak, i humbasin efektet, në qoftë se brenda dhjetë ditëve nga marrja e akteve, gjykata kompetente nuk vendos për masën e sigurimit”.*

⁷⁸ *Neni 244 – Kërkesa për caktimin e masave të sigurimit parashikon: “1. Masat e sigurimit vendosen me kërkesën e prokurorit, i cili i paraqet gjykatës kompetente arsyet ku bazohet kërkesa. Vendimi merret në dhomë këshillimi dhe jepet i arsyetuar. 2. Edhe kur gjykata deklaron moskompetencën e vet për çdo lloj shkak, në qoftë se janë kushtet dhe ekziston urgjenca për marrjen e masës, ajo vendos marrjen e saj dhe i dërgon aktet gjykatës kompetente. 3. Gjykata nuk mund të caktojë një masë siguri më të rëndë se ajo e kërkuar nga prokurori”.*

⁷⁹ *Pasi çështja u regjistrua më 01.10.2013, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pesë (5) shtyrje të afatit të hetimeve, që kanë përfshirë periudhën kohore nga 26.10.2013 – 31.12.2014. Ndërsa më datë 13.11.2014, prokurori i çështjes u shpalli akuzat personave të akuzuar.*

Prokuroria e Krimeve të Rënda shpalli moskompetencën, nëse gjykata kompetente – në këtë rast, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë – nuk do të vendoste për masën e sigurimit. Për rrjedhojë, kërkesa e subjektit, drejtuar gjykatës, në datën 04.10.2013, për caktimin e masës së sigurimit, është në përputhje me afatin 10-ditor të përcaktuar në nenin 88 të Kodit të Procedurës Penale.

18.7. Edhe ndryshimi i masës së sigurimit me *arrest në shtëpi*, rezulton të jetë i bazuar në ligj, pasi është diktuar nga afrimi i afatit fundor të paraburgimit, rregulluar nga nenet 263 dhe 264 të Kodit të Procedurës Penale. Konkretisht, nga aktet rezulton se të pandehurit ishin në paraburgim që në datën 29.03.2013, me vendim të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda⁸⁰. Në kushtet që kufijtë e dënimit për veprën penale, për të cilën ata akuzoheshin, variojnë nga pesë deri në 10 vjet burgim,⁸¹ kohëzgjatja e paraburgimit është më së shumti deri në gjashtë (6) muaj, e cila bashkë me zgjatjen e vetme të mundshme shkon në nëntë (9) muaj⁸². Leximi i ndërthurur i këtyre dispozitave me aktet e procedimit penal në fashikull tregon që afati i paraburgimit për të pandehurit do të përfundonte më datë 29.10.2013.

18.8. Sa më sipër, në kushtet që subjekti brenda 10 ditësh nga përcjellja e akteve për kompetencë, duhej t'i drejtohej gjykatës me kërkesë për vendosjen e masës së sigurimit, afati i paraburgimit do të përfundonte në datën 29.10.2013 dhe nuk mund të zgjatej më, kërkesa e subjektit për caktimin e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”, që mban datën 04.10.2013, është në përputhje me dispozitat ligjore. Rrjedhimisht, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i bazuar në akte dhe në ligj.

18.9. Në vijim, trupi gjykues i Kolegjit vëren se kthimi i sendeve të sekuestruara në funksion të hetimit penal, një prej të pandehurve, rezulton me *mungesë të arsytimit ligjor*. Konkretisht, në vendimin e marrë mbi bazën e kërkesës së të pandehurit (z. H. M.), në datën 11.10.2013, mungon arsyetimi përse këto sende nuk paraqisnin më rëndësinë e provës materiale, në çështjen për të cilën po hetohej apo pse kthimi i tyre nuk e dëmtonte zgjidhjen e çështjes, sipas përcaktimit të nenit 190 të Kodit të Procedurës Penale, që e lidh kthimin e sendeve me mosqenien e tyre të nevojshme apo kur kthimi i provave materiale nuk dëmton zgjidhjen e çështjes. Po kështu, mungon arsyetimi mbi nevojën e zgjatjes/mbajtjes së sekuestros për qëllime prove, sipas pikës 1, të nenit 217, të Kodit të Procedurës Penale.⁸³ Nisur nga argumentimi i Prokurorisë për Krimet e Rënda në vendimin e tyre të sekuestrimit, se këto sende kanë rëndësinë e provës materiale, si dhe nga fakti që kjo prokurori nuk rezulton të jetë shprehur⁸⁴ për kërkesën për kthimin e sendeve, bërë më herët pranë kësaj prokurorie, është e pritshme që urdhri i subjektit të rivlerësimit,

⁸⁰ Me vendimet nr. {***} dhe nr. {***}, datë 29.09.2013.

⁸¹ Neni 298/3 i Kodit Penal parashikon: “[...] Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet dhe me gjobë nga gjashtë milionë deri në tetë milionë lekë. [...]”.

⁸² Neni 263 dhe 264, për afatet dhe zgjatjen e paraburgimit përcaktojnë përkatësisht: “[1.] Paraburgimi e humbet fuqinë, në qoftë se nga fillimi i zbatimit të tij kanë kaluar afatet e mëposhtme, pa u dorëzuar aktet në gjykatë: ...b) gjashtë muaj, kur procedohet për krime që dënohen në maksimumin deri në dhjetë vjet burgim; [...]” dhe neni 264 “[2.] Gjatë hetimeve paraprake, prokurori mund të kërkojë zgjatjen e afateve të paraburgimit, që janë në mbarim e sipër [...] Zgjatja mund të bëhet vetëm një herë dhe nuk mund të jetë më shumë se tre muaj”.

⁸³ Neni 217 - Kthimi i sendeve të sekuestruara, pika 1, parashikon: “1. Kur nuk është e nevojshme mbajtja e sekuestros për qëllime prove, sendet e sekuestruara i kthehen atij që i takojnë edhe para se të merret vendimi përfundimtar. Kur është e nevojshme, organi procedues urdhëron të sillen sendet e kthyerat”.

⁸⁴ Nga aktet rezulton se i pandehuri H. M., në datën 03.06.2013, i ka kërkuar prokurorit të Krimeve të Rënda kthimin e sendeve të sekuestruara (dy telefona celularë dhe një autoveturë), me pretendimin se nuk janë prova në lidhje me çështjen për të cilën po hetohej i pandehuri. Nga aktet në fashikuj nuk evidentohet ndonjë akt i prokurorit lidhur me këtë kërkesë. Në kërkesën e drejtuar subjektit, në datën 11.10.2013, i pandehuri ka kërkuar kthimin e sendeve të sekuestruara me të njëjtin pretendim si më herët.

minimalisht, duhet të ishte i arsyetuar për të treguar ndryshimin e vlerës së tyre provuese në procesin penal në hetim prej tij.

18.10. Trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të bazuar edhe konkluzionin e Komisionit për zgjatje të paarsyetuar të afateve të hetimit të kësaj çështjeje nga subjekti. Nga aktet rezulton se përgjigjja e autoriteteve franceze mbi letërporosisë është përcjellë nga Prokuroria për Krimet e Rënda, më datë 26.12.2013.⁸⁵ Po ashtu, rezulton se për rreth 10 muaj, e konkretisht, nga data 26.12.2013 deri në datën 25.10.2014, kur subjekti ka marrë vendimin e fundit për zgjatje të afatit hetimor, nuk evidentohen akte procedurale të subjektit për caktim përkthyesi (siç ka vepruar më parë prokurori i çështjes të Krimeve të Rënda). Nëse pranohet shpjegimi se afati i hetimeve është zgjatur për përkthimin e letërporosisë, mund të konsiderohet i justifikuar vetëm vendimi i parë, datë 26.10.2013, që daton para përcjelljes së letërporosisë. Katër vendimet e tjera për zgjatje afati hetimesh, të marra pas datës 26.12.2013, kur tashmë Prokuroria për Krimet e Rënda ka vënë në dispozicion të subjektit letërporosisë nga autoritet franceze, qartazi, nuk mund të jenë në funksion të pritjes, e për pasojë, as si shkak për zgjatjen e afatit të hetimeve.

18.11. Së fundmi, në relacionin e OPGj-së, në kërkesën për gjykimin e procedimit penal, në konkluzionet përfundimtare të prokurorit në gjyq, letërporosia nuk është renditur ndër aktet⁸⁶ që provojnë kryerjen e veprës penale të ngarkuar nga të pandehurit. Në këto kushte dhe duke mbajtur në konsideratë që shumica e veprimeve hetimore në këtë çështje janë kryer nga Prokuroria e Krimeve të Rënda, më herët, mungesa e përkthimit të letërporosisë, e pretenduar si shkas për zgjatjen në rrethanat konkrete, e bën të paqartë zgjatjen e afatit të hetimeve dhe vonesën prej 10 muajsh të pajustificuar e pabazuar në nevojat hetimore. Kjo zgjatje duket se i ka shërbyer të pandehurve për të konsumuar afatet e dënimit me burgim, të pritshëm për t'u caktuar nga gjykata, në kushtet e arrestit në shtëpi, parë edhe në këndvështrim të arsyetimit të mëposhtëm për masë minimale dënimi.

18.12. Aspekti i fundit i analizës së kësaj çështjeje, dënimi i kërkuar për të pandehurit nga subjekti në gjyq, është analizuar nga Komisioni në funksion të arsyetimit ligjor. Sikurse Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit vëren se aktet e referuara/cituara në konkluzionet përfundimtare përmbajnë rrethana dhe fakte, që nuk e mbështesin kërkimin e subjektit për dënim minimal. Konkretisht, referuar konkluzioneve në fjalën përfundimtare, subjekti ka kërkuar dënim minimal, pasi të pandehurit: (i) janë në moshë të re; (ii) kanë treguar pendim të thellë dhe (iii) janë të padënuar më parë. Këto arsyeime nuk gjejnë mbështetje në ligj dhe prova pasi, nuk mbështeten në asnjë dokument të dosjes. Pretendimi i subjektit, se me kërkesën e tij ka rënë dakord edhe gjykatat, përfshirë atë të Apelit Tiranë, është po ashtu pa peshë në vlerësimin e arsyetimit ligjor të subjektit në këtë aspekt të çështjes penale.

18.13. Në zbatim të nenit 73, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, Komisioni ka analizuar përputhshmërinë e kërimit të subjektit me aktet mbi të cilat e ka bazuar këtë kërkim. Në të njëjtën linjë, trupi gjykues i Kolegjit vëren se asnjëri prej kriterëve të prezantuar nga subjekti në fjalën përfundimtare, përmbledhur më sipër, nuk gjen zbatim në rastin e të pandehurve. Konkretisht, referuar nenit 47, paragrafi i dytë⁸⁷ i Kodit Penal, mosha nuk është rrethanë që përcakton masën e dënimit, pasi nuk renditet ndër rrethanat

⁸⁵ Me shkresën nr. {***} prot., datë 26.12.2013.

⁸⁶ Referuar fjalës përfundimtare të prokurorit në gjyq.

⁸⁷ Neni 47 – Mënyra e caktimit të dënimit: “Gjykata cakton dënimin duke respektuar dispozitat e pjesës së përgjithshme të këtij Kodi dhe kufijtë e dënimeve të parashikuar në ligj për veprën penale. Në caktimin e dënimit ndaj personit, ajo merr parasysh rrethshmërinë e veprës penale, të autorit të saj, shkallën e fajit, si dhe rrethanat lehtësuese dhe rënduese”.

lehtësuese të parashikuara në nenin 48, paragrafi i parë⁸⁸ i Kodit Penal. Kodi Penal i jep rëndësi moshës së të pandehurit nëse ky i fundit është i mitur⁸⁹ dhe në rastin e aplikimit të dënimit alternativ, në kuptim të neneve 58-60 të Kodit Penal. Nëse subjekti kishte parasysh moshën si një ndër rrethanat lehtësuese përjashtimore kundrejt atyre të përcaktuara shprehimisht në ligj, nën dritën e hapësirës që lejon neni 49 i Kodit Penal,⁹⁰ në kërkimin e tij mungon çdo lloj arsytimi përse mosha e të pandehurve, 38 - 47 vjeç dhe njëri prej tyre 27 vjeç, përbën rrethanë lehtësuese, duke mos qenë as në marzhin e të miturve dhe as në atë të moshuarve.

18.14. Dy rrethanat e tjera, *pendimi* i thellë apo qenia e të pandehurve të *padënuar* më parë, nuk është e mbështetur në të dhënat nga aktet në fashikull. Të pandehurit jo vetëm që nuk kanë shfaqur shenja pendimi për veprën penale të kryer, por asnjë prej tyre⁹¹ nuk e ka pranuar akuzën, me pretendimin që nuk kanë tentuar të ndihmojnë dikë për kalim të paligjshëm të kufirit, dhe njëri prej tyre nuk është gjetur dhe i është shmangur drejtësisë. Së fundmi, nga përmbajtja e kërkesës për gjykim, rezulton se i pandehuri H. M. është me gjendje gjyqësore “i dënuar”, gjë që provon edhe që kërkesa për dënim minimal, pasi të pandehurit janë të padënuar, është haptazi e pabazuar.

18.15. Në përmbyllje të këtij shkakut ankimor, sikurse argumentuar më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se pretendimet e subjektit të rivlerësimit nuk gjejnë mbështetje në akte dhe në ligj. Për rrjedhojë, është i bazuar konkluzioni i Komisionit, se subjekti ka treguar *më së paku* mangësi të njohurive të ligjit dhe rol pasiv e jo efikas në drejtim të veprimtarisë hetimore, të demonstruara në veprime të ndryshme, si: marrja e vendimit për kthimin e sendeve të sekuestruara, marrja disa herë dhe në mënyrë të pajustificuar e vendimit për zgjatjeve të afatit të hetimeve, kërtimeve përfundimtare të pambështetura në akte, të cilat duket se kanë favorizuar të pandehurit. Për këto rrethana, subjekti duhet të kishte ushtruar kujdes dhe vëmendje të posaçme. Në përfundim të verifikimeve të kryera në lidhje me këtë pretendim, trupi gjykues i Kolegjit e gjeti të pambështetur në akte dhe vlerësoi se subjekti i rivlerësimit në këtë rast ka demonstruar mungesë të arsytimit ligjor në marrjen e vendimeve, defekt i cili e vendos subjektin në kushtet e nenit 73, pika 3 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e magjistratit”.

18.16. Sikurse përmbledhur në pjesën hyrëse të vlerësimit të shkakut ankimor për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues i Kolegjit, në ndryshim nga Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk mund të konsiderohet i papërshtatshëm në vlerësimin e aftësive profesionale, në kuptim

⁸⁸ Neni 48 – Rrethanat lehtësuese: “Lehtësojnë dënimin rrethanat që vijnë: a) kur vepra është kryer e shtyrë nga motive me vlera pozitive morale e shoqërore; b) kur vepra është kryer nën ndikimin e tronditjes psikike të shkaktuar nga provokimi ose veprime të padrejta të viktimës apo të ndonjë personi tjetër; c) kur vepra është kryer nën ndikimin e veprimeve apo të udhëzimeve të padrejta të eprorit; ç) kur personi që ka kryer veprën tregon pendim të thellë; d) kur personi ka zëvendësuar dëmin e shkaktuar nga vepra penale ose ka ndihmuar aktivisht për të zhdukur ose pakësuar pasojat e veprës penale; dh) kur personi paraqitet në organet kompetente pas kryerjes së veprës penale; e) kur marrëdhëniet ndërmjet personit që ka kryer veprën penale dhe të dëmtuarit janë normalizuar”.

⁸⁹ Neni 51 – Dënim i miturit: “Për të miturit, që në kohën e kryerjes së veprës penale nuk kanë mbushur moshën 18 vjeç, dënimin nuk mund të jetë më shumë se gjysma e dënimit që parashikon ligji për veprën penale të kryer. Rregullat për caktimin e dënimit për të miturin parashikohen në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur”.

⁹⁰ Neni 49 – “Gjykata, pavarësisht nga rrethanat që përmenden në nenin 48 të këtij Kodi, mund të marrë në konsideratë edhe rrethana të tjera për sa kohë i quan të tilla që justifikojnë lehtësimin e dënimit.”

⁹¹ Referuar procesverbaleve të pyetjes të të pandehurve datë 14.11.2014. Ndërsa i pandehuri K. B. nuk mund të ketë shprehur pendim, pasi, referuar vendimit datë 17.11.2014, “Për mosgjatjen e personit nën hetim”, rezulton se për sa kohë i është fshehur drejtësisë, nuk mund të ketë shprehur pendim.

të nenit 44, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016. Problematikat e konstatuara, ndonëse dëshmojnë mangësi të njohurive të ligjit dhe rol pasiv e jo efikas në drejtim të veprimtarisë hetimore, ato pasqyrojnë zgjedhje të vetë subjektit, magistrat me përvojë të gjatë. Për këtë arsye, trupi gjykues çmoi se duhen bërë pjesë e vlerësimit tërësor të çështjes. Parë në këtë kontekst dhe nën dritën e perceptimit të publikut, mënyra se si subjekti ka zgjedhur të kryejë një sërë veprimesh në funksionin e prokurorit dhe mënyra se si subjekti ka zgjedhur të shpjegojë veprimet e tij, cenon besimin e publikut, e për rrjedhojë, subjekti u vlerësua përfundimisht për këtë kriter se ndodhet në kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

19. Komisioni ka konkluduar edhe që subjekti nuk ka qenë bashkëpunues gjatë hetimit administrativ dhe e ka vështirësuar punën e organeve në kryerjen e procesit të rivlerësimit. Në këtë vlerësim, Komisioni ka referuar kundërshtimet dhe kërkesat e njëpasnjëshme gjatë procesit, e sidomos në fazën finale të përmbylljes së tij. Kjo mënyrë sjelljeje me synim shtyrjen e procesit dhe zgjatjen e tij, bie ndesh me detyrimin ligjor që kanë subjektet për të qenë të vërtetë, të saktë dhe efikas gjatë këtij procesi. Komisioni e ka vlerësuar këtë aspekt të sjelljes së subjektit si cenim të besimit të publikut të funksionari që e kryen atë, në një mënyrë të parikuperueshme nëpërmjet ndonjë programi trajnimi në Shkollën e Magjistraturës, dhe si një nga kushtet e parashikuara për *shkarkim* nga *detyra*, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

19.1. Sikurse përmbledhur më sipër, subjekti e ka kundërshtuar këtë konkluzion, duke pretenduar se nuk lidhet me veprime e sjellje që përbëjnë shkelje të normave ligjore në fuqi. Ai po ashtu potencon se konkluzioni për cenimin e besimit të publikut është marrë në kundërshtim me nenin 61 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenin 4, pika 2 të po këtij ligji. Së fundmi, subjekti shprehet se vendimi objekt ankimi është marrë pa argumentuar njësinë matëse së cilës i është referuar Komisioni, për të konkluduar për cenim të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë.

19.2. Sikurse referuar në paragrafin 10.12 më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vëren se ky pretendim i subjektit është i pabazuar. Komisioni ia ka kushtuar Kreun V të vendimit, veprimeve përmes të cilave subjekti i rivlerësimit ka demonstruar mungesë bashkëpunimi, në kundërshtim me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka përmbledhur dhe analizuar po aty mënyrën se si ka vlerësuar mosprezencën e subjektit në seancë, pa shkaqe të përligjura, ecurinë e seancës dëgjimore relatuar në mënyrë të detajuar në Kreun II të vendimit, mënyrën që ka zgjedhur subjekti për t’u përfaqësuar me një akt përfaqësimi konfuz dhe kontradiktor, kërkesat e njëpasnjëshme për përjashtim të anëtarëve të trupit gjykues, si dhe për përjashtim të të gjithë trupit gjykues. Të gjitha këto sjellje të subjektit të rivlerësimit dhe përfaqësuesve të tij ligjorë, sikurse edhe Komisioni, trupi gjykues i Kolegjit i vlerëson si përpjekje për të prezantuar para organeve të rivlerësimit një situatë faktike që nuk i përgjigjet realitetit dhe që del jashtë kontekstit të rivlerësimit të kryer ndaj tij, e rezultateve konkrete të relatuara mbi hetimin administrativ dhe që tenton ta deformojë atë në funksion të prodhimit të të dhënave, të cilat do të favorizonin subjektin gjatë procedurës së rivlerësimit.

19.3. Kolegji ka arsyetuar gjerësisht në çështje të mëparshme se, në kuptim të nenit 4, pika 2, vendimi për procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit mund të merret bazuar në një ose disa prej kriterëve. Kjo nënkupton që, nëse në një moment të caktuar të zhvillimit të procedurës hetimore administrative Komisioni arrin në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, bazuar në rezultatet e arritura nga procedura hetimore edhe për vlerësimin e një kriteri të vetëm, ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit për atë kriter dhe të marrë një vendim

për shkarkimin e subjektit, pa qenë e nevojshme që procedura administrative të vazhdojë më tej me verifikimin e kritereve të tjera, për sa kohë një vendim është bërë tashmë i arritshëm. Nëse në përfundim të këtij vlerësimi arrihet në konkluzionin se sjellja e subjektit është e tillë që cenon besimin e publikut të magjistrati gjyqtar ose prokuror, edhe vetëm kjo qasje e sjellje e subjektit ndaj procesit të rivlerësimit do të përmbushte një nga kushtet e parashikuara për shkarkim nga detyra, atë të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Sjellja jobashkëpunuese e subjektit dhe mangësitë e konstatuara në kriterin e aftësive profesionale konsiderohen prej Kolegjit se duhen parë në tërësi, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, si një nga alternativat e vlerësimit të kritereve të procesit të rivlerësimit të parashikuar nga ligji.

19.4. Së fundmi, cenimi i besimit të publikut të drejtësia nuk vlerësohet bazuar në njësi matëse, por në veprime e sjellje të subjektit të rivlerësimit. Sikundër argumentuar më lart, subjekti i rivlerësimit nuk ka treguar një sjellje korrekte dhe bashkëpunuese gjatë procesit të rivlerësimit. Ndërsa është e drejtë kushtetuese e subjektit të paraqesë kërkesat procedurale të nevojshme, aktet në fashikull dhe kronologjia e dinamika e veprimeve, sikurse edhe pohimet e përfaqësuesve të tij ligjorë tregojnë për përpjekje të kryera në kufijtë e abuzivizmit. Veprimet e subjektit të rivlerësimit, qartazi, nuk duken të kenë synuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, por zvarritjen e këtij procesi, deri në pamundësimin e tij. Në këtë drejtim dhe nën dritën e nenit 48, të ligjit nr. 84/2016, u vlerësuan edhe në Kolegj kërkesat e përsëritura dhe haptazi të pabazuara të subjektit gjatë procesit, e sidomos në fazën finale të përmbylljes së hetimit administrativ në Komision. Sjellja e veprimeve të subjektit dhe qasja që ka treguar karshi këtij procesi, me të drejtë është konsideruar nga Komisioni si cenim i besimit të publiku.

20. Duke e vlerësuar sjelljen e subjektit gjatë procesit të rivlerësimit kundrejt Komisionit, së bashku me veprimet e subjektit gjatë kryerjes së detyrës, sikurse ka rezultuar nga hetimi i katër procedimeve penale të gjetura me problematika, trupi gjykuesi Kolegjit e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, e për rrjedhojë, vlerëson se ndaj tij duhet të aplikohet neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
21. Bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se, mbështetur në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit Ervin Karanxha *nuk arrin* nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe *ka cenuar* besimin e publikut të sistemi i drejtësisë. Në përfundim, trupi gjykues çmon se vendimi nr. 413, datë 07.07.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i drejtë, i bazuar në fakte dhe në ligj dhe, si i tillë, ai duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 413, datë 07.07.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ervin Karanxha.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 15.01.2025.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

KRYESUES

Sokol ÇOMO

nënshkrimi